

**RAPORTI FILLESTAR DHE I PARË PERIODIK I  
SHTETEVE PALË**

**KONVENTA MBI TË DREJTAT E FËMIJËS (CRC)**

**SHQIPËRIA**

## PËRMBAJTJA

	Faqe
HYRJE	4
I. MASA TË PËRGJITHSHME PËR ZBATIM	5
II. KUPTIMI I FËMIJËS	15
III. PARIME TË PËRGJITHSHME	16
A. Mos-diskriminimi (neni 2)	16
B. Interesi më i lartë i fëmijës (neni 3)	<b>19</b>
C. E drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit (neni 6)	20
D. Respektimi i mendimit të fëmijës (neni 12)	21
IV. TË DREJTAT DHE LIRITË CIVILE	23
A. Emri dhe kombësia (neni 7)	23
B. Ruajtja e identitetit (neni 8)	27
C. E drejta e shprehjes (neni 13)	28
D. E drejta për informacion të përshtatshëm (neni 17)	29
E. Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë (neni 14)	34
F. Liria e organizimit dhe mbledhjes paqësore (neni 15)	36
G. Mbrojtja e jetës private (neni 16)	36
H. E drejta për t'iu mos nënshtruar torturës, trajtimeve, apo dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese (neni 37 (a))	37
V. MJEDISI FAMILJAR DHE KUJDESI ALTERNATIV	38
A. Kujdesi prindëror (neni 5)	38
B. Përgjegjësitë prindërore (neni 18, parag. 1-2)	39
C. Ndarja nga prindërit (neni 9)	40
D. Ribashkimi familjar (neni 10)	43
E. Kujdesi për fëmijët (neni 27, parag. 4)	43
F. Fëmijët e privuar nga mjedisi familjar (neni 20)	44
G. Birësimi (neni 21)	50
H. Transferimi i paligjshëm dhe mos-kthimi (neni 11)	52
I. Abuzimi dhe neglizhenca (neni 19), duke përfshirë rikuperimin fizik dhe psikologjik dhe riintegrimin social (neni 39)	54
J. Rishikimi periodik i vendbanimit (neni 25)	57
VI. SHËNDETI BAZË DHE MIRËQENIA	57
A. Mbijetesa dhe zhvillimi (neni 6, parag 2)	58
B. Fëmijët e paaftë (neni 23)	58

C. Shëndeti dhe shërbimet shëndetësore (neni 24)	62
D. Sigurimi shoqëror, shërbimet dhe lehtësitë e kujdesit për fëmijën (neni 26 dhe 18, parag. 3)	67
E. Standarti i jetesës (neni 27, paragrafët 1 dhe 2)	71
VII. ARSIMI, KOHA E LIRË DHE AKTIVITETET KULTURORE	75
A. Arsimimi, duke përfshirë trajnimin profesional dhe administrimin (neni 28)	75
B. Objektivat e arsimit (neni 29)	87
C. Koha e lirë, aktivitetet rekreative dhe kulturore (neni 31)	89
VIII. MASAT E VEÇANTA TË MBROJTJES	90
A. Fëmijët me status refugjati (neni 22)	90
B. Fëmijët në konflikte të armatosura (neni 38), duke përfshirë rikuperimin fizik dhe psikologjik, si dhe riintegrimin shoqëror (neni 39)	92
C. Administrimi i drejtësisë për fëmijët (neni 40)	92
D. Fëmijët e privuar nga liria, duke përfshirë çdo formë ndalimi, burgosjeje, apo vendosje në ambiente të mbikqyrura (neni 37 (b), (c))	95
E. Dënimi i fëmijëve, në veçanti ndalimi i dënimit kapital dhe burgimit të përjetshëm (neni 37 (a))	98
F. Shfrytëzimi ekonomik, duke përfshirë punën e fëmijëve (neni 32)	99
G. Abuzimi me drogat (neni 33)	101
H. Shfrytëzimi dhe abuzimi seksual (neni 34)	103
I. Forma të tjera shfrytëzimi (neni 36)	104
J. Shitja, trafikimi dhe rrëmbimi (neni 35)	105
K. Fëmijët që i përkasin minoriteteve apo grupeve indigjene (neni 30)	106

## HYRJE

1. Konventa mbi te Drejtat e Femijes, miratuar nga Asambleja e Pergjithshme e Organizates se Kombeve te Bashkuara me 20 nentor 1989, eshte nje nga aktet me te rendesishme te se drejtes nderkombetare ne te cilen jane parashikuar te drejtat dhe detyrimet ne te gjitha fushat e jetes se femijes, te grumbulluara ne nje menyre kaq te plote dhe te detajuar si ne asnje akt tjetet juridik ne fushen e te drejtave te femijeve.

2. Ne Kushtetuten shqiptare (neni 122) thuhet se çdo marreveshje nderkombetare e ratifikuar perben pjese te sistemit te brendshem juridik, pasi botohet ne Fletoren Zyrtare te Republikes se Shqiperise. Ajo zbatohet ne menyre te drejtperdrejte, pervec rasteve kur nuk eshte e vetzbatueshme dhe zbatimi i saj kerkon nxjerrjen e nje ligji. Nje marreveshje nderkombetare e ratifikuar me ligj ka epersi mbi ligjet e vendit qe nuk pajtohen me te. Kjo dispozite e Kushtetutes eshte e nje rendesie te veçante ne mbrojtjen e te drejtave te femijeve, sepse edhe ne rastet kur ne legjislacionin e brendshem ka mangesi mund te zbatohet direkt Konventa e OKB-se per te Drejtat e Femijes.

3. Konventa Per te Drejtat e Femijes u ratifikua nga Kuvendi i Republikes se Shqiperise ne Shkurt 1992 dhe hyri ne fuqi ne Mars 1992. Ratifikimi i saj nga Kuvendi u be ne baze te nenit 16 te Dispozitave Kryesore Kushtetuese (1991). Konventa per te Drejtat e Femijes eshte botuar ne 500 kopje nga Komiteti per Mundesi te Barabarta i cili eshte ne varesi te Keshillit te Ministrave. Po keshtu Konventa eshte botuar nga ana e UNICEF dhe organizates jo-qeveritare CRCA dhe ne disa raste ajo eshte e shoqeruar edhe me komentet perkatese. Kuadri ligjor pas ratifikimit te Konventes ka pesuar ndryshime rrenjesore me qellim pershtatjen e tij me dispozitat e Konventes.

4. Te drejtat e femijes dhe ato te njeriut ne pergjithesi kane pesuar permiresime te ndjeshme me ane te reformave te gjithanshme ligjore dhe institucionale, duke u afruar me standartet Europiane. Por, ne kundershtrim me gjendjen reale te te drejtave te njeriut ne Shqiperi, kane munguar deri me tani raportimet ne lidhje me zbatimin e Konventave te OKB-se per te drejtat e njeriut te cilat rrjedhin nga detyrimet qe Shqiperia ka si pale ne keto Konventa.

5. Duke e vleresuar ne maksimum procesin e raportimeve dhe bazuar ne angazhimet qe rrjedhin ndaj Konventave te ratifikuara nga Shqiperia, Qeveria shqiptare me Urdher te Kryeministrit nr. 134, date 05.05.2000 vendosi krijimin e nje grupi pune te perhershem, i cili ka per detyre hartimin e raporteve kombetare per Konventat per te Drejtat e Njeriut. Ky grup pune perbehet nga perfaqesues te te gjitha ministrive dhe te institucioneve qendrore, si dhe nga perfaqesues te OJQ-ve aktive ne fushen e te drejtave te njeriut, gruas, femijes, dhe pakicave te ndryshme ne Shqiperi. Raporti fillestar dhe i pare i Konventes mbi te Drejtat e Femijes perfshin masat ligjore, ekzekutive, administrative, etj te ndermarra nga Republika e Shqiperise gjate periudhes 1992-2000.

6. Ne zbatim te Neni 44, paragrafit 6 te Konventes, para dorezimit Raporti per te Drejtat e Femijes, CRC u eshte vene ne dispozicion jo vetem dikastereve dhe OJQ-ve qe jane ftuar te marrin pjese aktive ne pergatitjen e tij, por edhe organizatave te tjera joqeveritare, disa prej te cilave jane permendur ne raport. Ky hap eshte ndermarre jo vetem me qellimin e shperndarjes se Raportit, por edhe ne drejtim te njohjes me verejtjet e tyre eventuale per pjese te vecanta te tij.

## **I. MASA TE PERGJITHSHME PER ZBATIM (nenet 4, 42 dhe 44 paragrafi 6)**

7. Me qellim pershtatjen e legjislacionit te brendshem me Konventen e OKB-se mbi te Drejtat e Femijes, pas Marsit 1992 jane miratuar nje sere ligjesh dhe vendimesh te cilat direkt, apo indirekt ndikojne ne permiresimin e te drejtave te femijes ne Republiken e Shqiperise. Si te tille mund te permenden:

- ✍ Kodi i Familjes, ligji Nr. 6599, datë 29.06.1982.
- ✍ Kodi Penal, ligji nr.7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet me ligjin 8279, date 15.01.1998.
- ✍ Kodi i Procedures Penale, ligji Nr.7905, datë 21.3.1995.
- ✍ Kodi Civil, ligji Nr. 7850, datë 29.07.1994.
- ✍ Kodi i Procedures Civile, ligji Nr. 8116, datë 29.03.1996.
- ✍ Kodi i Punes, ligji Nr.7961, datë 12.07.1995.
- ✍ Vendimi Nr 384 date 20.05.1996, “Per mbrojtjen e te miturve ne pune”.
- ✍ Konventa e Hages “Per mbrojtjen e femijeve dhe bashkepunimin per biresimet jashte vendit”, ratifikuar ne qershor 2000, me ligjin 8624, date 15.06.2000.
- ✍ Konventa 182 “Per format me te keqija te punes se femijeve” dhe rekomandimi nr.190, “Format me te keqija te punes se femijeve” miratuar nga Qeveria Shqiptare ne shtator 2000.
- ✍ Rregullorja e Pergjithshme e Burgjeve.
- ✍ Ligji nr.8328, date 14.04.1998 “Per te drejtat dhe trajtimin e te denuarve me burgim”.
- ✍ Ligji nr.7650, date 17.12.1992 ‘Per biresimin e te miturve nga shtetas te huaj dhe per disa ndryshime ne Kodin e Familjes”.
- ✍ Ligji nr.5840, date 20.21.1979 “Per rregjistrimin e akteve te gjendjes civile”, i cili ka pesuar nje ndryshim persa i perket ruajtjes se emrit ose mbiemrit te personit, me ligjin nr 7682, date 9.03.1993, “Per disa ndryshime ne ligje”.
- ✍ Ligji nr.8389, date 5.08.1998, “Per shtetesine shqiptare”, neni 5, etj, ndryshuar me ligjin 8442, date 21.1.1999.
- ✍ Ligji nr.8432, date 14.12.1998, “Per Azilin ne Republiken e Shqiperise”
- ✍ Ligji nr. 8410, date 30.09.1998, “Per Radion dhe Televizionin Publik dhe Privat ne Republiken e Shqiperise”.
- ✍ Konventa kunder tortures dhe vuajtjeve ose trajtimeve mizore, jonjerezore e degraduese, ratifikuar me ligjin nr. 7727, date 30.06.1993.
- ✍ Konventa per zhdukjen e te gjitha formave te dallimit racial, ratifikuar me ligjin 7768, date 9.11.1993.

- ✍ Ligji nr.3766, date 17.12.1963, “Per Kujdesin Shendetesor”, ndryshuar me ligjin 7718, date 3.06.1993, dhe ligjin nr. 7738, date 21.07.1993.
- ✍ Ligji 7761, date 19.10.1993, “Per parandalimin dhe luftimin e semundjeve ngjitese”.
- ✍ Ligji 8528, date 23.09.1999, “Per nxitjen dhe mbrojtjen e te ushqyerit me gji”.
- ✍ “Konventa Europiane “Per mbrojtjen e te drejtave dhe lirive themelore”, miratuar me ligjin nr. 8137, date 31.07.1996.
- ✍ Ligji 8153, date 31.10.1996, “Per statusin e jetimit”.
- ✍ Ligji nr. 8331, date 21.4.1998, “Per ekzekutimin e vendimeve penale”.
- ✍ Ligji nr.7710, date 18.5.2000, “Per ndihmen dhe perkujdesjen shoqerore”, ndryshuar me ligjin nr.7886, date 8.12.1994, dhe ligjin nr.8008, date 5.10.1995 dhe aktet nenligjore nga Ministrise se Punes dhe Çeshtjeve Sociale.
- ✍ Ligji nr.8092, date 21.3.1996 “Per Shendetin Mendor”.
- ✍ Ligji nr.7889, date 14.12.1994 “Per Statusin e Invalidit”.
- ✍ Ligji nr.7952, date 30.07.1998, “Per sistemin Arsimor Parauniversitar” ndryshuar me ligjin 8387, date 21.6.2000, “Per sistemin arsimor parauniversitar”.
- ✍ Vendimi nr 39 date 22. 08, 1994, “Per arsimin 8-te vjecar ne gjuhen amtare te personave te pakicave kombetare”,
- ✍ Ligji nr.8689 date 16.11.2000, “Per parandalimin e perhapjes se infeksionit HIV- AIDS ne Republiken e Shqiperise” (neni 20-22).
- ✍ Ligji nr 7986 date 13.9.1995 “Per Inspektoriatin Shteteror te Punes”.
- ✍ Ligji nr 7635 date 11.11.1992 “Per disa ndryshime ne ligjin nr 4624, date 24. 12. 1969 “Per Sistemin e ri Arsimor”.
- ✍ Ligji “Per Organizimin e Pushtetit Gjyqesor ne Republiken e Shqiperise” i ndryshuar me ligjin 8436, date 28.12.1998, ndryshuar me ligjin nr 8546, date 5.11.1999, ndryshuar me ligjin nr 8656, date 31.07.2000, neni 25/a pjesemarrja e psikologut ne procesin gjyqesor ndaj te miturit.
- ✍ Kushtetuta e Republikes se Shqiperise miratuar ne Nentor 1998, neni 18, 122 etj.
- ✍ Ligji nr 8045 “Per nderprerjen e shtatzanise”, date 7.12.1995.
- ✍ Ligji nr 7939, “Per Emigracionin”, date 25.5.1995, neni 15 krijon lehtesira per marrjen e lejes se qendrimit te femijeve qe jane nen moshen 18 vjec.
- ✍ Konventa Europiane per Televizionin Nderkufitar, miratuar me ligjin nr 8525, date 9.09.1999.
- ✍ Ligji nr 8503, date 30.06.1999 “Per te drejten e informimit per dokumentet zyrtare”.
- ✍ Vendimi nr. 248, date 28.05.1999, i Keshillit te Ministrave, parashikon paraqitjen e nje deklarate nga institucionet arsimore jopublike, me ane te se ciles marrin persiper te respektojne Konventen “Per te drejtat e femijeve” (CRC).
- ✍ Ligji nr. 8096, date 29.04.1996, “Per Kinematografine”, parashikon transmetimin e filmave ne menyre te diferencuar, sipas moshave te te miturve, si dhe percakton oraret e shfaqjes se tyre.
- ✍ Ligji nr. 8492, date 27.05.1999 “Per te Huajt”, i cili parashikon te drejten e te miturit nen 16 vjec, per te aplikuar per vize leje, ose te drejten per te hyre ne

Republikën e Shqipërisë me lejen e kujdestarit ligjor. Në zbatim të tij është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave, nr 439, datë 04.08.2000, “Për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në territorin e Republikës së Shqipërisë”, në të cilin parashikohen edhe të miturit.

✍ “Marreveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, dhe Komisarariatit të Lartë të Kombeve të Bashkuara Për refugjatet”. ratifikuar nga Kuvendi Popullor me Ligjin nr 7833, datë 22. 06.1994.

Shumë projektligje të tjera siç është Projekti i Kodit të Ri të Familjes janë në fazën përfundimtare të diskutimit.

8. Dokumenti më i rëndësishëm i Qeverisë Shqiptare që është duke u përgatitur për përcaktimin politikave në lidhje me të drejtat e fëmijëve është Strategjia Kombëtare Për Fëmijët e cila do të hartohet nga një grup pune i përbërë nga specialistë të institucioneve shtetërore më pranë problemeve të fëmijëve dhe të disa shoqatave jo-qeveritare për të drejtat e fëmijës. Ky grup pune drejtohet nga Komiteti për Mundësi të Barabarta.

9. Strategjia Kombëtare për Fëmijët e cila është drejt përfundimit mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë - Neni 54, si dhe në Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës. Ajo do të shoqërohet nga një Plan Veprimi i detyrueshëm për të gjitha institucionet shtetërore dhe organizatat joqeveritare dhe do të shërbejë për përmirësimin e gjendjes së fëmijëve në Shqipëri.

10. Qeveria Shqiptare po merr të gjitha masat e nevojshme, si në drejtim të ndryshimeve të nevojshme në legjislacion dhe përputhjen e tij me dispozitat e Konventës për të Drejtat e Fëmijës, por edhe që ta shndërrojë Strategjinë e propozuar Kombëtare për Fëmijët në një aksion detyrues për të gjitha institucionet e vendit. Kjo do të arrihet nëpërmjet përcaktimit të detyrave, masave komplekse dhe konkrete në fushën e formimit dhe të edukimit të fëmijëve, për pacënueshmërinë e tyre fizike dhe psikologjike në të gjitha mjediset, për përmirësimin e kushteve dhe të mjedisve që lidhen drejtpërdrejt, apo tërthorazi me mësimin dhe formimin e tyre kulturor, me rritjen e nivelit të informacionit, me zhvillimin e shëndetshëm, me çlodhjen dhe argëtimin, për mirëtrajtimin dhe nxitjen e prirjeve dhe talenteve të fëmijëve etj.

11. Institucionet kryesore shtetërore kompetente që mbulojnë problemet e të drejtave të fëmijëve të përmendura në CRC, janë Ministria e Arsimit, Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Rendit Publik, Ministria e Pushtetit Vendor, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Komiteti për Mundësi të Barabarta dhe Sherbimi Social Shtetëror.

✍ Ministria e Arsimit është institucion kompetent për edukimin dhe arsimimin e fëmijëve. Vitet e fundit Ministria e Arsimit ka bërë përpjekje të mëdha në drejtim të krijimit të kushteve normale për edukimin dhe arsimimin e fëmijëve në të gjitha drejtimet dhe në mënyrë të vecante në drejtim të ndërtimit të institucioneve të reja arsimore dhe restaurimit të atyre ekzistuese. Aktualisht një sfida e madhe për këtë Ministri përbejnë synimet për kthimin e nxënësve të

larguar dhe ne kete kuader Ministria e Arsimit bashkepunon ne menyre intensive me organet e pushtetit vendor.

- ✍ Ministria e Punes dhe Ceshtjeve Sociale, siguron asistencen per femijet e braktisur, rehabilitimin e tyre social etj. Sipas te dhenave per vitit 1999, 1% e femijeve jane te angazhuar ne pune te ndryshme.
- ✍ Ministria e Shendetesise ka ne kompetencen e saj hartimin e politikave te vecanta per shendetin e femijes dhe gjithcka qe lidhet me kujdesin e vecante per nenen dhe femijen. Nje vemendje te vecante Ministria i kushton numrit ne renie te vdekshmerise foshnjore.
- ✍ Ne perberje te Ministrise te Drejtesise kohet e fundit eshte ngritur nje seksion i vecante i cili merret me perpjekjet per permiresimin e dispozitave ligjore per mbrojtjen e te drejtave te femijeve, si dhe per rehabilitim e femijeve te cilet jane perfshire ne aktivite keqberese.
- ✍ Nje nga detyrat kryesore te Ministrise se Rendit Publik eshte mbrojtja e femijeve nga dhuna fizike dhe parandalimi i trafikut te tyre. Strukturat e Policise se Shtetit si psh, Interpoli, Policia e Rendit, Policia Kriminale, Policia Kufitare dhe Anti-droga jane pjese te MRP qe bashkepunojne ne realizimin e detyrave te siperpermendura.
- ✍ Ministria e Pushtetit Vendor koordinon punen ne shkalle vendore per zbatimin sa me rigoroz te programeve dhe projekteve ne lidhje me femijet.
- ✍ Qendra Kombetare Kulturore e femijeve ne kuadrin e Ministrise se Kultures, Rinise dhe Sporteve realizon nje numer projektesh per femijet.
- ✍ Komiteti per Mundesi te Barabarta ne varesi te Keshillit te Ministrave, po pergatit aktualisht Strategjine Kombetare per Femijet.
- ✍ Sherbimi Social Shteteror, eshte agjenci qeveritare e zbatimit te politikave te mbrojtjes sociale.

12. Mbrojtja e te drejtave te femijeve perben nje nga drejtimet me te rendesishme te politikave te mbrojtjes sociale ne Republiken e Shqiperise. Ne themel te politikave sociale te adresuara ne mbrojtjen e te drejtave te femijeve, reflektohen parimet themelore te Konventave te OKB-se dhe instrumentave te tjera nderkombetare te ratifikuara nga shteti shqiptar, te cilat theksojne se femijet, per shkak te veçorive te moshes, te mungeses se pjekurise fizike dhe intelektuale, kane nevojë per nje mbrojtje dhe vemendje te veçante, nga familja dhe institucionet shteterore.

13. Mbeshtetur ne keto parime dhe duke marre ne konsiderate faktin se, femijet jane kategoria me e prekshme ndaj kushteve ne te cilat jetojne dhe rreziqeve qe mbart ekonomia e tregut, trajtimi i problemeve sociale te femijeve ne nevojë zene nje vend te rendesishem ne veprimtarine komplekse te Sherbimit Social Shteteror.

14. Qellimi i politikave te mbrojtjes sociale lidhur me te drejtat e femijeve eshte qe ne kuader te krijimit te nje sistemi modern te sherbimeve sociale, me standarte dhe parametra bashkekohore, te sigurohet mbeshtetja, rehabilitimi dhe riintegrimi ne shoqeri i kategorive te femijeve ne nevojë, te cilet rezikohen nga marginalizimi dhe perjashtimi social.



15. Ndryshimet e ndodhura ne dhjetevjeçarin e fundit kane rritur ne menyre te dukshme rreziqet me te cilat ballafaqohen femijet dhe familjet e tyre. Nen ndikimin e dukurive sociale te tilla si emigracioni, urbanizimi i pakontrolluar, varferia dhe papunesia, dezintegrimi i familjes dhe divorcet, konstatohet tendenca e rritjes se numrit dhe shkalles se prekshmerise sociale per kategorite e ndryshme te femijeve. Problematikat dhe rreziqet me te cilat ballafaqohen femijet, reflektojne sfidat e zhvillimit dhe veshtiresite komplekse me te cilat ndeshet shteti, shoqeria dhe familja ne periudhen e tranzicionit.

16. Duke marre ne konsiderate kete situatë, Sherbimi Social Shtetëror synon zgjerimin e spektrit të shërbimeve të ofruara, nxitjen e tipologjive dhe alternativave të reja, duke u fokusuar në menyre me të ndjeshme në plotësimin e nevojave sociale të kategorive të femijeve në nevojë.

17. Kategorite sociale te femijeve te fokusuar ne veprimtarine e Sherbimit Social Shtetëror per perkujdesje dhe mbrojtje sociale jane:

- ? Femijet jetime dhe te braktisur.
- ? Femijet e paafte (mendore dhe fizike).
- ? Femijet viktime te dhunes, keqtrajtimit dhe abuzimit seksual.
- ? Femijet/minoret viktime te prostitucionit dhe droges.
- ? Femijet te riadhesuar (te larguar pa prinder ne emigracion).
- ? Femije te rruges.

18. Sherbimi Social Shtetëror administron rrjetin e Institucioneve të Perkujdesit Shoqëror (22 institucione), nepermjet te cilit ofrohen shërbime dhe perkujdesje per te moshuarit e vetmuar, per femijet jetime dhe me aftesi te kufizuara. Trajtimi institucional i femijeve kryesisht ofrohet si shërbim klasik rezidencial.

19. Aktualisht funksionojne 15 Institucione Rezidenciale per femijet, nga te cilat:

- 5 Shtëpi të foshnjës (0-3 vjeç),
- 2 Shtëpi të femijeve parashkollore (3-6 vjeç),
- 3 Shtëpi të femijeve shkollore (6-14 vjeç),
- 5 Qendra të Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Femijeve të Paafte,

Per trajtimin e nevojave te femijeve me paaftesi zhvillimi funksionojne edhe 2 Qendra Ditore.

20. Per plotësimin e nevojave sociale të këtyre kategorive të femijeve të rrezikuar, krahas strukturave të shërbimit social shtetëror (të cilat duhet të jenë të kufizuara në kapacitete dhe tipologji). Një kontribut të rëndësishëm po japin OJQ, vendase dhe të huaja, të cilat kanë sjelle ndryshime çësore jo vetëm në konceptimin por edhe në strukturën e shërbimeve të ofrura, duke nxitur forma dhe alternativa të reja të shërbimit social.

21. Sherbimi Social Shteteror, ne bashkepunim me sektorin joqeveritar ka nxitur ngritjen e modeleve te reja te sherbimit per femijet dhe shperndarjen e ballancuar te tyre ne perputhje me nevojat aktuale. Te tilla sherbime si Shtepi Familjeje apo Fshatra Femijesh jane ngritur dhe funksionojne ne Tirane, Shkoder, Elbasan.

22. Me gjithe ndryshimet pozitive te realizuara ne fushen e politikave te mbrojtjes sociale, per kategorite ne nevoje te femijeve, problematikat e mprehta dhe nevojat e shumeanshme te identifikuara ne kete sektor, kane shtruar nevojten e kalimit ne nje stad te ri, me cilesor, duke nxitur dhe promovuar politika dhe sherbime sociale me efikase, me cilesore dhe gjitheperfshirese, me synimin e parandalimit, trajtimit dhe riintegrimin te femijeve ne jeten normale. Strategjia e zhvillimit te sherbimeve sociale per femije orientohet nga ideja e krijimit te nje game te gjere sherbimesh, te decentralizuara dhe shtrira ne komunitet, me prane perfituesve dhe ne perputhje me nevojat e tyre specifike.

23. Strategjia e zhvillimit te sherbimeve sociale per femijet ne nevoje eshte pjese perberese dhe komponent esencial ne strategjine e pergjithshme per mbrojtjen sociale te grupeve vulnerabel te popullsise. Strategjia synon mbrojtjen e interesave me te larta personale te femijes, ku perfshihet ne rradhe te pare perkujdesi, mirerritja dhe zhvillimi i tij. Ne kategorite e femijeve te rrezikuara, me te fokusuara jane kategorite e femijeve jetime (biologjike dhe sociale), te femijeve me paaftesi mendore dhe fizike dhe femijet e abuzuar e keqtrajtur, si rezultat i trafikimit, abuzimit seksual dhe pjesemarrjes ne format e keqjaja te punes etj.

24. Ne te ardhmen do te synohet qe mbrojtja sociale e femijeve, krahas perkujdesit ne Qendra te tipit rezidencial, te mbeshtetet ne forma te larmishme, duke i dhene perparesi trajtimit ne ambientet sociale natyrale (shtepi, komunitet).

25. Linja kryesore e zhvillimit te sherbimeve sociale per femije do te karakterizohet nga:

- ? Deinstitutionalizimi i klienteve.
- ? Decentralizimi i sherbimeve.

26. Zhvillimi i metejshe i sherbimeve per femijet do te konsistoje ne dy forma:

- ? Trajtimi i perkohshem ne institucione rezidenciale (institucione te perkujdesit social, qendra zhvillimi),
- ? Trajtimi jorezidencial (modele dhe regjime te reja me prane perfituesve) duke iu dhene perparesi te dytave pasi jane me prane ambientit natyral te femijeve ne nevoje, me te arritshme dhe te prekshme nga perfituesit si dhe me pak te kushtueshme. Trajtimi rezidencial i femijeve ofrohet si alternative e fundit, veçanerisht per femijet jetime, biologjike dhe sociale, femijet me paaftesi mendore dhe fizike me shkalle te larte paaftesie. Realizimi i objektivave te percaktuara ne strategjine e zhvillimit te sherbimeve sociale dhe mbulimi i nevojave sociale te grupeve vulnerabel jane te lidhura ngushte me projektin e konsiderueshem te Bankes Boterore "Shperndarja e Sherbimeve Sociale ne Shqiperi".

27. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe SHSSH, si institucioni përgjegjës për zbatimin e politikës në fushën e shërbimeve sociale, me mbështetjen e Bankës Botërore dhe të donatoreve të tjerë, kanë filluar tashmë implementimin e projektit “Shpërndarja e Shërbimeve Sociale” thelbin e të cilit e përben përgatitja e terrenit dhe ndërtimi i kapaciteteve për kalimin, nga shërbimet e mbyllura, të tipit rezidencial, në shërbime moderne, të decentralizuara dhe të shtrira në komunitet, duke rritur pjesëmarrjen në këtë proces të qeverive lokale, komunitetit dhe shoqërisë civile.

28. Projekti do të kontribuojë në përmirësimin e standardeve të jetesës dhe riintegrimin e grupeve dhe kategorive sociale të marginalizuara, nëpërmjet nxitjes së shërbimeve komunitare dhe pjesëmarrjes së tyre në përcaktimin e prioritetëve dhe vendim-marrje.

29. Në kuadër të këtij projekti, krahas trajtimit të grupeve të tjera sociale si të moshuar të vetmuar, gra në nevojë, të rinj të droguar, të papunë etj., do të nxiten shërbime të reja me baza komunitare edhe për trajtimin e kategorive të ndryshme të femijëve të rrezikuar. Nëpërmjet këtij projekti hidhet një hap i rëndësishëm në zgjerimin e gamës së shërbimeve për trajtimin e nevojave dhe mbrojtjen e femijëve të rrezikuar.

30. Duke marrë në konsideratë eksperiencën e OJQ-ve në fushën e shërbimeve sociale, synimi është kalimi në shërbime të integruara, brenda komunitetit dhe në familje, duke bashkëpunuar dhe koordinuar burimet, mjetet dhe nderhyrjet e ofrura nga shteti, pushteti lokal dhe rrjeti i OJQ-ve. Në këto aktivitete do të bashkëpunohet ngushtë me pushtetin lokal, i cili do të evidentojë personat të cilët kanë nevojë për shërbime sociale, dhe me pas, specialistet e kësaj fushe do të vendosin për alternativat që u përshatën femijëve të rrezikuar.

31. Synimi i strukturave të Shërbimit Social Shtetëror është që, në partneritet me shoqërinë civile, pushtetin vendor dhe sektorin e OJQ-ve, gjatë viteve 2000-2005 të aplikohen alternativat e mundshme për të zhvilluar me tej shërbimet sociale për femije, duke u fokusuar në këto drejtime:

- Qendra ditore për mbështetje dhe trajtim psikosocial, edukim dhe keshillim të kategorive të femijëve të rruges, femijëve të abuzuar dhe keqtrajtuar, femijëve që rrezikojnë të braktisin shkollën.
- Qendra pritëse (strehëza) për pritjen dhe strehimin e perkohshëm të femijëve të riadhesuar, të larguar pa prinderit në emigracion, minorenet viktime të prostitucionit, etj.
- Qendra rehabilitimi për femijet dhe të rinjtë e droguar dhe të alkolizuar, për trajtimin psikosocial, keshillim, formim profesional, rehabilitim dhe riintegrim në jetën normale.
- Shtëpi-familje dhe Qendra Ditore për trajtimin e femijëve handikape dhe jetime, të cilët lenë institucionet e perkujdesit, për femijet që vijnë nga familje me probleme sociale etj.

- Qendra keshillimi ligjore per probleme juridike, te mbrojtjes se te drejtave te femijeve jetime ose me probleme sociale.
- Qendra polivalente, te cilat ofrojne nje game te gjere sherbimesh si keshillim, konsulence juridike, mbeshetje psikosociale, asistence ne familje, kurse formimi, trajnimi, informacioni asistence per zgjidhjen e situatave te jashtezakonshme te personave ne rrezik, ne vuajtje etj.
- Kujdestaria, e cila eshte nje nga zgjidhjet me optimale per femijet te cilet jetojne ne familje me probleme sociale dhe ekonomike, ose per femije te lindur jashte martese, nenat e te cileve kane probleme ekonomike dhe konflikte me familjet e tyre te origjines. Sistemimi i tyre ne nje familje, e cila eshte e gatshme t'i mireprese dhe t'i mbaje ne gjirin e saj per aq kohe sa familjet dhe prinderit kane keto probleme, eshte nje alternative e vlefshme dhe me e natyrshme per femijet.
- Biresimi si alternativa me e mire per femijet e braktisur dhe me prinder te panjohur.

32. Per te rritur efektivitetin e partneritetit shtet - shoqeri civile ne drejtim te permiresimit dhe zhvillimit te sherbimeve sociale per femijet ne nevoje, bazuar ne legjislacionin perkates, do te nxitet:

? Krijimi prane njesive te qeverisjes vendore i departamenteve te perkujdesit per femije.

? Ngritja e qendrave te sherbimit social ne qytetet kryesore te vendit per drejtimin e institucioneve te kujdesit rezidencial per femijet, dhe harmonizimi i sherbimeve, lehtesimi i bashkepunimit me te gjitha aktoret qe veprojne ne fushen e kujdesit dhe zhvillimit te femijeve.

? Permiresimi i legjislacionit ne fushen e sherbimeve sociale, per te siguruar mbrojtjen me te mire te te drejtave te femijeve/minoreneve ne nevoje.

33. Permiresimi i metejshem i legjislacionit ne fushen e mbrojtjes sociale te femijeve sigurisht do te reflektoje kerkesat dhe standartet e Dokumentave te rendesishem nderkombetare si Konventa per Mbrojtjen e te Drejtave te Femijeve, Karta Sociale Europiane e Rishikuar dhe te instrumentave te tjera te ratifikuara nga shteti shqiptar.

34. Disa nga masat me imediate qe do te ndermerren ne kete drejtim jane:

? Miratimi i Kodit te ri te Familjes ku do te gjejne rregullim te gjitha problemet qe kane te bejne me kujdestarine dhe femijet e braktisur.

? Krijimi i Gjykates se te Miturve dhe strukturave te policise per ceshtjet e mbrojtjes se te drejtave te femijeve.

? Rishikimi i ligjit qe trajton problemet e femijeve jetime, per biresimet dhe vendosjen e detyruar e te perkoheshme te femijeve jetime ne institucionet e perkujdesit social, dhe

- Ngritja dhe fuqizimi i nje sistemi te plote informacioni per grumbullimin e te dhenave per problematikat e femijeve te rrezikuar, mbi bazen e te cilave, te mund te perpunohen objektiva, programe dhe projekte efikase te zhvillimit te sherbimeve sociale.
- Vendosja e punonjesit social ne institucione te tilla si shkolla, qendra shendetesore, burgje te minoreneve dhe prane komuniteteve ne funksion te parandalimit, diktimit te hershem te problemeve qe cenojne te drejtat e femijeve si dhe mbeshtetjes se strukturave perkatese per trajtimin e nevojave sociale te femijeve sipas standarteve bashkekohore.
- Zevendesimi gradual i shtepive rezidenca te femijeve, me institucione me te vogla si Shtepi-Familje, Fshatra SOS, etj.
- Perkrahe ekonomike dhe sociale per familjet ne nevoje, vecanerisht per vajzat-nena dhe grate kryefamiljare me femije te mitur, si mase parandaluese ne uljen e numrit te femijeve te abandonuar, te keqtrajtuar dhe shfrytezuar.
- Hartimi i nje plani kombetar per te luftuar shfrytezimin seksual te femijeve me objektiv parandalimin, mbrojtjen, mjekimin, kujdesin dhe bashkepunimin rajonal (eshte duke u hartuar strategjia antitrafik).

35. Ne Shqiperi ka nje rrjet te gjere dhe te zhvilluar OJQ-sh te cilat zhvillojne aktivitetin e tyre duke u perqendruar kryesisht tek femijet dhe te drejtat e tyre. Procedurat per ngritjen dhe formimin e nje OJQ-je jane te percaktuara me Kodin Civil te Republikes se Shqiperise. Keto dispozita jane te vetmet lidhje ndermjet Shtetit dhe ketyre OJQ-ve, pasi aktiviteti i tyre ne vijim eshte teresisht i pavarur. Me poshte paraqitet nje liste OJQ-ve me veprimtari me te zgjeruar, si dhe drejtimet kryesore te punes se tyre:

- 1- Qendra per Mbrojtjen e te Drejtave te Femijeve ne Shqiperi - kryesisht eshte e fokusuar ne mbrojtjen e te drejtave te femijes.
- 2- Shoqata "Miqte e Femijeve te Talentuar" - kryesisht e fokusuar ne fushen e femijeve te talentuar dhe kultures.
- 3- Shpresa e Femijeve te Tiranës - nje OJQ vendore qe ne qender te punes ka permiresimin e kushteve te jeteses se femijeve te braktisur.
- 4- Unioni Kombetar per te Drejtat e Njeriut ne shkollat e mesme.
- 5- Shoqata e Jetimeve Shqiptare - shoqate ne nivel kombetar qe ka ne fokus te punes se saj punen me jetimet e mitur qe punojne, grate etj.
- 6- Mesuesit e te Drejtave te Njeriut - shoqate vendore nga qyteti i Vlores qe si objekt te punes se saj ka mesimin e te drejtave te njeriut ne shkolla.
- 7- Klubi i piktoreve te vegjel "Zemra e Liqenit"- shoqate vendore e fokusuar ne ndihmen ndaj te miturve nga 8-14 vjec per zhvillimin e dhuntive te tyre per pikturen.

- 8- Unioni Shqiptar i Marionetave dhe Teatrove per Femije dhe te Rinj - i perqendruar ne dhenien e shfaqjeve ne kopshte dhe shkolla.
- 9- Duke i Sherbyer se Ardhmes - shoqate vendore e orientuar ne fushen e mbrojtjes se te drejtave te femijes.
- 10- Ndhime per Femijet - shoqate vendore per mbrojtjen e te drejtave te femijeve te braktisur ne qytetin e Korces.
- 11- Femijet Tane - shoqate vendore (Burrel) qe perpiqet ne bashkepunim me prinderit te ndihmoje ne rikthimin e femijeve te larguar nga shkolla.
- 12- Ndhmoni Femijet - nje shoqate vendore (Lac) e cila eshte fokusuar ne fushen e punes, arsimit, shendetit dhe problemeve social - ekonomike te femijeve.
- 13- Organizata e Librit per Femije dhe te Rinj - Shoqate vendore ne qytetin e Tiranës per inkurajimin e femijeve ne lexim, shkembim kulturash, tolerance dhe bashkepunim ndermjet gjenerates se re ne Tirane.
- 14- Shoqata e Tirana Basket - Shoqate vendore (Tirane) qe ka si synim mesimin e minibasketit femijeve.
36. Pervec shoqatave te permendura me siper ekziston edhe nje rrjet OJQ-sh te cilat nuk kane ne qender te punes se tyre punen me femijet dhe problemet e tyre, por te cilat ndermarrin here pas here projekte dhe aktivitete per femijet.
37. Si te tilla mund te permendim, Keshillin Rinor Shqiptar, Forumin e Pavarur te Gruas Shqiptare, Shoqaten e Gruas Refleksion, Ne dobi te Gruas Shqiptare, Organizaten Mbrojtja e Gruas dhe Femijes, Familja ne Fokus, Gra pa mbeshtetje, Nena, Femija dhe e Ardhmja, Realitetet dhe Vizionet e Gruas etj. Duhet te theksohet se OJQ-te qe veprojne ne fushen e te drejtave te femijes kane pikat e tyre te forta sic jane vullneti dhe devocioni, puna vullnetare, njohja e mire e rrethanave per femijet ne Shqiperi etj. Dobesite e tyre vihen re vihen re ne strategjite akoma te paqarta, gjetja e fondeve dhe bashkepunimi ndermjet tyre, si dhe bashkepunimi me autoritetet shteterore. Me shume duhet te behet ne drejtim te permiresimit te metodave te punes, anetaresise, ambienteve te punes dhe pajisjeve.
38. Ministria e Punes dhe e Çeshtjeve Sociale, Komiteti Gruaja dhe Familja, Ministria e Arsimit, Ministria e Pushtetit Lokal, bashkepunojne me OJQ -te qe veprojne ne fushen e te drejtave te femijes ne projekte te ndryshme ne interes te te drejtave te femijeve.
39. Ne kete kuader funksionojne 10 institucione te administruara nga fondacione dhe shoqata qe kane kontrate me Ministrine e Punes dhe Sherbimin Social Shqiptar:
40. Lidhur me personelin qe punon ne institucionet e perkujdesit per femije i kushtohet nje rendesi mjaft e madhe pergatitjes se tyre profesionale. Per marrjen e tyre ne pune ka kritere te percaktuara lidhur me figuren profesionale dhe morale te

personave qe do te punojne ne kete sektor mjaft delikat. Gjithashtu, ne menyre te vazhdueshme dhe te planifikuar zhvillohen seminare per azhornimin e tyre me metodat bashkohore per rritjen dhe edukimin e femijeve. Seminaret zhvillohen ne bashkepunim me shoqata dhe fondacione te ndryshme qe punojne per kete qellim, nga eksperte te fushave mjekesore, pedagogjike, psikologjike dhe sociale.

41. Ky bashkepunim eshte me intensiv ne projektet per femijet me nevoja specifike, sic jane femijet handikapate, invalide, per kujdestarine, vendimmarrjen e femijeve dhe femijet me probleme te varesise ndaj droges.

## **II. KUPTIMI I FËMIJËS (neni 1)**

42. Sipas Legjislacionit Shqiptar fëmijë konsiderohet qënia njerëzore e lindur gjallë deri në moshën 18 vjeç, moment kur ai fiton zotësi të plotë juridike për të vepruar.

43. Me lindjen fëmija automatikisht ka zotësi juridike, e cila e shoqëron atë gjatë gjithë jetës. Persa i perket mbrojtjes te drejtave te femijeve para lindjes se tyre, ne Kodin Civil (neni 2) parashikohet se zotesia juridike fillon me lindjen e personit gjalle dhe mbaron me vdekjen e tij. Femija kur lind i gjalle gezon zotesi juridike qe nga koha e zenies.

44. Gjithashtu ne Kodin Civil (neni 320) parashikohet mbrojtja e te drejtave pasurore te femijes, te fituara nepermjet trashegimise qe ne momentin e konceptimit te tij. Konkretisht, ne kete dispozite thuhet se ka zotesi per te trasheguar personi qe ne kohen e celjes se trashegimise eshte gjalle, ose eshte zene para vdekjes se trashegimlensit dhe ka lindur i gjalle. Nga lindja deri në 14 vjeç fëmija ka vetëm zotësi juridike. Nga mosha 14-18 vjeç ai ka zotësi të pjesshme juridike për të vepruar.

45. Numri i fëmijëve në Shqipëri është 1.396.000 nga 3.320.000 banorë që ka Shqipëria, 33% janë nën 15-vjeç dhe 40% janë nën 18-vjeç. Në bazë të Kushtetutës së Shqipërisë, fëmija si të gjithë qytetarët gëzon të drejta të barabarta me ligj. Fëmijës i njihen të gjitha të drejtat e pranuar nga Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës së Kombeve të Bashkuara.

46. Zotesine per te vepruar e fiton me ane te marteses dhe gruaja qe nuk ka mbushur moshen 18 vjec. Ajo nuk e humb kete zotesi edhe kur martesa eshte deklaruar e pavlefshme dhe eshte zgjidhur para se te mbushe 18 vjec. I mituri qe ka mbushur moshen 14 vjec, mund te kryeje veprime juridike vetem me pelqimin e meparshem te perfaqesuesit ligjor. Megjithate ai mund te beje pjese ne organizata shoqerore, te disponoje ate qe fiton me punen e tij, te depozitoje kursimet dhe t'i disponoje vete keto depozita. Kodi Civil trajton dhe proceduren e krijimit te shoqatave kur nuk percaktohet mosha, gje qe te le te kuptosh qe edhe femijet kane te drejten e tyre te organizohen ne shoqata qe i pershtaten interesave te tyre.

47. I mituri qe nuk ka mbushur moshen 14 vjec, eshte i pazoti per te vepruar. Ai mund te kryeje veprime juridike qe i pershtaten moshes se tij dhe qe permbushen aty per aty si dhe veprime juridike qe i sjellin dobi pa asnje kundershperblim. Veprimet e tjera i kryen ne emer te tij perfaqesuesi i tij ligjor. Ne fushen e se drejtes familjare ka te drejte per t'u martuar cdo femer qe ka mbushur moshen 16 vjec dhe cdo mashkull qe ka mbushur moshen 18 vjec.

Femija perfundon shkollen e detyrueshme ne moshen 14, ose 15 vjec ne varesi te moshes ne te cilen femija ka filluar frekuentimin e shkolles fillore.

48. Sipas Kodit te Punes (nenet 98, 99) mosha minimale per pune e femijeve eshte 16 vjec. Femijet nga 14-18 vjec mund te punojne ne pune te lehta gjate pushimeve shkollore. Punet e lehta dhe oraret e tyre percaktohen nga Keshilli i Ministrave.

49. Neni 100 i Kodit te Punes parashikon se vetem personat madhore mund te punesohen ne pune te veshtira, ose qe paraqesin rrezik per shendetin, ose personalitetin e tyre. Keshilli i Ministrave percakton punet e veshtira, ose te rrezikshme.

50. Femijet nuk mund te rregjistrohen vullnetarisht per kryerjen e sherbimit ushtarak. Ligji "Për shërbimin ushtarak" Nr. 7527, date 2.11.1991 parashikon se me mbushjen e moshes 18 vjec shtetasit mund te rekrutohen per kryerjen e sherbimit ushtarak.

51. Sipas Kodit të Procedurës Civile (neni 356), femijet mund te deshmojne para gjykates me mbushjen e moshes 10 vjec.

52. Femija ka pergjegjesi penale me mbushjen e moshes 14 vjec per veprat penale dhe 16 vjec per kundravajtjet penale. Te miturit nen 18 vjec te denuar me burgim nuk mund te marrin me shume se gjysma e denimit te parashikuar per te rriturit (neni 51 i Kodit Penal).

## **PARIME TE PERGJITHSHME (nenet 2, 3, 6 paragrafi 1 dhe neni 12).**

### A. Mos-diskriminimi (neni 2)

53. Ne Kushtetuten shqiptare te vitit 1998 (neni 18) thuhet se askush nuk mund te diskriminohet padrejtesisht per shkaqe te tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose perkatesia prinderore.

54. Kushtetuta dhe dispozitat e tjera ligjore ne fuqi ne Republiken e Shqiperise i garantojne cdo femije, jo vetem atyre rezidente ne juridiksionin e shtetit perkates, me qendrim te perhershem ne Shqiperi, por edhe femijeve me qendrim te



perkohshem si dhe vizitoreve, ose per cdo arsye tjeter qofte, te drejtat e meposhtme:

- E drejta për të mos u diskriminuar- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 18.
- E drejta e jetës - Kushtetuta neni 21.
- Mbrojtja e veçantë nga shteti - Neni 54 i Kushtetutës.
- Mosdiskriminimi i fëmijës - paragrafi 2 i nenit 54 te Kushtetutes. Në paragrafin 2 të nenit 54 parashikohet edhe një element tjetër i mosdiskriminimit të fëmijës dhe këtu bëhet fjalë për të drejta të barabarta që gëzojnë fëmijët e lindur jashtë martesë me ata të lindur nga martesë.
- Mbrojtja nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë - Paragrafi 3 i Nenit 54 të Kushtetutës.
- E drejta pasurore e fituar nëpërmjet trashëgimisë- Neni 320 Kodi Civil. “Ka zotësi për të trashëguar personi që në kohën e çeljes së trashëgimisë është gjallë, ose është zënë para vdekjes së trashëgimlënësit dhe ka lindur i gjallë”.
- E drejta e emrit- Neni 5 i Kodit Civil.
- Te drejten e vendbanimit- Kodi Civil, neni 13: Fëmijët kanë për vendbanim atë të prindit.
- Fitimi i shtetësisë- Ligji nr. 8442 datë 21.01.1999 "Për Shtetësinë”.
- E drejta për t'u pyetur para organeve administrative dhe gjyqësore- Kodi i Procedures Civile.
- E drejta e mbrojtjes ne punë – Kodi i Punes.
- Lirine e mendimit, te ndërgjegjes dhe besimit fetar – Neni 24 i Kushtetutes.
- E drejta e informimit - Neni 22 i Kushtetutës.
- E drejta e organizimit – Neni 46 i Kushtetutes.
- E drejta për të patur kujdes shëndetësor - Neni 55 i Kushtetutes.
- Te Drejtat dhe lehtesite ne fushen penale te parashikuara me dispozitat e Kodit Penal, te Kodit te Procedures Penale etj.

55. Shtresa të veçanta fëmijësh ne praktike kanë disa kufizime te cilat jane karakteristike per te gjithë vendet e Evropes Lindore dhe me gjere. Keto kufizime nuk e kane burimin e tyre ne diskriminimin nga ana e shtetit dhe institucioneve te tij, por lidhen me shume me mentalitetin e ketyre shtresave.

56. Fëmijët romë, përgjithësisht rrojnë në varfëri dhe kushte të vështira sociale. Pjesa më e madhe e tyre jeton në rrugë duke lypur, ndërsa në sezonin e verës një pjesë e tyre sidomos ata që banojnë në qytetet dhe zonat pranë kufirit, shkojnë në Greqi për të punuar. Në këto kushte, një pjesë e tyre, bien viktimë e prostitucionit, dhunimit fizik e moral, keqtrajtohet dhe shfrytëzohet nga rrjetet e aktiviteteve të paligjshme.

57. Në përgjithësi fëmijët romë nuk frekuentojnë rregullisht shkollën, nuk zbatojnë kushtet e detyrimit shkollor dhe për rrjedhojë, karakterizohen nga një

nivel i lartë analfabetizmi. Përveç kësaj problemet ndaj të cilave janë të ekspozuar fëmijët romë janë varfëria, të punuarit në moshë të mitur, abuzimi dhe shfrytëzimi për prostitucion, lypësi, vjedhje etj.

Ne këte kuader janë ndërmarrë masa edhe në bashkëpunim me OJQ-te, në drejtim të kthimit të kësaj kategorie fëmijesh në procesin mesimor dhe integritet të tyre.

58. Gjate periudhes së rregjimit komunist fëmijet diskriminoheshin për shkak të bindjeve ose opinionëve të shprehura nga prinderit e tyre ose të afërm të tjerë të familjes. Format e diskriminimit ishin nga më të ndryshmet duke filluar nga internimet deri tek mohimi i të drejtës për t'u arsimuar.

59. Legjislacioni shqiptar nuk parashikon ndonjë dispozitë të veçantë lidhur me mosdiskriminimin e fëmijëve për shkak të pozitës, veprimtarive, opinionëve të shprehura ose bindjeve të prindërve të tij, etj. Gjate periudhes 1992-2000 nuk janë konstatuar diskriminime të fëmijëve për shkaqet e mesipërme.

60. Procesi i zhvillimeve demokratike në Shqipëri u shoqërua me kriza të mëdha politike, institucionale, ekonomike dhe psikologjike. Në këte kuader u shfaq një formë e re diskriminimi për shkak të pozitës së prindërve. U rishfaqën vrasjet në seri për shkak të gjakmarrjes dhe hakmarrjes dhe si pasojë, përveç të tjerash ngujimin e shumë fëmijëve në "burgun shtëpiak" dhe braktisjen e shkollës. Gjendja paraqitet veçanërisht e vështirë në rrethet e veriut të vendit.

61. Në këtë drejtim është punuar intensivisht nga institucionet perkatese për përcaktimin e gjendjes, strukturën dhe shpërndarjen gjeografike të vrasjeve për hakmarrje e gjakmarrje, me qëllim hartimin e strategjisë për zonat më të prekura dhe përparësitë e punës. Përveç evidentimit të rasteve të gjakmarrjes dhe hakmarrjes rëndësi ka patur edhe përcaktimi i tyre si raste të vjetra dhe të reja, pasi këto të fundit paraqesin një rrezikshmëri më të madhe dhe çojnë në një numër më të madh ngujimesh, ndërkohë që vrasjet e vjetra për gjakmarrje paraqesin më shumë mundësi për pajtim.

62. Në këte kuader janë përfshirë edhe misione me përfaqësues të pleqësive të fshatrave, që merren me pajtimin e gjaqeve në zona të ndryshme si dhe përfaqësues të ligjit, pa përjashtuar shoqatat, që merren me këto probleme, por sidomos shkollën.

63. Këto misione synojnë gjetjen e shkaqeve që çuan në gjallërimin e kësaj dukurie, në këto kohë, disa prej të cilave janë: mosrespektimi i ligjit; mosfunksionimi si duhet i aparatit shtetëror; migrimi i popullsisë në përmasa të mëdha dhe tërësisht të pakontrolluar, madje jo vetëm në shkallë vendi, por edhe në shkallë krahine duke pasur parasysh rrethanat historike, politike, shoqërore, kulturore, psikologjike të popullsisë.

## B. Interesi më i lartë i fëmijës (neni 3)

64. Neni 54 të Kushtetutës garanton të drejtën e fëmijëve të kenë një mbrojtje të veçantë nga shteti. Në këtë kuadër institucionet publike dhe private të mbrojtjes sociale, gjykatat dhe autoritetet administrative në vendimet e tyre kanë parasysh interesin më të lartë të fëmijës.

65. Parimi i interesit më të lartë të fëmijës gjen pasqyrim të plotë në Kodin e Familjes (neni 48), ku thuhet se biresimi bëhet në interes të të biresuarit, dhe në Ligjin Nr. 7650, dt. 17.12.1992 "Për biresimin e të miturve nga shtetas të huaj dhe për disa ndryshime në Kodin e Familjes" (neni 1) ku thuhet se biresimi lejohet vetëm në rast se është në interesin e lartë të të miturit dhe garanton respektimin e të drejtave të tij themelore. Gjithashtu, në Kodin e Familjes (neni 64) ku bëhet fjale për marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve thuhet se e drejta prinderore ushtrohet vetëm në interes të fëmijës së mitur dhe me marrëveshje ndërmjet dy prindërve.

66. Pas viteve 90-të vihet re një praktikë gjyqësore që deri diku nuk i përgjigjet maksimalisht interesit më të lartë të të miturit. Kjo sidomos në rastet e divorcive kur fëmija ose fëmijet i lihen për rritje dhe edukim një ose të dy prindërve, ku disa here shihen me tepër interesat e prindërve se sa të fëmijëve, ose në rastet e detyrimit ushqimor, ku shpesh here fëmijet nuk marrin shumën e nevojshme për edukimin, arsimimin, dhe mirëritjen e tyre. Me Kodin e Procedurës Civile (neni 354 paragrafi 2, dhe neni 357) parashikohet që gjykata e marrë vendimin e saj për emërimin e kujdestarit të të miturit ose zëvendësimit të tij, duke patur parasysh interesin e të miturit.

67. Projekti i Kodit të Familjes, në pjesën e dispozitave të përgjithshme, parashikon edhe parimin e interesit më të lartë të fëmijës. Sipas Projektit, prinderit, organet kompetente dhe gjykatat në vendimet dhe aktivitetin e tyre, duhet të kenë si konsideratë paresore interesin më të lartë të fëmijës. Gjithashtu, në kreun për biresimin është theksuar se biresimi lejohet vetëm në rast se është në interesin e lartë të të miturit dhe garanton respektimin e të drejtave të tij themelore. Projekti i Kodit të Familjes, për rastet e caktuara, parashikon detyrimin e gjykatës që për marrëdhënie të veçanta, të këtu në konsideratë interesin e të miturit. Kështu, në kreun mbi autoritetin prinderor, në rastet kur fëmija largohet nga prinderit dhe mbahet padrejtesisht nga persona të tjerë, prinderit mund të kërkojnë nga gjykata dorëzimin e fëmijës së mitur. Sipas Projektit, gjykata mund të mos vendosë kthimin, neqoftese kjo vjen në kundërshtim me interesat e të miturit. Gjykata merr edhe mendimin e fëmijës, kur ka mbushur moshën 10 vjeç.

68. Në rastin e administrimit të pasurisë të të miturit, Projekti parashikon tjetërsimin e pasurisë së tij vetëm kur e kërkon interesi i të miturit. Për here të parë Projekti parashikon rastin kur të dy prinderit nuk bien dakord për atë që kërkon interesi i fëmijës, atëherë mund të drejtohen gjykatës, e cila vendos, pasi është përpjekur të zgjidhë çështjen me pajtim.

### C. E drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit (neni 6)

69. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 21 të saj shprehet se jeta e personit, (ku përfshihen edhe fëmijet) mbrohet me ligj.
70. Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Paktin Nderkombëtar lidhur me të Drejtat Civile dhe Politike ku respektivisht në nenin 2 dhe 6 është parashikuar e drejta për jetën.
71. Një e drejtë tjetër e lidhur me jetën është dhe ajo e zhvillimit të fëmijës. Për shembull në ligjin Nr. 8528 të vitit 1999 "Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gjë". Prodhuesit detyrohen që etiketat e prodhimit të ushqimeve për fëmijë të përmbajnë formulimin "ushqimi i gjirit është ideal për ushqimin e fëmijës"
72. Një problem i diskutueshëm lidhur me të drejtën e pamohueshme për të jetuar të fëmijës është dhe aborti. Deri në vitin 1995 aborti vullnetar nuk ishte lejuar ligjrisht në Shqipëri. Me 7 dhjetor 1995, u miratua nga Kuvendi Popullor Ligji Nr. 8045, "Për nderprerjen e shtatzanisë". Megjithatë në nenin 1 të tij parashikohet se Ligji garanton respektimin e çdo qenie njerëzore që në fillim të jetës, jepen përjashtimet se ky parim mund të shkelet kur është e domosdoshme dhe në kushtet e përcaktuara në këtë Ligj. Ligji "Për nderprerjen e shtatzanisë", garanton respektimin e çdo qenie njerëzore që në fillim të jetës së tyre, pra që në fazën e konceptimit të tyre. Nderprerja e shtatzanisë lejohet vetëm për arsye shëndetësore (nena dhe fëmija) dhe për arsye psikosociale. Në rastin e një shtatzanie jashtë martesore të të miturave deri në 16 vjeç, nderprerja e shtatzanisë bëhet me miratimin e prindit ose kujdestarit ligjor. Përveç rasteve të nderprerjeve të shtatzanisë për arsye shëndetësore, lejohet dhe nderprerja vullnetare me kërkesën e nënes.

## **LINDJET DHE ABORTET BIRTHS AND ABORTIONS**

### **Vitet – Years 1994-2000**

Vitet Years	Abortet Abortions
1994	31622
1995	31874
1996	32538
1997	22103
1998	18944
1999	19930
2000	21004

Burimi: INSTAT

73. Seksioni V i Kodit Penal "Vepra Penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatëzanisë ose mosdhënia e ndihmës" neni 93 "Ndërprerja e shtatëzanisë së gruas pa pëlqimin e gruas", parashikon se duke përjashtuar këtu rastet e justifikuara të mbrojtjes së shëndetit të gruas, kjo veper dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

74. Kodi Penal parashikon dispozita të posacme që synojnë të mbrojnë të drejtën e femijes për të jetuar. Neni 81 i Kodit Penal "Vrasja e Foshnjës" bën fjalë për vrasjen me dashje të foshnjës nga nëna, menjëherë pas lindjes. Në këtë rast kemi të bëjmë me kundërvajtje penale dhe kundërvajtësja-nëna dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

75. Kodi Penal në kreun II "Vepra penale kundër personit", "Kryeveprimet kundër jetës", në Nenin 79 "Vrasja me dashje për shkak të cilësive të veçanta të viktimës" gërma a), parashikon një masë dënimi për vrasjen e të miturit nën 16 vjeç me burgim të përjetshëm.

76. Në Shqipëri ka një dallim në trajtimin e femijes me ushqim ndërmjet zonave urbane dhe atyre rurale. Por, diferenca ndihet sidomos midis zonave malore dhe atyre fushore. Në zonat malore kushtet ekonomike të familjeve janë shumë më të vështira dhe për shkak të terrenit të vështirë, kështu që femijet të cilët jetojnë në këto zona kanë një trajtim jo të mirë të të ushqyerit, gjë që sjell si pasojë dhe një vdekshmëri më të lartë të femijes në raport me zonat e tjera.

#### D. Respektimi i mendimit të fëmijës (neni 12)

77. Legjislacioni shqiptar, institucionet e shtetit dhe komuniteti e konsiderojnë fëmijën si një qenie që merr pjesë aktive, progresivisht në përputhje me intelektin e tij, në organizimin dhe rrjedhën e jetës së tij dhe të ambjentit që e rrethon. Kështu, sipas Kodit të Procedurës Civile (neni 356), fëmija mund të pyetet, ose të merret në konsideratë mendimi i tij, kur ka mbushur moshën 10 vjeç. Por, aftësia për të pasur mendimin e tij konsiderohet se ndryshon në funksion të zhvillimit të femijes, të aftësive të tij për të kuptuar ngjarjet që e prekin atë, natyrën dhe shkallën e rëndësisë së çështjes konkrete.

78. Në Kodin e Familjes (neni 66 dhe 70), në rastin kur prinderit për arsye të ndryshme nuk jetojnë bashkë, por nuk janë të divorcuar, vendos Këshilli i Kujdestarise se me cilin prind do të jetojë fëmija, dhe në qoftese fëmija ka mbushur moshën 10 vjeç, duhet të marrë dhe mendimin e tij. Në rastin e zgjidhjes së martesës, gjykata zgjidh edhe çështjen se cilit prind do t'i besohen femijet për rritje dhe edukim. Kur fëmija ka mbushur moshën 10 vjeç Këshilli i Kujdestarise merr në konsideratë edhe mendimin e tij (neni 97).

79. Në Ligjin Nr. 7650, datë 17.12.1992 "Për biresimin e të miturve nga shtetas të huaj dhe për disa ndryshime në Kodin e Familjes parashikohet e drejta e të miturit që të japë mendimin e tij për biresimin, në qoftese ka mbushur moshën 10 vjeç. Pra, në rastin e biresimit merret mendimi i të miturit që në fazën e

procedures administrative (neni 7). Gjithashtu, edhe gjate procedures gjyqesore, nese femija ka mbushur moshen 10 vjeç, merret edhe pelqimi i tij (neni 54). Sipas Kodit te Familjes, ne rastin kur Keshilli i Kujdestarise emeron kujdestarin duhet te marre edhe mendimin e te miturit qe ka mbushur moshen 10 vjeç (neni 105).

80. Kodi i Procedures Civile, konform nenit 12 te Konventes, parashikon te drejten e te miturit qe ka mbushur moshen 16 vjec t'i drejtohet vete gjykates per vendosjen e kujdestarise. Jo vetem me ceshtjet qe kane te bejne me marredheniet ne familje te femijes, por edhe ne rastin e fitimit ose heqjes dore nga shtetesia, merret mendimi i tij.

81. Ne Ligjin Nr. 8389, date 5.08.1998 "Per shtetesine shqiptare" thuhet se çdo ndryshim ne shtetesine e te miturve te moshes 14-18 vjeç behet duke marre edhe pelqimin e femijes (neni 5). Gjithashtu, ligji parashikon rastin kur te dy prinderit fitojne shtetesine shqiptare me natyralizem, femija i tyre, nen moshen 18 vjeç, kur jeton me prinderit, behet shtetas shqiptar me kerkesen e prinderve dhe me pelqimin e femijes, nese ai eshte ne moshen 14 -18 vjeç.

82. Projekti i Kodit te Familjes, ne kete fushe ka bere nje hap te rendesishem ne percaktimin e te drejtes se femijes per tu degjuar nga gjykata dhe per tu perfaqesuar vete, me avokat ose nga perfaqesuesi ligjor i tij. Keshtu, ne pjesen e pare mbi dispozitat e pergjithshme eshte paraqitur me dy variante e drejta e te miturit per t'iu drejtuar gjykates dhe per tu degjuar prej saj ne rastet kur merren vendime qe kane te bejne me interesat e te miturit.

83. Ne variantin e pare, nuk eshte percaktuar mosha, por lidhet me aftesine e te miturit per te kuptuar dhe me zhvillimin e tij intelektual, duke mos prekur dispozitat e Kodit, qe parashikojne te drejten e femijes dhe detyrimin e gjykates te degjoje dhe te marre pelqimin e femijes, sipas ceshtjes ne gjykim. Ne variantin e dyte eshte percaktuar mosha 12 vjec si kufi per femijen qe te degjohet, te marre pjese aktive ne proces dhe te mbrohet sipas mjeteve ligjore te mbrojtjes te parashikuara ne kete Kod dhe ne Kodin e Procedures Civile. Ky percaktim ne Projektin e Kodit te Familjes merr rendesi, sidomos kur procedurat kryesore qe i interesojne femijes para gjykates jane procedurat familjare, ne vecanti ato qe lidhen me ushtrimin e te drejtes prinderore, si vendbanimi, marredheniet me prinderit, e drejta e vizites, vendosja e kujdestarise, cenimi i jetes private dhe i korespondences, mbrojtja e te drejtave pasurore, etj.

84. Shqiperia ka ratifikuar Konventen Europiane te te Drejtave te Njeriut dhe ka pranuar juridiksionin e Gjykates Europiane per te Drejtat e Njeriut, e cila pergjithesisht ka arritur ne konkluzionin se asnje vendim nuk duhet te merret kunder vullnetit te nje femije te moshes 12 vjec ne raste te vendosjes se tij ne nje familje ushqyese, te ndryshimit te emrit, te kerkeses per shtetesi, te besimit fetar, etj.

## **TE DREJTAT DHE LIRITE CIVILE (nenet 7, 8, 13, 17, 14, 15, 16, dhe 37/a)**

### A. Emri dhe kombësia (neni 7)

85. Mbrojtja e te drejtes se emrit eshte parashikuar edhe ne Kodin Civil (neni 5), sipas te cilit çdo person fizik (ku perfshihen edhe femijet) ka te drejten dhe detyrimin te kete emrin dhe mbiemrin e tij qe i vihet sipas ligjit. Personit, te cilit i mohohet e drejta e perdorimit te tyre ose cenohet nga perdorimi qe te tjeret i bejne padrejtesisht, mund te kerkoje ne gjykate perdorimin e emrit ose te mbiemrit te vet, pushimin e cenimit, si dhe shperblimin e demit perkates.

86. Ne rastet kur gjykata pranon padine, urdheron botimin e vendimit ne Fletoren Zyrtare. Ne rast se kerkohet nga paditesi, gjykata mund te urdheroje botimin e vendimit te saj edhe ne gazeta te tjera.

87. Ligji nr. 5840, date 20.2.1979 "Per gjendjen civile" rregullon menyren e rregjistrimit te femijes se sapolindur. Rregjistrimi i femijes behet ne zyrat e gjendjes civile te vendbanimit te prinderve ose ne vendin ku ka ndodhur lindja.

88. Deklarimi i lindjes duhet te behet brenda 30 diteve nga data e lindjes, dhe kur femija lind i vdekur brenda 3 diteve. Kur kane kaluar afatet perkatese rregjistrimi behet me urdher me shkrim te kryetarit te njesise administrative te vendbanimit te prinderve ose te vendit ku ka ndodhur lindja pasi te kete vertetuar daten e lindjes. Deklarimi per lindjen e femijes behet nga prinderit e femijes te cilet i caktojne nje emer. Kur kete nuk kane mundesi ta bejne prinderit e femijes, ne mungese te tyre, te afermit caktojne emrin e femijes. Deklarimi behet nga anetaret e tjere madhore te familjes ose nga mamia kur eshte ndodhur ne lindje, ose nga institucioni shendetesor ku ka lindur femija. Lindja e femijes rregjistrohet ne rregjistrin e lindjeve.

89. Regjistrat e gjendjes civile jane: rregjistrat e lindjes, marteses, vdekjes dhe regjistri themeltar i shtetasve. Femija merr mbiemrin e perbashket te prinderve. Kur prinderit kane mbiemra te ndryshem, te gjithe femijet mbajne nje mbiemer, ate qe do te vendosin prinderit me marreveshje. Kur marreveshja nuk arrihet, femijet mbajne mbiemrin e atit. Kur ne kohen e rregjistrimit femija nuk eshte i gjalle, me pelqimin e prinderve i caktohet emri, regjistrohet me emer lindja dhe behet shenimi se ka vdekur. Kur femija ka lindur i vdekur regjistrohet pa emer dhe behet shenimi perkates ne shtyllen e verejtjeve te regjistrit. Femija i lindur jashte martese regjistrohet me emrin e tij, emrin e nenes dhe me emrin e paqene te atit, kurse mbiemer merr kurdohere ate te vajzerise se nenes. Ne rast se njihet ose vertetohet atesia, femijes i rregjistrohet emri dhe mbiemri i te atit. Femija i lindur jashte martese ne shtepine e lindjes regjistrohet ne zyrat e gjendjes civile me te afert, brenda tri diteve, nga drejtuesi i ketij institucioni, pasi ka marre pelqimin e nenes per emrin e femijes.

90. Femija i gjetur regjistrohet brenda tri diteve nga organi shteteror, ose administrata e shtepise se femijes mbi bazen e nje procesverbali te mbajtur ne kohen e gjetjes. Ne kete rast nepunesi i gjendjes civile i ve femijes, emrin dhe e regjistron me emer ati, nene dhe mbiemer te paqene.

91. Ne kete kuader situata e krijuar ne Shqiperi mbas viteve 90-te, kerkon nje rregullim me te hollesishem ligjor, pasi jane konstatuar mjaft raste ku shume ne na mbasi lindin femijet e tyre largohen pa u identifikuar ose japin emer te rreme, dhe kjo per shkak te parregullsive qe ndodhin ne maternitete si dhe ndryshimet e tjera ligjore qe kane krijuar mundesine e vendosjes se femijes edhe ne institucione jo shtetore, vendase apo te huaja.

92. Ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise (neni 19) thuhet se kushdo qe lind, duke pasur qofte edhe njerin prej prinderve me shtetesi shqiptare e fiton vetiu shtetesine shqiptare. Shtetesia shqiptare fitohet edhe per shkaqe te tjera te parashikuara me ligj. Shtetasi shqiptar nuk mund te humbase shtetesine, pervec se ne rastin kur ai heq dore prej saj.

93. Ne Ligjin Nr. 8389 date 5.08.1998 "Per Shtetesine Shqiptare" parashikohen edhe rastet e fitimit dhe heqjes se shtetesise se femijes. Sipas Ligjit (neni 5), fitimi dhe rifitimi i shtetesise shqiptare, si dhe heqja dore prej saj, nga te miturit, behet me miratimin e prinderve dhe se çdo ndryshim ne shtetesine e tyre, kur jane ne moshen 14-18 vjeç behet duke marre edhe pelqimin e femijes. Sipas Ligjit te siperpermendur mbi shtetesine, shtetesia shqiptare fitohet me lindje, natyralizim dhe biresim.

94. Fitimi i shtetesise shqiptare me lindje ndryshoi me Ligjin Nr. 8442, date 21.01.1999, sipas te cilit kushdo qe lind, duke pasur qofte edhe njerin prej prinderve me shtetesi shqiptare, e fiton vetiu shtetesine shqiptare. Ligji per shtetesine, ne perputhje me paragrafin e dyte te nenit 7 te Konventes, parashikon edhe rastet kur femija rrezikon te mbetet pa shtetesi. Sipas tij, nje femije i lindur ose i gjetur brenda territorit te Republikes se Shqiperise merr shtetesine shqiptare ne rast se ai eshte lindur nga prinder te panjohur dhe si pasoje femija do te mbetet pa shtetesi (neni 8). Ne rast se prinderit e femijes behen te njohur para se femija te kete arritur moshen 14 vjeç (pasi ne kete moshe duhet te merret edhe pelqimi i femijes), dhe ata jane me shtetesi te huaj, shtetesia shqiptare mund te hiqet me kerkese te prinderve te njohur ligjerisht me kusht qe femija te mos mbetet pa shtetesi me pas si pasoje e ketij veprimi.

95. Gjithashtu, ligji ka parashikuar edhe rastet kur nje femije lind nga prinder te huaj (me shtetesi tjeter). Ne kete rast femija mund te marre shtetesine shqiptare me pelqimin e te dy prinderve ne qofte se ploteson dy kushte:

? Se pari, te kete lindur brenda territorit te Republikes se Shqiperise dhe



? Se dyti, prinderit te jene rezidente te ligjshem ne territorin e Republikes se Shqiperise.

96. Si kusht i pare per te fituar shtetesine shqiptare me natyralizim eshte paraqitja e kerkeses se personit, qe ka mbushur moshen 18 vjeç. Pra, ne kete kategori nuk hyjne te miturit. Por, Ligji ka bere perjashtim per personat qe jane pa shtetesi, duke favorizuar ne kete rast te miturit nen moshen 18 vjeç, te cilet ne keto raste mund te fitojne shtetesine shqiptare dhe pa plotesuar kushtin e moshes dhe disa kushte te tjera te kerkuara nga ligji (neni 9).

97. Gjithashtu, femija mund te fitoje shtetesine shqiptare, me kerkesen e prinderve dhe me pelqimin e tij, kur eshte ne moshen 14-18 vjeç, ne rast se te dy prinderit fitojne shtetesine shqiptare me natyralizim.

98. Kerkesa per fitimin e shtetesisë shqiptare i drejtohet Ministrise se Rendit Publik dhe ne rast te banimit te personit jashte shtetit, ne perfaqesite diplomatike ose konsullore te Republikes se Shqiperise jashte shtetit e shoqeruar nga dokumentat e kerkuara nga ky ligj. Mbas shqyrtimit te dokumentacionit perkates, organet e siperpermendura ne qofte se vleresojne se dokumentacioni i paraqitur ploteson kerkesat e ligjit ia percjellin ate Presidentit te Republikes, i cili nxjerr dekretin perkates.

99. Ne Kushtetute (neni 23) eshte parashikuar e drejta e informacionit ne pergjithesi, ndersa ne nenin 35 i jepet e drejta kujtudo te njihet me te dhenat e mbledhura rreth tij, me perjashtim te rasteve te parashikuara me ligj.

100. Ne kuader te dy dispozitave kushtetuese te permendura me siper perfshihet dhe e drejta e femijes te marre informacion dhe te njihet me te dhenat qe disponojne organet perkatese per prinderit e tij.

101. Ceshtja e informacionit ne te drejten shqiptare shfaqet ne dy aspekte, ne ate te biresimit te te miturit dhe ne rastin kur femijet jane vendosur ne shtepite e femijes.

102. Kodi i Familjes, ndryshuar me Ligjin Nr. 7650, date 17.12.1992 "Per biresimin e te miturve nga shtetas te huaj dhe per disa ndryshime ne Kodin e Familjes", njih vetem biresimin e plote. Pra, ne rast se nje femije eshte biresuar, midis tij dhe biresuesve krijohen marredhenie te njejta si ato ndermjet prindit dhe femijes. Te drejtat dhe detyrat ndermjet te biresuarit dhe te paslindurve te tij, nga njera ane, dhe gjinise se tij nga ana tjater pushojne (neni 57). Sipas Ligjit "Per Regjistrimin e Akteve te Gjendjes Civile" ne regjistrat e gjendjes civile ruhet dhe regjistrimi i bere para biresimit. Per te ruajtur prejardhjen e vertete te femijes se biresuar, nepunesi i gjendjes civile nuk ben asnje shuarje ne gjeneralitetet e meparshme, qe ka femija i biresuar ne aktin e lindjes. Ai, ne baze te vendimit te gjykates per biresimin ben shenimet perkatese ne shtyllen e veçante te shenimeve te aktit te regjistruar te lindjes se te biresuarit. Nepunesi i gjendjes civile, te dhenat

lidhur me origjinen e femijes mund t'i jape vetem kur keto kerkohen nga gjykata ose nga organi i prokurorise sipas kerkesave te ligjit ne keto raste.

103. Praktika ka treguar se eshte akoma me e veshtire per femijet e strehuar ne shtepite e femijes dhe qe nuk i njohin prinderit e tyre. Presupozohet qe nena dihet se kush eshte, me perjashtim te femijes se gjetur, megjithate eshte teper e veshtire te sigurohet ky informacion ne shtepite e femijes. Praktika qe ndiqet ne disa raste ne matenitete, lidhur me regjistrimin e identitetit real te nenes, perben shpesh here cenim te drejtes se femijes per te njohur njerin nga prinderit, sepse parregullsite ne regjistrim i mohojne shpesh here femijes mundesine per te njohur te pakten nenen e tij.

104. Projektligji i ri per Gjendjen Civile, i cili eshte ne fazen perfundimtare te diskutimit, parashikon gjendjen civile te shtetasve shqiptare me banim te perhershem jashte vendit, si dhe te shtetasve te huaj dhe te personave pa shtetesi. Ne kuptim te projektligjit, familja perbehet nga persona te cilet vullnetarisht figurojne bashkerisht ne dokumentat e sherbimit te gjendjes civile.

105. Marredhenie familjare, sipas projektit, prezumohen ato midis prindit dhe familjes se tij, me lindjen e personit, martesen dhe biresimin dhe mund te ndryshojne vetem ne formen e vecimit, me kerkese te personit madhor e me miratim te organit kompetent ose te gjykates. Sipas projektit, femijet e mitur ndjekin prinderit. Kur prinderit vecohen dhe nuk merren vesh per te miturit, veprohet sipas vendimit te gjykates, mbi kerkesen e secilit prind. Per efekte te rregjistrimit dhe te kuptimit te familjes, projekti parashikon se si veprohet kur femija jeton me prinderit.

106. Projektligji parashikon regjistrimin e femijes me emrin qe duan prinderit dhe ne rast se prinderit nuk bien dakord duhet t'i drejtohen gjykates, ne baze te vendimit te te ciles behet edhe rregjistrimi. Mbiemri, sipas projektit, eshte ai i prinderve dhe kur secili ka mbiemer te vecante vendosen te dy mbiemrat. Kur nuk ka baba vendoset vetem mbiemri i nenes. Ndryshimi i emrit dhe mbiemrit, sipas projektligjit, mund te behet vetem per shkaqe te arsyeshme.

107. Nje tendence tjeter, mjaft e diskutueshme ne ditet e sotme eshte dhe futja e metodave te riprodhimit artificial. Projektligji per shendetin riprodhues parashikon, ndermjet te tjerash dhe futjen, per here te pare ne Shqiperi te teknikave te reja te riprodhimit artificial. Projektligji parashikon adoptimin surrogativ, inseminimin artificial dhe lindjen eksperimentale "In vitro". Me kete projektligj merren ne konsiderate deshirat e prinderve per te zgjedhur metodat e riprodhimit. Sidoqofte nje pjese e specialisteve mendojne se zbatimi ne Shqiperi i metodës së adoptimit surrogativ është i parakohshëm, për vetë mentalitetin e shoqërisë shqiptare. Projektligji parashikon pervec te tjerash qe detajet dhe procedurat per realizimin e ketyre sherbimeve te percaktohen me akte te nxjerra nga Ministri i Shendetesise.

108. Megjithate problemet, ne rastet e fekondimit artificial jane te shumta ne raport me fekondimin natyral, duke krijuar situata te ndryshme ne disfavor te interesave te femijeve, si p.sh lindja e femijes ne mungese te prindit ligjor, i cili ekziston fizikisht ne momentin e lindjes se femijes, por qe ligji nuk i njeh as titullin dhe as te drejtat dhe detyrimet e nje babai, ekzistenca e dy nenave, ne rastin kur dy gra kane kontribuar ne lindjen e femijes. Njera eshte nena gjenetike, ndersa tjetra nena mbajtese. Projektligji ne kete rast parashikon hartimin e nje kontrate noteriale midis ciftit dhe nenes mbajtese, e cila me lindjen gjalle te femijes duhet t'ia dorezoje ciftit.

#### B. Ruajtja e identitetit (neni 8)

109. Ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise si dhe ne ligje te veçanta parashikohet e drejta e personit (ku ben pjese edhe i mituri) per te ruajtur identitetin ne elemente te veçante te tij, siç jane shtetesia, lidhjet familjare, gjuha, kultura etj. Ne Kushtetute (neni 3) jepet detyrimi i shtetit per te respektuar dhe mbrojtur identitetin kombetar, i cili ka nje kuptim me te gjere se identiteti i personit.

110. Gjithashtu, ne Kushtetute, kur behet fjale per parimet e pergjithshme te drejtave dhe lirive themelore te njeriut, parashikohet detyrimi i organeve te pushtetit publik te respektojne te drejtat dhe lirate themelore te njeriut, si dhe te kontribuojne ne realizimin e tyre. Kufizime te ketyre te drejtave mund te vendosen vetem me ligj per nje interes publik ose per mbrojtjen e te drejtave te te tjereve. Kufizimi duhet te jete ne perpjestim me gjendjen qe e ka diktuar ate (neni 17).

111. Kushtetuta, gjithashtu respekton dhe ruajtjen e identitetit nga pakicat kombetare, te cilet kane te drejte te shprehin dhe te ruajne perkatesine e tyre etnike, kulturore, fetare e gjuhesore.

112. Ne kodin Civil, qe ne kapitullin e pare te tij percaktohet e drejta e personit per te ruajtur emrin dhe mbiemrin si dhe vendbanimin e tij (neni 5 dhe 12). Ne kete Kod parashikohet gjithashtu e drejta e personit fizik per te gezuar te drejtat civile perveç perjashtimeve te caktuara me ligj.

113. Persa i perket ruajtjes se shtetesisë, si ne Kushtetute dhe ne Ligjin Nr. 8389, date 05.08.1998 "Per Shtetesine Shqiptare" garantohet ruajtja e shtetesisë shqiptare e fituar sipas ligjit. Sipas Kushtetutes, shtetasi shqiptar nuk mund ta humbase shtetesine, perveç se kur ai heq dore prej saj. Per te miturit deri ne 14 vjeç, jane prinderit ata qe vendosin per shtetesine e femijes brenda kriterëve te percaktuara me ligj. Ndersa, per femijet e moshes 14 deri 18 vjeç duhet te merret edhe pelqimi i tyre.

114. Persa i perket ruajtjes se emrit ose mbiemrit te personit, Ligji "Per rregjistrimin e akteve te gjendjes civile" nr. 5840, date 20.02.1979 ka pesuar nje ndryshim me Ligjin Nr. 7682, date 9.03.1993 "Per disa ndryshime ne ligje".

115. Sipas tij, çdo shtetas ka te drejte te kerkoje nderrimin e emrit ose te mbiemrit, duke treguar dhe shkaqet per kete nderrim, si dhe emrin ose mbiemrin qe ka zgjedhur. Vendimi per nderimin e emrit ose mbiemrit merret nga Keshilli i Komunes ose Bashkise dhe i dergohet zyres se gjendjes civile perkatese, e cila ben ndryshimet e nevojshme ne regjistrin themeltar te shtetasve.

116. Per sa i perket ruajtjes se lidhjeve familjare ne rastin e biresimit, sipas Kodit te Familjes, pushojne te gjitha lidhjet qe femija kishte me familjen e tij te origjines mbas realizimit te biresimit.

117. Projektligji per gjendjen civile percakton se per cdo pjesetar, perfshire dhe femijet, fleta familjare permban emrin, mbiemrin, numrin e identifikimit, seksin, datelindjen, vendlindjen, atesine, amesine, kombesine dhe gjendjen e raportet familjare. Sipas projektit, femija merr kombesine e prinderve me kombesi te njejte, e cila nuk mund te ndryshohet as me vendim gjyqesor, pervec kur vertetohet pasaktesia e kombesise se prinderve ose behet ndryshimi ne rruge gjyqesore i atesise ose amesise. Kur prinderit me kombesi te ndryshme nuk merren vesh, sherbimi i gjendjes civile i cakton perkohesisht ate te atit dhe perfundimisht sipas vullnetit te femijes kur behet madhor. Gjithashtu, projekti percakton kombesine e femijes se lindur jashte martesese, te te biresuarit, te femijes pa prinder dhe te femijes se lindur me metodat e fekondimit artificial. Per kete te fundit, projektligji kufizohet vetem tek femijet e lindur nga nje grua e martuar.

### C. E drejta e shprehjes (neni 13)

118. Legjislacioni shqiptar i lejon femijes te marre pjese aktive ne jeten social-kulturore duke shprehur mendimet e tij, duke marre dhe shkëmbyer informacione dhe ide.

119. Neni 22 i Kushtetutës garanton lirinë e informacionit, të shprehjes dhe lirinë e shtypit, gjithashtu garanton lirinë e radiotelevizionit.

120. Nenet 56,57,58 të Kushtetutës të cilat flasin për të drejtat social-kulturore, sanksionojnë të drejtën e kujtudo për tu informuar për gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij, të drejtën e arsimit, lirinë e krijimit artistik dhe kërkimit shkencor.

121. Ligji 8410 datë 30,09.1998 "Për radio televizionin publik e privat" shprehet në mënyrë të përgjithshme për respektimin e të drejtave të të miturve.

122. Edhe ligji nr. 8503 i vitit 1999, "Për të drejtat e informimit për dokumentat zyrtare" edhe pse nuk ka dispozitë të veçantë ku të flitet për fëmijët në nenin 2 të tij bën fjalë se të drejtën për këtë informim e kanë personat fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj. Duke qënë se fëmijët futen në kategorinë e personave fizikë rrjedh se ata kanë të drejtën e informimit. Sidoqofte, ndihet nje mungese e akteve ligjore te cilat parashikojne menytrat dhe rruget se si mund te realizohet kjo e drejte per femijet, qe eshte shume me teper specifike se te rriturit.

123. Sigurisht, femijet marrin informacion dhe shprehin mendimet e tyre nepermjet procesit mesimor, i cili parashikon se arsimi ka per mision emancipimin shpirtoror, progresin material dhe zhvillimin social te individit (neni 2). Ajo ç'ka eshte e rendesishme ne kete Ligj ka te beje me pjesemarrjen e femijeve ne komunitet, duke i krijuar mundesi te shprehe mendimet e tij dhe te kerkoje e te marre informacion per kete fushe (neni 12/2).

124. Nje rendesi te madhe ne kete drejtim ka edhe miratimi i Ligjit Nr 8503, date 30.06.1999 "Per te drejten e informimit per dokumentet zyrtare". Ligji nuk ka dispozita te vecanta per femijet, por nuk shprehet as edhe per perjashtime.

125. Ne nenin 2 te Ligjit percaktohet se me person, ne kuptim te ketij Ligji, kuptohet cdo person fizik ose juridik, vendas ose i huaj. Gjithashtu, Ligji parashikon edhe te drejten e ankimit ne rruge administrative dhe gjyqesore, ne rast te shkeljes te te drejtes se informimit per dokumentet zyrtare.

126. Ne Kushtetute thuhet se kufizime te te drejtave dhe lirive te parashikuara ne te, mund te vendosen vetem me ligj per nje interes publik ose per mbrojtjen e te drejtave te te tjereve. Kufizimi duhet te jete ne perpjestim me gjendjen qe e ka diktuar ate (neni 17).

127. Ligji 8096 "Për kinematografinë" parashikon shfaqjen e filmave në mënyrë të diferencuar sipas moshave të fëmijëve, dhe ndalimin e shfaqjes së filmave për fëmijët nga 14-18 vjec apo nën 14 vjec në orë të caktuara. Ligji ndalon shfaqjen e reklamave të cilat mund të ndikojnë në dëmtimin e shëndetit të fëmijëve, shfaqjen e reklameve me pije alkoolike në duart e fëmijëve apo që të përdoren nga fëmijët.

128. Programet e TV lidhur me femijet kanë si synim të transmetojnë emisione me karakter edukativ, arsimor, kulturor, argëtues, për forcimin e traditës kombëtare, mbrojtjes së gjuhës etnike që respekton edhe të drejtat e fëmijëve të minoriteteve. Përveç sa sipër, me Ligjin Nr 8525, date 09.09.1999, Shqipëria ka ratifikuar Konventen Europiane per Televizionin Nderkufitar. Sipas Konventes, liria e shprehjes dhe e informimit, e parashikuar dhe ne nenin 10 te Konventes per Mbrojtjen e te Drejtave te Njeriut dhe Lirive Themelore, perben nje nga parimet themelore te nje shoqërie demokratike dhe nje nga kushtet baze per perparimin e saj dhe per zhvillimin e cdo qenieje njerezore.

129. Konventa shprehet ne menyre te vecante per ta, per kufijte e transmetimit te programeve dhe te reklamave duke parashikuar dispozita kufizuese ne mbrojtje te te drejtave te femijeve. Keshtu, sipas Konventes (neni 7), te gjitha sherbimet programore, te cilat kane gjasa te demtojne zhvillimin fizik, mendor ose moral te femijeve dhe adoleshenteve, nuk do te vihen ne program kur per shkak te kohes se transmetimit dhe te marrjes, ka gjasa qe ata t'i shohin ato.

D. E drejta për informacion të përshtatshëm (neni 17)

130. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton lirinë e informacionit, të shprehjes dhe lirinë e shtypit. Gjithashtu, Kushtetuta garanton lirinë e radios dhe të televizionit dhe ndalimin e çensurës paraprake të mjeteve të komunikimit (neni 22). Në kreun, që bën fjalë për lirinë dhe të drejtat social-kulturore, megjithëse nuk shprehet direkt për fëmijet, Kushtetuta sanksionon për cilindo të drejtën të informohet për gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij (neni 56), të drejtën e arsimit, lirinë e krijimit artistik dhe kërkimit shkencor, etj (neni 57,58).

131. Ligji nr. 8410, datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” nuk shprehet për nevojat e veçanta të fëmijëve në fushën e mas-medias, por shprehet në mënyrë të përgjithshme për respektimin e të drejtave dhe interesave të të miturve. Ligji, në atë pjesë të veprimtarisë radio-televizive respekton paanëshmerisht të drejtën për informacion, bindjet politike e besimet fetare, personalitetin, dinjitetin, jetën private të njeriut, si dhe të drejtat dhe lirinë themelore të tij, përfshin edhe respektimin në mënyrë të veçantë të të drejtave, interesave dhe kërkesave morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve (neni 4,36). Sipas Ligjit, radio dhe televizioni publik transmetojnë emisione me karakter informativ, edukativ, kulturor, artistik e argetues, programe këto që midis të tjerave respektojnë dhe të drejtat e fëmijëve dhe të adoleshentëve, gjuhën dhe kulturën shqiptare, të drejtat e pakicave kombëtare, etj (neni 35,36).

132. Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit në kuadër të kompetencave të dhëna ka licensuar vetëm një televizion privat për fëmijë, JUNIOR TV, i cili transmeton vetëm filma për fëmijë dhe adoleshente, në bashkëpunim me transmetues satelitore. Në programet e transmetuesve lokale dhe kombëtare (gjithsej 40), një vend të rëndësishëm zënë programet e ndryshme për fëmijë.

133. Me poshtë paraqitet një tabelë mbi transmetuesit e licensuar televizive në territorin e Republikës së Shqipërisë, numrin e programeve për fëmijë në një javë në këto televizione si dhe ndarja e tyre sipas tematikës.

Nr.	Emri i Televizionit	Numri i programeve për fëmijë	Programe për fëmijë në %	Programe informative për fëmijë në %	Programe argetuese për fëmijë në %	Filma vizatimore në %
1.	TV Shqiptar	3	12	2	7	3
2.	TV Klan	2	8	-	4	4
3.	TV Arberia	2	10	1	5	4
4.	Vizion +	2	9	-	4	5
5.	Gjeli Tv	1	3	-	-	3
6.	TV Egnatia	2	4	-	2	2

7.	Teuta TV	2	10		8	2
8.	Tv Dardan	2	10	2	6	2
9.	Tv 2000	2	10	2	2	6
10.	Calvin Tv	1	15	-	-	15
11.	BBF Tv	1	6	-	2	4
12.	Junior Tv	Satelitor	100	-	-	-
13.	Shkodra Tv	2	6	-	4	2
14.	TV ARV	2	12	2	5	5
15.	Gramsh Tv	1	3	-	-	3
16.	Johaniter Tv	2	15	-	8	7
17.	Tv "4+"	2	7	-	5	2
18.	Onufri Tv	2	18	-	10	8
19.	Tv "6+1"	2	10	2	4	4
20.	Tv Kombi	2	7	1	4	2
21.	Tv Skampa	2	7	-	2	5
22.	Tv Puka	1	10	2	3	5
23.	Tv SOT 7	1	2	-	-	2
24.	Tv Mati	2	14	2	6	6
25.	Tv Kruja	2	7	-	4	3
26.	Tv Bulqiza	1	7	-	7	-
27.	Tv Kucova	2	10	-	5	5
28.	Tv "A.Jug"	2	7	-	4	3
29.	ERA Tv	1	8	-	8	-
30.	Real Tv	2	10	-	5	3
31.	Kukes Tv	2	8	-	4	4
32.	Alba Tv	2	11	-	4	7
33.	ATN 1	2	5	-	2	3

34.	Shijak Tv	2	5	-	3	2
35.	TNSH	2	9	-	4	5
36.	Tv Koha	1	6	-	-	6
37.	Tv Lobivizion	2	7	-	3	4
38.	Top Channel	1	5	-	-	5
39.	Tv Mirdita	2	6	-	3	3
40.	Tv Beslidhja	2	6	-	3	3
41.	Tv Kristal	2	6	-	2	4



134. Bibliotekat e shkollave vlerësohen si pjesë e rëndësishme e procesit mësimor edukativ dhe informimit në shkollë, sepse ato ndihmojnë për zgjerimin dhe konsolidimin e njohurive të programeve të lëndëve të ndryshme, si dhe për formimin e edukatës dhe të shprehive të të lexuarit, përgjithësisht për formimin kulturor të fëmijëve, në tërësi të brezit të ri.

135. Për këto arsye janë bërë përpjekje për ngritjen e bibliotekave pranë shkollave, për pasurimin e vazhdueshëm të tyre, si dhe për funksionimin normal të tyre.

136. Aktualisht pranë pothuaj të gjitha shkollave 8-vjeçare ka biblioteka. Nje numer i vogel bibliotekash kanë hapësira dhe fonde modeste librash, sidomos në disa zona rurale. Shkollat 8-vjeçare, që funksionojne bashkë me shkollat e mesme në qytete kanë biblioteka më të plota, të rregullta dhe funksionale, të sistemuara në mjedise të përshtatshme.

137. Sipas statistikave ne vitin 2000 jane 210 shkollat 8-vjeçare dhe të mesme të bashkuara. Këto dy grupe shkollash kanë rregjistruar në vitin 2000 gjithsej 296 biblioteka, me një fond mesatar titujsh prej 833 dhe me një fond të përgjithshëm prej 819.672 ekzemlarë (copë) librash.

138. Deri në vitin 1991 ka patur një fond financiar nga buxheti i shtetit për blerjen e librave të reja dhe furnizimin me to të bibliotekave të shkollave. Ky fond u riaktivizua perseri në vitin 1997 nga Ministria e Arsimit kur miratoi udhëzimin “Për trajtimin e blerjes së librit artistik për bibliotekat si mjet shkolle”.

139. Një masë tjetër favorizuese për bibliotekat është caktimi i mësuesëve të gjuhës e të letërsisë si përgjegjës për administrimin e tyre, kundrejt kompensimit me ulje të normës mësimore në klasë. Kjo parashikohet në “Dispozitat Normative për Shkollat Publike” të datës 31 Korrik 1996 të Ministrise se Arsimit dhe Shkences.

140. Persa i perket transmetimit te emisioneve ose programeve per femijet, qe i perkasin nje grupi etnik, Ligji parashikon shfaqjen e programeve ne gjuhen e pakicave kombetare qe ndodhen ne Shqiperi, respektimin e gjuhes dhe kultures se tyre dhe dhenien e informacioneve te veçanta per ta (neni 36,37,68).

141. Ligji per Radio-Televizionin dhe Ligji Nr. 8096, date 29.04.1996 “Per kinematografine” parashikojne transmetimin e filmave ne menyre te diferencuar, sipas moshave, dhe ndalimin e shfaqjes se filmave per femijet nen moshen 14 vjec dhe 14-18 vjec ne orare te caktuara (neni 43,11). Ligji kryesisht ka parashikuar ndalimin e shfaqjes se programeve te caktuara per femije, por jo llojin e programeve qe duhet te transmetoje per ti siguruar femijes informacionin dhe materialet e nevojshme qe synojne te rrisin mireqenien e tij shoqerore, shpirterore e morale, si dhe shendetin e tij fizik dhe mendor.

142. Ne vazhdim te kesaj ideje, ligji parashikon nje dispozite te veçante per mbrojtjen e te miturve, sipas se ciles nuk lejohet te jepen ne radio e televizion reklama qe nxisin sjellje, te cilat rrezikojne shendetin dhe zhvillimin normal psiqik te femijeve. Reklammat e destinuara per femijet ose kur realizohen me femije, te jene te tilla qe te shmangin çdo gje qe demton interesat dhe veçantine e moshes se tyre (neni 56).

143. Ligji ndalon, gjithashtu, shfaqjen e reklamave te pijeve alkolike per femijet si dhe paraqitjen ne reklame me pije alkolike ne duar te femijeve (neni 57).

144. Keshilli Kombetar i Radios dhe Televizionit krahas monitorimit te vazhdueshem dhe te panderprere te te gjithe programeve si ne radio dhe ne televizion, ka vene ne dispozicion te publikut te gjere nje linje telefoni, faksi dhe e-mail, ku personat fizike mund te denoncojne shperdorimin e dhunes, pornografine, ose cenimin e dinjitetit ne mediat e ndryshme elektronike.

#### E. Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë (neni 14)

145. Ne Kushtetute parashikohet se shteti eshte asnjanes ne çeshtjet e besimit dhe te ndergjegjes dhe garanton lirine e shprehjes se tyre ne jeten publike (neni 10). Gjithashtu, ne Kushtetute parashikohet se liria e ndergjegjes dhe e fese eshte e garantuar. Secili eshte i lire te zgjedhe ose te ndryshoje fene ose bindjet, si dhe t'i shfaqe ato individualisht ose kolektivisht ne publik ose ne jeten private, nepermjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes se riteve.

146. Askush nuk mund te detyrohet ose te ndalohet te marre pjese ne nje bashkesi fetare ose ne praktikat e saj, si dhe te beje publike bindjet ose besimin e tij (neni 24). Pra Kushtetuta kete te drejte ia njeh gjithesecilit, duke mos perjashtuar dhe kategorine e femijeve.

147. Ligji nr. 7952, date 21.06.1995 "Per sistemin arsimor parauniversitar", meqenese arsimi publik eshte laik, nuk lejon propaganden fetare te cilitdo besim qofte. Ne Shqiperi çeshtja e besimi fetar nuk ka paraqitur probleme edhe per faktin se per me shume se 20 vjet me radhe besimi fetar ishte i ndaluar.

148. Me Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 248, date 28.05.1999, jane percaktuar kriteret dhe procedurat e dhenies se lejes per funksionimin e institucioneve arsimore jopublike dhe te institucioneve arsimore plotesuese jopublike, ne te cilat zhvillohen lende fetare. Vendimi parashikon se subjekti privat, qe do te funksionoje si institucion arsimor jopublik, ku do te zhvillohen lende fetare, midis te tjerave duhet te paraqese edhe nje deklarate, me ane te se ciles merr persiper te respektojte Deklaraten Universale te te Drejtave te Njeriut dhe Konventen per te Drejtat e Femijes. Vendimi nuk shprehet nese duhet te merret pelqimi i femijes qe rregjistrohet ne kete shkolle, ndersa shprehet per pjesmarjen fakultative te femijeve ne veprimtarite jashte procesit mesimor, ku miratimi i prindit, kujdestarit apo i vete nxenesit eshte percaktues. Vendimi nuk parashikon se per cilen moshe eshte percaktues mendimi i prindit.

149. Me Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 459, date 23.09.1999 eshte krijuar Komiteti Shteteror per Kultet, i cili i paraqet Ministrise se Arsimit dhe Shkences mendimin e tij lidhur me planin mesimor, programet lendore dhe tekstet e pjeses jolaike per kerkesat e paraqitura per hapjen e institucioneve arsimore jopublike ku zhvillohen lende fetare.

150. Ne Kodin e Familjes jane parashikuar te drejtat dhe detyrimet qe kane prinderit ose kujdestari i tij ne drejtimin dhe edukimin e femijes. Ne kete Kod nuk parashikohet asgje e veçante per ta drejtuar femijen ne ushtrimin e te drejtes se besimit fetar, pra mund te konkludohet se femija eshte i lire ne zgjedhjen e besimit fetar, ndergjegjes etj.

151. Ne Kodin Penal parashikohet rasti kur personave qe duan te marrin pjese ne ceremonite fetare, ose qe duan te shprehin lirisht bindjet fetare, u krijohen pengesa ose u ndalohe aktiviteti. Kjo veper perben kundravajtje penale dhe denohet me gjobe ose me burgim gjer ne nje vit.

152. Duhet te theksohet se besimet fetare ne Shqiperi, gjithmone i ka karakterizuar nje ndjenje e forte dhe e sinqerte harmonie e cila reflektohet dhe ne marredheniet ndermjet personave me besime te ndryshme fetare dhe ndermjet fetareve dhe ateistev. Nuk disponohen statistika te sakta per numrin dhe perqindjen e besimtareve te cdo besimi, por sipas nje statistike te shume dekadave me pare, 50% e besimtareve rezultuan te ishin myslimane, 20% e tyre ortodokse, 20% bektashinj dhe 10% katolike.

153. Mbi bazen e lirise se ndergjegjjes dhe besimit fetar, sot ne Shqiperi, krahas kater komuniteteve fetare kryesore, veprojne edhe rreth 62 shoqata te krishtere Protestante, Evangjeliste, Adventiste, Bahai, Mormone, te ardhura kryesisht nga Evropa Perendimore dhe SHBA, si dhe shoqata bamirese fetare islamike.

154. Ne Republiken e Shqiperise, ndonese nuk ka fe zyrtare dhe ne çeshtjet e besimit e te ndergjegjjes shteti eshte asnjanes, ai njeh barazine e bashkesive fetare dhe garanton lirine e shprehjes se tyre ne jeten publike (neni 10 i Kushtetutes se Republikes se Shqiperise).

155. Diskriminimi per shkak te fese apo bindjeve fetare eshte antikushtetues (neni 18 i Kushtetutes, neni 253 i Kodit Penal). Nxitja e urrejtjes dhe grindjeve fetare perben veper penale dhe denohet me gjobe ose me burgim gjer ne dhjete vjet (Kodi Penal, neni 265).

156. Gjithashtu, ne Seksionin X te Kodit Penal, ne nenet 131,132 dhe 133, shkaterrimi ose demtimi i objekteve te kultit dhe pengimi i ceremonive fetare, parashikohen si vepra penale te denueshme.

157. Shteti shqiptar, brenda mundesive te tij, krahas fondeve qe i akordon nga buxheti i shtetit Institutit te Monumenteve te Kultures per restaurimin dhe mirembajtjen e objekteve te ndryshme te kultit, jep kontributin e vet nepermjet krijimit te lehtesive doganore e fiskale, kthimit te pronave (aty ku ka qene e mundur), apo nepermjet dhenies falas ose me çmime simbolike te trojeve ne pronesi publike per ndertimin e objekteve fetare te kultit, shkollave, spitaleve, azileve etj.

#### F. Liria e organizimit dhe mbledhjes paqësore (neni 15)

158. Ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise parashikohet e drejta e kujtdo te organizohet kolektivisht per çfaredo qellimi te ligjshem (neni 46).

159. Gjithashtu, Kushtetuta garanton lirine e tubimeve paqesore dhe pa arme sipas procedurave te parashikuara me ligj (neni 47).

160. Ne Kodin Civil parashikohet e drejta e femijeve, qe kane mbushur moshen 14 vjeç, te bejne pjese ne organizata shoqerore (neni 7). Edhe projektligji "Për organizatat jofitimprurëse" në nenin 3 kur flet për subjektet e ligjit shprehet se cdokush ka të drejtën e organizmit kolektiv dhe në nenin 4 shprehet se cdo person fizik ose juridik vendas apo i huaj ka të drejtën e themelimit dhe të pjesëmarrjes në organizatat jofitimprurëse.

161. Gjithashtu, Kodi Civil trajton dhe proceduren e krijimit te shoqatave ku nuk percaktohet mosha, gje qe te le te kuptosh qe edhe femijet kane te drejten e tyre te organizohen ne shoqata qe i pershtaten interesave te tyre. Pra nuk ka asnje kufizim ne kete te drejte.

#### G. Mbrojtja e jetës private (neni 16)

162. Kushtetuta ka percaktuar fshehtesine e korrespondences dhe paprekshmerine e baneses per cilindo, pa percaktuar ne menyre te veçante kategorine e femijeve, por dhe pa e perjashtuar ate. Pra, percaktimet kushtetuese vlejne edhe per te miturit. Sipas Kushtetutes, jane te garantuara liria dhe fshehtesia e korrespondences (neni 36).

163. Gjithashtu, Kushtetuta garanton paprekshmerine e baneses. Kontrollat e baneses mund te behen vetem ne rastet e parashikuara me ligj. Dhunimi i baneses, nderhyrja e padrejte ne jeten private, ose shkelja e fshehtesise se korespondences perbejne veper penale dhe denohen sipas dispozitave te Kodit Penal. Konkretisht sipas Kodit Penal dhunimi i baneses denohet me gjobe ose me burgim deri ne 3 muaj, nderhyrja e padrejte ne jeten private perben kudravajtje penale dhe denohet me gjobe ose me burgim deri ne 2 vjet, pengimi ose shkelja e fshehtesise se korespondences perben kudravajtje penale dhe denohet me gjobe ose me burgim deri ne dy vjet.

164. Po kështu sipas ligjit Nr.8092, datë 21.3.1996 "Per shendetin mendor", korrespondenca e personave ne institucionet e rehabilitimit dhe ato psikiatrike nuk kontrollohet.

H. E drejta për t'iu mos nënshtruar torturës, trajtimeve, apo dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese (neni 37 (a))

165. Te drejtat e parashikuara ne Konvente, gjejne pasqyrim ne legjislacionin shqiptar ne kuadrin e pergjithshem te te drejtave te njeriut, duke mos e konsideruar te nevojshme pasqyrimin ne menyre te veçante te te drejtave te femijeve ne disa prej tyre. Sipas Kushtetutes Shqiptare parashikohet se askush nuk mund t'i nenshtrohet tortures, denimit apo trajtimit mizor, ç'njerezor ose poshterues (neni 25).

166. Ne Kodin e Procedures Penale, ne pjesen e dispozitave te pergjithshme eshte parashikuar se askush nuk mund t'i nenshtrohet tortures, denimit apo trajtimit poshterues. Me ligjin nr. 7727, date 30.06.1993, Republika e Shqiperise ka aderuar ne Konventen kunder tortures dhe vuajtjeve te tjera ose trajtimit mizor, ç'njerezor e degradues. Denimi me vdekje nuk parashikohet nga legjislacioni shqiptar. Persa i perket denimit me burgim te perjetshem, legjislacioni penal shqiptar e ndalon dhenien e kesaj mase denimi per femijet nen moshen 18 vjeç. Per me teper, ne Kodin Penal parashikohet qe edhe denimi me burgim per te miturit, qe nuk kane mbushur moshen 18 vjeç, nuk mund te jete me shume se gjysma e denimit, qe parashikon ligji per vepren penale te kryer (neni 51). Ne rastet kur vepra penale eshte e nje rendesie te paket dhe sjellja e meparshme e te miturit eshte e mire, gjykata mund ta perjashtoje ate nga denimi dhe mund te vendose dergimin e tij ne nje institucion edukimi.

167. Ne Kodin e Procedures Penale eshte parashikuar sigurimi i trajtimit njerezor dhe rehabilitimi moral i te denuarve me burgim (neni 5/3).

168. Ne pjesen e legjislacionit shqiptar qe parashikon trajtimin e personave te denuar me heqje lirie, nje vemendje i eshte kushtuar ruajtjes, permiresimit ose rivendosjes te lidhjeve te te miturit me familjen, duke pergatitur nje program favorizues.

169. Si subjekt i veprave penale Kodi Penal përcakton si moshë minimale për përgjegjësi penale moshën 14 vjeç kur kryen një vepër penale dhe 16 vjeç kur kryen një kundërvajtje penale. Persa i perket marrjes se mases se sigurimit, Kodi i Procedures Penale parashikon kriteret dhe rrethanat qe duhet te kete parasysh gjykata, sidomos kur behet fjale per vepra penale te kryera nga te miturit.

170. Kur i pandehuri eshte i mitur gjykata mban parasysh dhe kerkesen per te mos nderprere proceset edukative konkrete. Ne qofte se i mituri ka kryer kundervajtje penale, nuk zbatohet masa e arrestit per te.

**MJEDISI FAMILJAR DHE KUJDESI ALTERNATIV (nenet 5, 18 paragrafi 1 dhe 2, neni 9, 10, 27 paragrafi 4, neni 20, 21, 11, 19, 39 dhe 25)**

A. Kujdesi prindëror (neni 5)

171. Ne legjislacionin shqiptar ne marrëdhëniet e femijes me prinderit dhe familjen ose qe kane te bejne me edukimin e femijes etj, prioritet i jepet te drejtave dhe detyrimeve qe kane prinderit, familja ose perfaqesuesit e tyre ligjor. E drejta e femijes per te pasur kujdesin e prinderve eshte percaktuar qe ne pjesen hyrese te Kodit te Familjes (neni 7) ndryshuar me Ligjin Nr. 7540, date 17.12.1991 "Per disa ndryshime ne Kodin e Familjes te Republikes se Shqiperise".

172. Sipas dispozites se siperpermendur, prinderit pergjigjen per mirerritjen dhe edukimin e femijeve te tyre. Po ne Kodin e Familjes (neni 69 dhe 71) parashikohet se prinderit nuk mund t'ia lene femijen ne rritje dhe edukim nje personi qe nuk mund te jete kujdestar. Prinderit e perfaqesojne vete femijen e tyre te mitur, qe nuk ka mbushur moshen 14 vjeç, ne te gjitha veprimet juridike, me perjashtim te atyre qe sipas ligjit, i mituri mund ti kryeje vete.

173. Gjithashtu, ne Kodin e Familjes dhe ne ligje te veçanta parashikohet detyrimi dhe e drejta e prinderve per tu kujdesur per ushqimin e femijes, arsimimin e tij, etj.

174. Projekti i Kodit te Ri te Familjes parashikon detyren dhe te drejten e prinderve per te mbajtur, arsimuar dhe edukuar femijet e lindur nga martesat ose jashte martesat, te cilet ne rast nevojë ndihmohen nga shteti.

175. Ne te njejten kohe projekti i ligjit parashikon kuptimin e pergjegjesive prinderore, ku perfshihen te drejtat dhe detyrat qe kane per qellim te sigurojne mireqenien morale dhe materiale te femijes, duke u kujdesur per te, duke mbajtur raporte personale me ta, duke i siguruar femijeve edukimin, rritjen, perfaqesimin ligjor dhe administrimin e te mirave te tij.

176. Ne rastet e vendosjes se kujdestarise, projekt-ligji parashikon detyrimin e gjykates qe te vendose mbi bazen e cilesive te personit te zgjedhur per te edukuar dhe arsimuar te miturin sipas kerkesave te parashikuara ne Kodin e Familjes.

177. Po ne kuadrin e pergjegjesive prinderore, nje rol te madh luan shkolla, e cil7 ka nje bashkëpunim të gjerë me komunitetin, veçanërisht me prindërit e femijëve.

178. Keshtu, prindërit marrin pjesë aktivisht në bordet e shkollës dhe aktivizohen për organizimin dhe mbarëvajtjen e saj si dhe informohen rregullisht nga mësuesit për ecurinë e fëmijëve në shkollë, për problemet që ata kanë dhe për mënyrat se si mund të rritin kujdesin dhe kontrollin ndaj fëmijëve.

179. Braktisja e Fëmijës parashikohet si vepër penale në Kodin Penal, Seksioni IX, Neni 124 "Braktisja e fëmijëve të mitur". Me anen e ketij neni parashikohet se

braktisja e fëmijëve nën 14 vjeç nga prindi ose personi që e ka fëmijën nën kujdestari dënohet me gjobë ose burgim deri në tre vjet.

180. Kur braktisja ka rezultuar me dëmtim të rëndë të shëndetit, ose vdekje, sanksioni është dënim me burg nga tre deri në dhjetë vjet.

#### B. Përgjegjësitë prindërore (neni 18, parag. 1-2)

181. Ushtrimi i përgjegjësise së prindërve ndaj fëmijëve shihet në tre këndvështrime;

- ✍ Kur përgjegjësia e prindërve ushtrohet gjatë martesës;
- ✍ Kur kjo përgjegjësi ushtrohet pas zgjidhjes së martesës;
- ✍ Kur prinderit biologjike nuk janë të martuar sipas kërkesave të ligjit;

182. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nga ana e saj nuk parashikon asnjë dispozitë të veçantë për përgjegjësinë e prindërve ndaj fëmijëve të tyre, por kjo fushë rregullohet me aktet e tjera ligjore dhe nenligjore në fuqi, si Kodi i Familjes, Dekrete të ndryshme etj.

183. Në Kodin e Familjes, që është aktualisht në fuqi, parashikohet se prinderit përgjigjen për mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve të tyre (neni 7).

184. Përgjegjësia e përbashkët e prindërve për edukimin dhe zhvillimin e fëmijës realizohet nepermjet ushtrimit të të drejtës prindërore (ose autoritetit prindëror, term ky i përdorur nga Projekt-Kodi i ri i Familjes), e cila i përket në mënyrë të barabartë të dy prindërve. Kodi i Familjes, parashikon që prinderit kanë të njëjtat të drejta dhe detyra ndaj fëmijëve të tyre të mitur (neni 63).

185. Gjithashtu, legjislacioni i familjes nuk i njeh asnjë përparësi ndonjerit prej prindërve në lidhje me të drejtën prindërore dhe ushtrimin e saj është në funksion të interesit të fëmijës. Ky kod parashikon se e drejta prindërore ushtrohet vetëm në interes të fëmijëve të mitur dhe me marrëveshje ndërmjet dy prindërve (neni 64).

186. Në rastet kur prinderit, për arsye të ndryshme, nuk mund ta mbajnë fëmijën e tyre, ata mund t'ia lenë për rritje dhe edukim vetëm një personi, i cili duhet të ketë cilësinë e kujdestarit, sipas kërkesave të ligjit. Prinderit i mbrojnë të gjitha të drejtat vetjake dhe pasurore të fëmijëve të tyre, pa qenë e nevojshme një emerim i posaçëm. Kjo ben pjesë në teresinë e të drejtave dhe detyrave që kanë prinderit për fëmijët e tyre (neni 71,72 i Kodit të familjes).

187. Prinderit, në mënyrë të përbashkët, përgjigjen për arsimimin, zhvillimin fizik e mendor, për shëndetin dhe detyrimin për ushqim të fëmijëve të tyre (neni 78 – Kodi i Familjes).

188. Në rastin kur prinderit zgjidhin martesën ose martesë është e pavlefshme, e drejta prindërore ushtrohet nga prindi që i është besuar fëmija për rritje dhe

edukim (neni 68 i Kodit të Familjes). Megjithatë Kodi i Familjes nuk shprehet, prindi tjetër vazhdon të gëzojë të drejtën prindërore, por mënyra e ushtrimit të saj përcaktohet në vendimin e gjykatës për zgjidhjen e martesës.

189. Përsa i përket përgjegjësisë së tij për detyrimin ushqimor ndaj fëmijës, për kujdesin që duhet të tregojë për zhvillimin normal dhe arsimimin e tij, etj. ai vazhdon të ketë të drejtë paralelisht me prindin tjetër. Në rastin kur prindërit biologjikë nuk janë martuar, por e kanë njohur fëmijën si të tyre, kanë të njëjtat përgjegjësi si dhe prindërit që kanë lindur fëmijën e tyre nga një martesë e ligjshme.

190. Shqipëria ka ratifikuar Konventën mbi Eliminimin e të Gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave, ku parashikohet se prindërit kanë të drejta dhe detyra të barabarta ndaj fëmijëve të tyre. Interesi i fëmijës do të jetë konsideratë parësore në të gjitha rastet (neni 6/2-c).

191. Përveç, përgjegjësisë që kanë prindërit për edukimin dhe zhvillimin, ata përgjigjen edhe për sjelljet anti-sociale të fëmijëve të tyre. Me Dekretin Nr. 2450, datë 27.05.1957 "Për përgjegjësinë e prindërve për sjellje të keqja të fëmijëve dhe mbi masat për edukimin e tyre", ndryshuar me Dekretin Nr. 7441, datë 1.12.1990, parashikohet denimi i prindërve për sjellje të keqja dhe për rrugaçëri të fëmijëve të tyre të mitur, që nuk kanë mbushur moshën 14 vjeç.

192. Denimet në bazë të këtij Dekreti për kundravajtje administrative përfshijnë gjatë deri në 500 leke. Por, megjithatë ky Dekret është ende në fuqi, në praktike ai nuk gjen më zbatim, kjo dhe për shkak të ndryshimit të kushteve që kërkojnë përdorimin e metodave të reja në edukimin e fëmijëve nën moshën 14 vjeç.

### C. Ndarja nga prindërit (neni 9)

193. Në Kodin e Familjes së Republikës së Shqipërisë (neni 70) parashikohet dhe rasti kur prindërit mund të kërkojnë në gjykatë dorëzimin e fëmijës së tyre, kur ai nuk jeton pranë tyre dhe mbahet pa të drejtë nga persona të tjerë. Në këtë rast gjykata vendos kthimin e fëmijës në qoftë se kjo nuk vjen në kundërshtim me interesat e tij si dhe mërr mendimin e fëmijës kur ai ka mbushur moshën 10 vjeç.

194. Për më tepër, në Kodin Penal (neni 127) thuhet se marrja e padrejtte e fëmijës, duke e larguar prej personit që ushtron autoritetin prindëror, ose që është besuar për rritje dhe edukim, si dhe mosdorëzimi i fëmijës prindit tjetër në zbatim të vendimit gjyqësor për kundervajtje penale dhe denohet me gjobe ose me burgim deri në gjashtë muaj.

195. Në lidhje me kujdestarinë, në Kodin e Familjes (neni 75) parashikohet dhe drejta e Këshillit të Kujdestarisë t'i kërkojë gjykatës që të vendosë heqjen e fëmijës nga prindërit në rastet kur prindërit nuk kujdesen për rritjen dhe edukimin e fëmijës së mitur ose kur këto e do interesi i tij, dhe t'i a besojë për rritje dhe edukim një institucioni shtetëror ose një personi tjetër, kur ky e pranon.



196. Pas viteve 1990-1991, ku shume fusha te se drejtes pesuan ndryshime te rendesishme, fusha e te drejtes familjare po i nenshtrohet ketyre ndryshimeve me me veshtiresi. Madje dhe nje pjese e organizmave qe funksiononin ne mbrojtje te te drejtave te femijeve, aktualisht kane mbetur pa funksion, siç jane Keshillat e Kujdestarise prane Bashkive. Kjo ben qe dhe funksionet e kompetencat qe kishte Keshilli i Kujdestarise te mbeten aktualisht ne leter dhe ne nje fare mase te jene ne dem te interesave te femijeve.

197. Ne rastet, kur prindi shperdoron te drejten prinderore, autoritetin prinderor, ose tregon pakujdesi te rende ne ushtrimin e saj, apo me veprimet e tij ndikon ne menyre te demshme ne edukimin e femijeve, me kerkesen e prindit tjetër, ose te Keshillit te Kujdestarise, apo prokurorit, mund ti hiqet e drejta prinderore me vendim te gjykates kompetente.

198. Gjykatat, ne nje pjese te vendimeve te tyre, jane perpjekur te zbatojne kriterin e interesit me te larte te femijes ne caktimin e autoritetit prinderor ne proceduren e zgjidhjes se martesës, ku femija ose femijet duhet te jetojne me njerin prind. Por, ka raste te tjera, qe gjykatat nuk shprehen fare ose shprehen ne menyre teper te zbehte lidhur me interesat e te miturit ne kete rast. Praktika gjyqesore para viteve 1990-te ka qene me e konsoliduar ne kete drejtim edhe per shkak te udhezimeve qe jepte Gjykata e Larte, te cilat ne baze te ligjit ishin te detyrueshme per gjykatat e tjera.

199. Persa i perket shprehjes se mendimit te te miturit, ne rastet kur femija do te qendroje me njerin prind ose me persona te tjere sipas rastit, Kodi i Familjes ka percaktuar moshen 10 vjeç (neni 66,67). Pra, gjykata merr mendimin e femijes kur ai ka mbushur moshen 10 vjeç.

200. Kodi i Familjes i jep te drejten prindit, te cilit nuk i eshte besuar femija, te mbaje marredhenie personale me femijen e tij (neni 98), sipas menyres se caktuar ne vendimin e gjykates.

201. Sipas rregullores se Burgut te Vaqarrit (burg per femijet), takimet lejohen kater here ne muaj ku nje here eshte takim special me familjen. Familja ka te drejte te qendroje 12 ore me te denuarin dhe mund te qendroje brenda burgut gjate kesaj kohe.

202. Megjithese ne Kodin e Familjes nuk eshte parashikuar si institut vecimi i bashkeshorteve (separation de corps) para zgjidhjes se martesës, vetem persa i perket ruajtjes se marredhenies te prindit me femijen, qe jeton me prindin tjetër, ka nje dispozite te vecante (neni 66). Kjo dispozite i referohet rasteve kur prinderit jetojne te vecuar, ndonese nuk kane zgjidhur martesën.

203. Keshilli i Kujdestarise eshte organi qe vendos se me cilin prind do te jetoje femija dhe ç'marredhenie do te kete ai me prindin tjetër. Por, ne kushtet kur Keshilli i Kujdestarise pothuajse nuk funksionon, problemi i rregullimit te

marredhenieve te femijes me prindin, me te cilin jeton, kerkon nje zgjidhje sidomos ne rastet kur prinderit jane veçuar per arsye te tjera nga ato qe çojne ne zgjidhjen e martesës. Te tilla mund te jene rastet e transferimit te njerit bashkeshort per efekte pune dhe bashkeshortet nuk bien dakort se me cilin prind do te qendroje femija si dhe per marredheniet e tij me prindin tjetër.

204. Ne ligjet ekzistuese ka nje kolizion problematik te dispozitave persa i perket kompetences se organit qe ka te drejte te percaktoje lenien e femijes per rritje dhe edukim ne fazen para zgjidhjes se martesës. Kjo perplasje dispozitash ligjore mendohet te eliminohet me miratimin e Kodit te ri te Familjes.

205. Keshtu, me 1 qershor 1996 hyri ne fuqi Kodi i Procedures Civile dhe pa ndryshuar ose shfuqizuar dispoziten e siperpermendur te Kodit te Familjes, rregullon ne menyre te ndryshme kompetencen e organit qe ka te drejte te percaktoje lenien e femijes per rritje dhe edukim ne fazen para zgjidhjes se martesës. Ne Kodin e Procedures Civile i lihet per kompetence te vendose se me cilin prind do te qendroje femija, deri ne zgjidhjen e martesës Seksionit per Shqyrtimin e Mosmarreveshjeve Familjare prane Gjykates se Rrethit.

206. Pra, sa me siper verehet se legjislacioni i familjes parashikon ne menyre te shprehur te drejten e prinderve per te mbajtur marredhenie personale me femijet e tyre dhe jo ne formen e te drejtes se femijes per te mbajtur marredhenie me prinderit e tij.

207. Projekti i Kodit te Familjes parashikon rastet kur femijet e mitur, ne pamundesi per te qendruar me prinderit e tyre, vihen ne kujdestari dhe gezojne mbrojtje te vecante nga shteti. Ne keto raste perfshihen edhe keqtrajtimet e femijeve nga prinderit, mungesa e kujdesit te tyre, heqja e autoritetit prinderor, etj.

208. Gjithashtu, Projekti parashikon rastet e lenies se femijes per rritje dhe edukim ne rast divorci dhe marredheniet qe ka femija me prindin tjetër. Nje rendesi merr dhe percaktimi i marredhenieve te femijes me prinderit gjate gjykimit te divorcit, ku ne Projekt eshte parashikuar gjykata si organi qe do te vendose per kete periudhe, si per menyren e realizimit te marredhenieve, per nevojat materiale te femijes dhe per vendbanimin. Projekti i le hapesire pjesemarrjes se femijes ne procedurat qe kane lidhje me interesat e tij, per te shprehur mendimin dhe ndjenjat e tij, si dhe ben te detyrueshem pjesemarrjen e psikologut ne gjykim.

209. Ne Projekt, eshte suprimuar organi i Keshilli i Kujdestarise, dhe i eshte dhene me shume vend rolit te gjykates ne mbrojtje te te drejtave dhe interesit te femijes. Projekti parashikon marredheniet qe duhet te kete femija me kujdestarin, te cilat jane te njejta si marredheniet e femijes me prinderit e tij. Kujdestari kujdeset per te miturin, e perfaqeson ate ne te gjitha veprimet juridike dhe administron pasurine e tij sipas dispozitave te Kodit mbi autoritetin prinderor.

210. Sipas Projektit, pergjithesisht i mituri i vene ne kujdestari jeton me kujdestarin, pervec kur gjykata vendos ndryshe. Projekti parashikon detyrimin e

gjykates qe para se te zgjedhe kujdestarin, duhet te degjoje dhe te marre ne konsiderate mendimin e te miturit qe ka mbushur moshen 10 vjec. Ne rast konflikti interesash, midis te miturit dhe prindit ose kujdestarit, gjykata cakton nje kujdestar te posacem, duke percaktuar dhe raportet e tij me femijen.

#### D. Ribashkimi familjar (neni 10)

211. Ne kushtet e Shqiperise, ku nje perqindje e madhe shtetasish shqiptare ndodhen ne emigracion ne vendet fqinje e me gjere, do te ishte mjaft e rendesishme te garantohej hyrja e shtetasve shqiptare ne keto shtete per realizimin e takimeve te shume femijeve qe nje, ose te dy prinderit i kane te punesuar, ose per shkaqe te ndryshme ndodhen ne shtete te tjera. Kushtetuta e Republikes se Shqiperise (neni 16), parashikon se te drejtat dhe lirite themelore si dhe detyrimet e parashikuara ne Kushtetute per shtetasit shqiptare vlejne njelloj dhe per te huajt e per personat pa shtetesi ne territorin e Republikes se Shqiperise, me perjashtim te rasteve kur Kushtetuta e lidh ne menyre te posacme me shtetesine shqiptare ushtrimin e te drejtave e te lirive te caktuara. Kjo eshte nje dispozite e pergjithshme qe gjen zbatim ne ligje te veçanta per fusha te caktuara te te drejtave dhe lirive te njeriut.

212. Gjithashtu, ne Kushtetute (neni 38-40) parashikohet e drejta e cilitdo qe te levize lirisht brenda territorit te shtetit si dhe jashte tij. Ndersa njeh te drejten e strehimit te te huajve ne Shqiperi, procedurat dhe kriteret, sipas Kushtetutes, rregullohen me ligj te veçante.

213. Aktualisht, hyrja e personave ne Republikën e Shqiperise dhe dalja prej saj, dhenia e strehimit dhe e lejes se qendrimit ne Shqiperi rregullohen nga Ligji Nr. 7939, date 25.05.1995 "Per migracionin". Ne baze te ketij ligji, çdo shtetas shqiptar, i cili largohet nga territori i Republikes se Shqiperise, ka te drejte te rikthehet (neni 6).

214. Ky ligj, jo vetem per shtetasit shqiptar, por edhe per shtetasit e huaj krijon mundesine e qendrimit ne Shqiperi ne afate 3 mujore dhe 1 vjeçare, me te drejte riprertitje.

216. Ligji, per marrjen e lejes se qendrimit i krijon lehtësi personave qe jane bashkeshorte te shtetasve shqiptare, femijeve te tyre qe jane nen moshen 18 vjeç, ose personave qe jane ne ngarkim te tyre (neni 15). Me tej, ligji parashikon edhe rastin e familjeve te shtetasve te huaj, qe kane ardhur per arsye te ndryshme ne Shqiperi (studime, investime, punesim, etj). Ne kete rast bashkeshorti dhe femijet nen moshen 18 vjeç, ose personat qe jane ne ngarkim te personave te siperpermendur, pajisen me leje qendrimi, te vlefshme sa kohezgatja e vlefshmerise se lejes se qendrimit te mbajtesit kryesor, duke paraqitur prova se ata mund te mbahen pa iu drejtuar fondeve publike.

#### E. Kujdesi për fëmijët (neni 27, parag. 4)

217. Ne baze te Kodit Penal, mosdhenia e mjeteve te nevojshme per jetesen e femijeve nga personi, qe ne zbatim te nje vendimi gjyqesor detyrohet te jape, perben kundravajtje penale dhe denohet me gjobe ose me burgim deri ne nje vit (neni 125).

218. Ne kushtet e hapjes se Shqiperise ndaj botes, pas viteve 1990-1991, shume prinder emigruan jashte vendit per te gjetur nje te ardhme me te mire. Ne shume raste emigrimi u shoqerua me prishje te familjeve, zgjidhje martesash, dhe shume femije mbeten pa ndihmen e duhur per tu shkolluar dhe jetuar ne kushte normale.

219. Megjithte vendimet e shumta gjyqesore te marra nga gjykatat shqiptare, te cilat percaktojne dhe detyrimin ushqimor te prindit qe eshte larguar ne nje shtet te huaj, nuk eshte arritur te ekzekutohen keto vendime. Kjo, per shkak te parashikimeve te legjislacioneve te huaja, te cilat kerkojne plotesimin e disa kushteve qe te njihen vendimet e gjykatave shqiptare ne vendet e tyre. Per kete problem eshte parashikuar si zgjidhje e plote lidhja e marreveshjeve dypaleshe ndermjet Republikes se Shqiperise dhe vendeve ku ka me teper emigrante shqiptare, alternative qe eshte parashikuar ne Kodin e Procedures Civile per zbatimin e vendimeve te dhena nga gjykatat e huaja (neni 393).

220. Ne kete kuader, Shqiperia ka ratifikuar marreveshjen me Ish-Republiken Jugosllave te Maqedonise per ekzekutimin e ndersjellte te vendimeve gjyqesore dhe me Greqine, nderkohe qe eshte ne bisedime per te arritur nje marreveshje me Italine ku punojne nje pjese e mire e emigranteve shqiptare.

221. Projekti i Kodit te Familjes parashikon detyrimin per ushqim qe kane prinderit ndaj femijeve te tyre te mitur, si dhe detyrimin e personave te tjere ne mungese te prinderve. Prindet detyrohen te ushqejne femijet e tyre te mitur, kur keta nuk kane mjete te mjaftueshme per te jetuar.

222. Detyrimi per ushqim caktohet ne proporcion me nevojat e atij qe e kerkon dhe me mundesite ekonomike te atij qe detyrohet. Projekti i Kodit te Familjes nuk ka ndryshime te rendesishme ne raport me Kodin ekzistues, persa i perket detyrimit per ushqim ndaj te miturve.

#### F. Fëmijët e privuar nga mjedisi familjar (neni 20)

223. Me Kushtetuten e Republikes se Shqiperise garantohet perkujdesja dhe ndihma e shtetit per jetimet (neni 59/e). Gjithashtu, Kushtetuta parashikon mbrojtjen e veçante te femijeve nga shteti duke u shprehur ne menyre te pergjithshme. Ndersa, ne Kodin e Familjes parashikohet detyrimi i shtetit per rritjen dhe edukimin e femijeve te mbetur pa prinder dhe pa perkrahje (neni 10).

224. Ne Kodin e Familjes parashikohet e drejta e Keshillit te Kujdestarise t'i drejtohet gjykates dhe t'i kerkoje qe te vendose heqjen e femijes nga prinderit ne rastet kur prinderit nuk kujdesen per rritjen dhe edukimin e femijeve ose kur kete e kerkon interesi i femijes, dhe t'ia besojte per rritje dhe edukim nje institucioni

shteteror ose nje personi tjetër kur ky i fundit e pranon. Ne keto raste nuk pushojne te drejtat dhe detyrimet e tjera qe u takojne prinderve kundrejt femijes.

225. Ne Kodin e Familjes parashikohen edhe rastet kur femijet nuk jane nen kujdesin e prinderve, kur te dy prinderit kane vdekur ose nuk njihen, jane shpallur si te pagjetur, ose u eshte hequr zotesia per te vepruar. Keta femije vihen ne kujdestari, e cila duhet t'u siguroje atyre kushte te pershtatshme per rritjen, edukimin, arsimimin dhe zhvillimin e gjithanshem te tyre (nenet 102 dhe 103).

226. Keshilli i Kujdestarise, sipas Kodit te Familjes, ka te drejten jo vetem te emeroje nje kujdestar per femijen, por edhe dergimin ne institucione te posaçme per femije, ne konvikte, ne institucione shendetesore ose ne institucione te tjera (neni 105).

227. Ligji Nr.7710, date 18.05.1993 "Per ndihmen dhe perkujdesjen shoqerore", me ndryshimet perkatese, percakton menyren e vendosjes ne institucione te perkujdesit shoqeror te femijeve jetime. Keto institucione, sipas ligjit mund te jene ne nivel lokal apo qendror. Ligji parashikon, gjithashtu, sherbimet shoqerore jo-qeveritare, te cilat mund te administrohen nga persona private dhe organizata jo-qeveritare, qe duhet te lidhin kontrate me Ministrine e Punes dhe te Çeshtjeve Sociale.

228. Kerkesa per vendosjen ne institucion te femijeve jetime ose te femijeve me paaftesi mendore dhe fizike behet nga kryetari i familjes, nga administratori shoqeror, ose komisioni ekspert-mjekesor kur institucioni varet nga pushteti lokal. Ne nivel qendror eshte Ministria e Punes dhe e Çeshtjes Sociale qe percakton menyren e vendosjes se tyre.

229. Ligji nr. 8153, date 31.10.1996 "Per statusin e jetimit", konsideron si jetime personat nga 0-25 vjec:

- te lindur jashte martesese;
- qe nuk kane gjalle asnjerin nga prinderit;
- qe me vendim te formes se prere te gjykates u eshte hequr e drejta prinderore te dy prinderve ose njerit prej tyre dhe tjetri nuk jeton;
- qe braktisen nga te dy prinderit dhe nuk u njihet identiteti i tyre.

230. Femijet jetime mbahen ne institucion deri ne moshen 14 vjec dhe ne rast se nuk kane mbaruar arsimin 8 vjecar deri ne moshen 17 vjec. Per ata qe mbarojne shkollen e mesme ose te larte dhe qe jetojne ne konvikt, shpenzimet e ushqimit perballohen nga Seksionet e ndihmes dhe te perkujdesit shoqeror prane organeve te pushtetit vendor, deri ne zenien e tyre me pune.

231. Gjithashtu atyre u sigurohet sherbimi shendetesor falas deri ne fillimin e marrredheneve te punes. Ligji parashikon nje sere lehtesirash ne mundesite per te gjetur pune, per strehim, ne emigracionin e organizuar nga shteti, apo per argetim.

232. Ne Shtepite e Femijes dhe te Foshnjes pranohen femije nga mosha 0-6 vjeç dhe femije te moshes 6-14vjeç. Lidhur me kriteret e vendosjes se femijeve ne kujdestari nga ana e shtetit ne institucione ndiqet nje procedure e caktuar ligjore e percaktuar ne VKM nr 510 date 24.11.1997, "Kriteret e vendosjes ne institucionet rezidenciale te perkujdesit shoqeror dhe dokumentacioni i nevojshem per pranim"

233. Ne institucionet e perkujdesit shoqeror per femije pranohen:

- a. Femije qe nuk kane asnje nga prinderit dhe nuk kane persona te tjere te afert qe marrin persiper vullnetarisht rritjen dhe edukimin e tyre.
- b. Femije te lindur jashte martesese, te cilet per rrethana te caktuara nuk mund t'i rrise nena.
- c. Femije, prinderve te te cileve, te dyve ose njerit, kur tjetri ka vdekur u eshte hequr e drejta prinderorore me vendim gjykate dhe gjykata me vendim ka percaktuar vendosjen e tyre ne institucione.
- d. Femije, kur prinderit e te cileve te dy apo njerit kur tjetri nuk jeton, nuk eshte ne gjendje ekonomike ta mbaje, shtrohen ne spital, jane te denuar me burg.
- e. Femije te familjeve pa te ardhura apo me te ardhura te pamjaftueshme, ose qe kane kriza familjare, si divorc, martesese e rimartese si dhe probleme te tjera te forta sociale.
- f. Gjithashtu, ne keto institucione mund te pranohen dhe femije te braktisur, prinderit e te cileve, kane emigruar ose do te emigrojne, jashte shtetit per arsye ekonomike. Ne kete rast vendosja e femijeve ne institucione te perkujdesit shoqeror behet per nje periudhe kohe deri ne permiresimin e kushteve social/ekonomike te prinderve.

234. Per vendosjen e femijeve te braktisur apo te familjeve me probleme sociale ne institucionet e perkujdesit per femije marrin inisiative:

- ✍ Te afermit ose prinderit e femijes;
- ✍ Kujdestare te femijes, kur nuk jane gjalle prinderit;
- ✍ Te interesuar te tjere, te autorizuar Drejtori i Shtepise se Lindjes;
- ✍ Seksioni Perkates i Ndhimes dhe Perkujdesit Shoqeror prane bashkise apo komunes si dhe institucione te tjera nepermjet Sherbimit Social Shteteror (SHSSH).

235. Per te vendosur femijet ne institucione te perkujdesit prane SHSSH funksionon komisioni i vendosjes, transferimit dhe largimit te femijeve nga institucionet. Ky komision shqyrton dokumentat perkatese te femijeve, te cilat jane:

1. Certificate e lindjes se femijes
2. Fotografi
3. Certificate familjare
4. Kopje e vendimit te gjyqit per heqjen e te drejtes prinderore

5. Deklarata e noterizuar e enes ose ne pamundesi e drejtorit te maternitetit per braktisjen e femijes apo te kryetarit te bashkise, apo te komunes
6. Analizat shendetesore per SIDA, Hepatit, me te dhenat laboratorike dhe vaksinimet
7. Epikriza shendetesore e femijes
8. Dokumenti i shkolles.

236. Institucionet Rezidenciale te Perkujdesit per Femije ndahen ne institucione shteterore dhe ne institucione te perkujdesit per femije te menaxhuara nga fondacionet apo shoqatat, te cilat kane lidhur kontrata me Ministrine e Punes dhe Sherbimit Social Shteteror.

237. Qe nga viti 1966 e deri ne vitin 2000 ne Institucionet Rezidenciale Shteterore te Perkujdesit Social jane trajtuar:

Institucioni	Viti 1996	Shtesa ne 1997	Shtesa ne 1998	Shtesa ne 1999	Shtesa ne 2000
Tirane 0-3 vjeç	59	38	13	21	38
Korçe 0-3 vjeç	27	3	6	5	14
Shkoder 0-3 vjeç	32	7	11	6	15
Durres 0-6 vjeç	42	19	21	30	17
Vlore 0-6 vjeç	68	4	36	28	2
Shkoder 3-6 vjeç	38	4	4	4	2
Shkoder 6-14 vjeç	78	6	0	16	8
Tirane 6-14 vjeç	117	4	18	8	19
Sarande 6-14 vjeç	85	2	3	12	2
TOTALI	546	87	112	130	117

238. Femije te trajtuar gjithsej qe nga viti 1996 ne Institucionet Shteterore te Perkujdesit Social jane 992.

239. Aktualisht ne keto Qendra trajtohen:

Qyteti	Kapaciteti	Nr i femijeve aktual	Personeli
Tirane 0-3 vjeç	50 femije	40	36
Korçe 0-3 vjeç	20 femije	17	16
Shkoder 0-3 vjeç	30 femije	30	25
Durres 0-6 vjeç	45 femije	40	30
Vlore 0-6 vjeç	40 femije	30	23
Shkoder 3-6 vjeç	50 femije	43	24
Shkoder 6-14 vjeç	100 femije	87	31
Tirane 6-14 vjeç	100 femije	91	38
Sarande 6-14 vjeç	90 femije	54	20

240. Institucione te menaxhuara nga fondacione dhe shoqata qe kane kontrate me Ministrine e Punes dhe Sherbimin Social Shteteror:

Betania - Fushe/Kruje	0-14vjeç	36 femije	40 personel sherbimi
Fshati SOS - Tirane	6-18vjeç	91 femije	100 punonjes
Fillimet e Reja - Berat	6-14vjeç	10 femije	7 punonjes
Vater e Ngrohte- -Gjirokaster	0-14vjeç	6 femije	9 punonjes
Rreze Dielli - Tirane	0-14 vjeç	11 femije	10 punonjes
Shtepia e Shpreses- -Elbasan	6-14 vjeç	28 femije	16 punonjes
Ndihma e Wilhelmit -Elbasan	3-14 vjeç	28 femije	20 punonjes
CEFA -Elbasan	6-14 vjeç	10 femije	15 punonjes
Misionaret e Bamiresise te Motrave te Nene Terezes -(Korçe) -(Elbasan)	0-3 vjeç 0-3 vjeç	20 femije 20 femije	10 punonjes 10 punonjes

241. Lidhur me personelin qe punon ne institucionet e perkujdesit per femije i kushtohet nje rendesi mjaft e madhe pergatitjes se tyre profesionale. Per marrjen e tyre ne pune ka kriteret te percaktuara lidhur me figuren profesionale dhe morale te personave qe do te punojne ne kete sektor mjaft delikat.

242. Gjithashtu, ne menyre te vazhdueshme dhe te planifikuar zhvillohen seminare per azhornimin e tyre me metodat bashkekohore per rritjen dhe edukimin e femijeve. Seminaret zhvillohen ne bashkepunim me shoqata dhe fondacione te ndryshme qe punojne per kete qellim, nga eksperte te fushave mjekesore, pedagogjike, psikologjike dhe sociale.

243. Sipas Kodit te Procedures Civile kerkesa per vendosjen e kujdestarise i paraqitet gjykates nga te afermit e femijes se mitur dhe nga cilido qe merr njoftimin per mbetjen e femijes pa prinder, per lindjen e nje femije me prinder te panjohur dhe per çdo rrethane tjeter qe ligji kerkon vendosjen e kujdestarise (neni 351).

244. Ne Kodin e Procedures Civile jane parashikuar edhe dispozita te tjera, te cilat ne fakt i perkasin ligjit material dhe qe kane dale pavaresisht nga ekzistenca e



Kodit te Familjes. Ne disa raste hartimi i ligjeve te ndryshme dhe te pakoordinuara njeri me tjetrin ka sjelle probleme edhe ne zbatimin e tyre per raste konkrete.

245. Keshtu, Ligji nr.7650, date 17.12.1992 "Per biresimin e te miturve" parashikon se gjykata qe deklaroi te braktisur te miturin, cakton ne te njejtin vendim dhe menyren e sistemimit te te miturit, nderkohe qe Ligji per Statusin e Jetimit edhe per kete kategori femijesh vendos kriteret me Vendim te Keshillit te Ministrave, duke injoruar ekzistencen e nje ligji qe vazhdon te jete ne fuqi.

246. Ka patur raste qe gjykata ne vendimin e saj ka percaktuar menyren e vendosjes se femijes, nderkohe qe Ministria e Punes dhe e Çeshtjes Sociale nuk e ka marre ne konsiderate vendimin e gjykates, duke e konsideruar kompetence te saj vendosjen e femijes ne institucion.

247. Projekti i Kodit te Familjes unifikon vendosjen e kujdestarise, duke percaktuar perfundimisht gjykatën si organin kompetent per rastet e parashikuara ne kete Kod. Duke patur ne konsiderate mbrojtjen e interesave te te miturve, Projekti parashikon afate te shkurtra dhe gjykimin me nje gjyqtar te vetem.

248. Sipas Projektit, femijet e mitur qe nuk jane nen kujdesin e prinderve per shkak se te dy prinderit kane vdekur ose nuk njihen, jane shpallur si te pagjetur, u eshte hequr autoriteti prinderor ose u eshte hequr zotesia per te vepruar, si dhe per cdo shkak tjetër te pranuar nga gjykata, vihen ne kujdestari dhe gezojne mbrojtje te vecante nga shteti.

249. Projekti parashikon dhe caktimin e kujdestarit nga prindi pasjetues, nepermjet testamentit ose me deklarate noteriale. Per te mbrojtur interesat e te miturit, sidomos ato pasurore. Projekti parashikon dhe mundesine e caktimit te nje kujdestari te posacem, kufijte e ushtrimit te kujdestarise te te cilit percaktohen me vendim gjyqesor.

250. Nje alternative tjetër per vendosjen e femijes nen kujdes eshte dhe ajo e familjes ushqyese. Per kete eshte hartuar nje projektligj per kujdesin ndaj te miturve ne nevojë (fostercare), i cili percakton rastet dhe procedurat e vendosjes se femijeve ne familje qe duhet te permbushin disa kushte te parashikuara ne kete projektligj.

251. Ne institucionet e perkujdesit per femije, ne pergjithesi, jetojne femijet deri ne moshe 14 vjeç, ndersa ne disa institucione te administruara nga fondacionet, perkujdesen per femijet deri sa ata te mbushin moshen 18 vjeç.

252. Femijet qe kane mbushur 14 vjeç, d.m.th. pas mbarimit te shkolles 8 vjeçare ndjekin shkollat e mesme me burse dhe jetojne ne konviktet e ketyre shkollave. Pas mbarimit te shkolles se mesme, keta te rinj jetime e te braktisur, jane nen mbrojtjen e Statusit te Jetimit. Ne baze te ketij ligji, ata perfitojne ndihme ekonomike, strehim e pune nga bashkita dhe deri sa te gjejne shtepi ata jetojne neper konvikte.

253. Gjithashtu, statusi u siguron fëmijëve shërbim mjekësor dhe dentar falas. Punesimi i jetimeve behet me perparësi nga zyrat e punës. Ata përjashtohen nga taksat, në rastin e emigracionit të organizuar nga shteti.

#### G. Birësimi (neni 21)

254. Instituti i Biresimit në të drejtën shqiptare rregullohet nga Kodi i Familjes dhe ligji nr. 7650, datë 17.12.1992 "Për biresimin e të miturve nga shtetas të huaj dhe për disa ndryshime në Kodin e Familjes".

255. Meqenëse ligji për biresimin e të miturve u miratua pas ratifikimit të Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijës, ai u hartua konform kësaj Konvente dhe Konventës së Hagës mbi biresimin ndërvendas, të 29 maj-it 1993, që në atë kohë ishte ende projekt. Në pjesën hyrëse të ligjit për biresimin e të miturve, sanksionohet parimi se, biresimi lejohet vetëm në rastet kur është në interesin e lartë të të miturit dhe garanton respektimin e të drejtave të tij themelore (neni 1), duke patur parasysh edhe paragrafin e parë të nenit 21 të Konventës.

256. Ligji për biresimin e të miturve, kryesisht rregullon biresimin ndërvendas, sepse legjislativi i mëparshëm nuk i përgjigjej me kushteve të reja në të cilat ndodheshin Shqiperia mbas viteve 90-te.

257. Ligji përcakton, kryesisht procedurën administrative të procesit të biresimit të fëmijës. Në zbatim të Konventës u krijua Komiteti Shqiptar i Biresimit si autoriteti kompetent që përparat gjithë dokumentacionin e nevojshëm për biresimin e fëmijës brenda ose jashtë vendit, për shqyrtimin në gjykatë.

258. Komiteti Shqiptar i Biresimit varet nga Këshilli i Ministrave dhe ka në përberje të tij përfaqësues të ministrave me të rëndësishme të lidhura me interesat e të miturit. Për të realizuar biresimin nga shtetas të huaj, Komiteti Shqiptar i Biresimit lidh marrëveshje me organizma ose agjenci të specializuara për biresimin e fëmijëve në vendet përkatëse. Ky Komitet gjatë aktivitetit të tij duhet të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare, të kësaj fushe, të ratifikuara nga Shqiperia (neni 5,6).

259. Gjithashtu, Komiteti, midis dokumenteve të tjera për përparatjen e dosjes për çdo biresim, kërkon edhe dënimin e pelqimit me shkrim për biresim nga prindërit biologjikë dhe ata biresues, si dhe mendimin e të miturit për biresimin neqoftese ka mbushur moshën 10 vjeç (neni 7).

260. Ligji përparat biresimin e fëmijës në një vend tjetër si alternative, duke detyruar Komitetin, fillimisht, të përparat të gjejë një familje në Shqipëri, për se të japë pelqimin për një vater familjare të përherëshme jashtë vendit.

261. Komiteti Shqiptar i Biresimit mund të japë pelqimin për biresimin ndërvendas vetëm në rast se i mituri nuk ka patur mundësi të biresohet në

Shqiperi ne nje afat prej gjashte muajsh nga dita e regjistrimit ne listat e Komitetit (neni 8,11). Praktika e deritanishme e Komitetit Shqiptar te Biresimeve ka treguar se biresimit brenda vendit i eshte dhene prioritet edhe per shkak te kerkesave te shumta qe ka patur nga prinder shqiptare per te biresuar femije shqiptare.

262. Vendimi perfundimtar jepet nga gjykata (Seksioni per shqyrtimin e mosmarreshjeve familjare), e cila shqyrton edhe njehere dokumentacionin e paraqitur nga Komiteti Shqiptar i Biresimeve si dhe kerkon dhenien e pelqimit te prinderve biologjike dhe biresues para gjykates. Gjithashtu, gjykata degjon edhe mendimin e femijes kur ai ka mbushur moshen 10 vjec (nenet 54,56 i Kodit te Familjes dhe neni 349 i Kodit te Procedures Civile).

263. Konform nenit 21/c te Konventes, ligji per biresimin e te miturve parashikon se biresimi nuk lejohet kur i mituri ne shtetin ku banojne biresuesit nuk gezon te njejtat te drejta qe njihen ne Shqiperi, ose kur arrihet ne perfundimin se biresimi eshte me pasoja te renda per te miturin. Konform nenit 21/d, ligji per biresimin e te miturve parashikon edhe denim me heqje lirie.

264. Sipas ligjit, pranimi, kerkesa per marrje, ose marrja e parave dhe e te mirave te tjera materiale nga ana e prindit, kujdestarit ose e çdo personi tjetër për vetë a për të tretet në procesin e biresimit të një të mituri denohen deri në pesë vjet heqje lirie. Kjo dispozite u parashikua edhe për shkak të abuzimeve që pati me rastet e biresimit të femijeve nga shtetas të huaj në vitet 1990-1991, fenomen ky që u favorizua edhe nga mangesite që kishte legjislacioni në atë kohë për biresimin ndervendas.

265. Rregullorja e Komitetit Shqiptar të Biresimeve parashikon në mënyrë të detajuar procedurën administrative të biresimit dhe dokumentacionin e nevojshëm që bazohet në një studim psikologjik social, shpirtëror, mjeksor, kulturor, etj. Sipas rregullores, duhet që K.SH.B të bëjë një punë paraprake me prinderit biresues, si dhe me femijen, kur ai është i rritur. Në këtë rast K.SH.B keshillon femijen me qellim që të kuptojë konceptin e biresimit, i jep shpjegime për prinderit biresues, duke i treguar për jetën e tyre nëpërmjet fotografive, videos, letrave, etj dhe i siguron kontakt personal me prinderit biresues.

266. Në periudhën midis majit 1994 dhe Shkurtit 1998, Komiteti i Biresimeve miratoi 298 biresime. Nga këto, 211 femije u adoptuan nga familje shqiptare dhe 87 femije nga të huajt. Shumica e femijeve të adoptuar nga të huajt (37) u sistemuan në Itali, e ndjekur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (31), në Francë 14, në Malte 4 dhe në Austri 1.

267. Nga të biresuarit gjatë kësaj periudhe, 151 ishin të seksit femer dhe 147 meshkuj. Përsa i përket moshës së tyre, në momentin e adoptimit, 43 ishin nën moshën 1 vjeç, 224 nëndërmjet 2 dhe 6 vjetësh, ndërsa 31 ishin nëndërmjet 7 dhe 16 vjetësh. 8 femije të biresuar ishin të paafte.

268. Me ligjin Nr 8624, date 15.06.2000, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi aderimin e Shqipërisë në Konventën e Hagës “Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për biresimet jashtë vendit”, të datës 29 maj 1993. Kjo sjell angazhimin e Shqipërisë për të parë nëse legjislacioni mbi biresimin e të miturve vjen në kundërshtim me këto Konvente. Aderimi i Shqipërisë në Konventën e Hagës u bë në një moment të pershtatshëm, kur dhe legjislacioni në fushën e familjes po peshon ndryshime të rëndësishme.

269. Në Projektin e Kodit të Familjes u përfshi dhe pjesa materiale e ligjit për biresimin e të miturve nga shtetas të huaj, si dhe u bënë ndryshime konform Konventës së siperpërmendur. Projekti parashikon dhe periudhën e provës, për qëndrimin e fëmijës me prindërit biresues, para se gjykata të marrë vendimin përfundimtar për biresimin. Gjithashtu, Projekti i jep prioritet të drejtave të prindërve biologjike në raport me prindërit biresues, para se gjykata të shprehet përfundimisht për biresimin. Kështu, në rast se prindërit biologjike kanë dhënë pelqimin për biresim dhe me vone e tërheqin atë edhe mbas kalimit të afatëve të parashikuara në këtë Kod, në rast se nuk është dhënë vendimi përfundimtar atë kanë të drejtë ta tërheqin atë.

#### H. Transferimi i paligjshëm dhe mos-kthimi (neni 11)

270. Sipas disa të dhënave të pjesëshme të Komitetit për Mundësi të Barabarta, rreth 4000 fëmijë janë larguar në emigracion të pashoqëruar nga prindërit (3000 në Greqi dhe 1000 në Itali). Kjo kategori fëmijësh e ndodhur në vende të tjera, larg familjes dhe kujdesit të saj, shpesh ndodhet përballë rreziqeve të shumta si keqtrajtimi, abuzimi fizik e seksual, përfshirja në format e këqija të punës, në trafikë dhe aktivitete të tjera të paligjshme. Ka raste kur fëmijët shiten nga prindërit, ose shfrytëzohen nga rrjete mafioze e kriminale për qëllime fitimi.

271. Sipas këtyre të dhënave burimet e rekrutimit të fëmijëve për trafikim janë:

- ☞ Nga familje të divorcuara dhe me mungesë kujdesi familjar
- ☞ Nga familje me shumë fëmijë dhe në gjendje të vështirë ekonomike
- ☞ Nga familje fshatare që shpresojnë në ndihmën e fëmijëve
- ☞ Nga fëmijë të mbetur jetimë dhe pa kujdes
- ☞ Nga familje që prindërit u janë larguar për punë jashtë shtetit
- ☞ Fëmijë që kanë braktisur shkollën dhe janë marrë me lypësi e veprimtari tjetër të kundërligjshme edhe në Shqipëri

272. Kushtet e jetesës të të miturve të trafikuar në shumicën e rasteve janë të mjerueshme, punë e rëndë dhe me orar të zgjatur dhe pagesë minimale sa për t’u ushqyer. Këta fëmijë janë të preferuar për trafikantët, sepse u kushtojnë pak dhe përfitimi nga puna e tyre është gjithnjë e në rritje.

273. Rrugët e trafikimit të fëmijëve zakonisht janë të njëjta me ato të trafikimit të qenieve njerëzore, por përdoren nga trafikantët edhe dokumente false si kujdestarë apo prindër të tyre. Puna për riintegrimin e fëmijëve, kthimin në Shqipëri dhe kujdesi për ta paraqet vështirësi dhe kërkon një angazhim të gjithanshëm jo vetëm të institucioneve shtetërore, por edhe të organizatave ndërkombëtare e OJQ-ve, të cilat kanë programe për këtë qëllim e kanë nisur punën.

274. Legjislacioni shqiptar parashikon si krim të veçantë "trafikimin e njerëzve" të shprehur në trafikimin e njerëzve, trafikimin e femrave për prostitucion, e trafikimin e fëmijëve, si dhe vepra penale të tjera që lidhen me trafikimin e njerëzve siç është fshehja ose ndërrimi me dashje i fëmijës, kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror, dhënia e ndihmës për kalimin e paligjshëm të kufirit, dënimet për organizimin e prostitucionit dhe aktiviteteve të lidhura me të.

275. Kodi Penal shqiptar parashikon sanksione për vepra penale që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi me trafikimin e njerëzve. Këtu përfshihen vepra penale të përmendura më lart, si dhe mbajtja, shfrytëzimi, financimi dhe dhënia me qira e lokaleve për prostitucion, rrëmbimin e personit si dhe të fëmijës nën 14 vjeç, heqjen e paligjshme të lirisë së personit duke venë në rrezik jetën ose duke e shoqëruar me vuajtje të rënda fizike, rrahje, marrëdhënie seksuale me dhunë, vjedhjen e dokumenteve të identifikimit, falsifikimin e dokumenteve të identifikimit, kërcënimin si dhe kryerjen e veprave penale në bashkëpunim nga organizata kriminale ose banda të armatosura.

276. Sipas Kodit Penal Shqiptar të gjitha sendet që shërbejnë apo janë caktuar të përdoren për kryerjen e veprave penale duke përfshirë çdo lloj objekti, të holla apo pasuri që rrjedhin nga një vepër penale apo shpërblim i dhënë apo i premtuar për kryerjen e saj, konfiskohen dhe kalojnë në pronësi të shtetit pas dhënies së dënimit për krimin.

277. Sipas legjislacionit shqiptar qytetarët e vendeve të huaja mund të dëbohen nëse kanë hyrë ilegalisht në Shqipëri. Megjithatë dëshmitarët mund të përjashtohen nga dëbimi nga Shqipëria për interesa të shtetit si dhe nevoja për t'i patur si dëshmitare deri në përfundimin e çështjeve gjyqësore. Viktimat e trafikut kanë të drejtë të përfaqësohen nga një përfaqësues ligjor ose përfaqësues i pajisur me prokurë, kanë të drejtë të kenë një përkthyes, i cili paguhet nga shteti, kanë të drejtë për të folur dhe për t'u informuar mbi faktet dhe aktet si dhe mbi zhvillimin e procesit, me ndihmën e përkthyesit.

278. Aktualisht në Shqipëri nuk ka një ligj që të rregullojë mbrojtjen e dëshmitarëve. Ligji ekzistues nuk e ndalon mbrojtjen e dëshmitarëve, por mungesa e burimeve financiare dhe e personelit e bën të vështirë dhënien e mbrojtjes së përshtatshme.

279. Sipas Kodit të Procedurës Penale, personat e arrestuar apo të dënuar për një vepër penale që lidhen me trafikun e narkotikeve, prostitucionin dhe klandestinëve të cilët ndihmojnë dhe bashkëpunojnë me organet e procedimit, nuk mund të dënohen më tepër se gjysma e dënimit të parashikuar për veprën e kryer. Në raste të veçanta këta persona mund të përjashtohen nga dënimi. Nje analizë e detajuar e legjislacionit shqiptar mbi keto ceshtje ka hapur rrugen per nje projekt per ndryshime ne Kodin Penal te Republikes se Shqiperise. Keto ndryshime te cilat priten te miratohen gjate vitit 2001, parashikojne nene me specifike per trafikimin e qenieve njerezore, perfshire ketu ne rradhe te pare femijet, si dhe sanksione te renda per autoret e ketyre veprave penale.

280. Ajo ç'ka eshte dhe me e rendesishme ne kete projektligj per ndryshime te Kodit Penal, ka te beje me bashkepunimin nderkombetar ne luften kunder ketyre fenomeneve, nepermjet marreveshjeve dypaleshe ose shumeपालeshe ose aderimit ne marreveshjet ekzistuese. Ne kete kuader eshte parashikuar qe ne qytetin e Vlores, ne bashkepunim me shtetet e interesuara si Italia, Gjermania, Greqia etj, te ngrihet nje qender e fuqishme antitrafik, e cila te luftoje ne rradhe te pare trafikun njerezor, vecanerisht ate te grave dhe femijeve.

281. Një mbrojtje e vecantë u garantohet fëmijëve refugjatë në ligjin nr.3920 datë 21.11.64, "Për gëzimin e të drejtave civile nga të huajt dhe zbatimin e ligjit të huaj", ku garantohet gëzimi i të drejtave civile që i njihen shtetasve shqiptarë, si dhe në ligjin nr.8432, datë 14.12.1998, "Për azilin", duke garantuar mbrojtje dhe përkrahje te veçantë për fëmijët refugjatë, fëmijë të familjeve të varfëra, fëmijë që rrezikojnë të përfshihen në veprimtari kriminale, minorenë viktimë të prostitucionit.

282. Per kete qellim në qytetet e vendeve të huaja, me përqëndrim të madh emigrantësh shqiptarë do të synohet të ngrihen Qendra Kulturore Shqiptare. Në mjediset e këtyre Qendrave do të ofrohen shërbime të ndryshme për fëmijët e emigrantëve, duke filluar nga kurset për mësimin e gjuhës shqipe e duke vazhduar me shfaqje e projektme filmash, lektorate të ndryshme, shërbime bibliotekare etj.

#### I. Abuzimi dhe neglizhenca (neni 19), duke përfshirë rikuperimin fizik dhe psikologjik dhe riintegrimin social (neni 39)

283. Paragrafi 3 i Nenit 54 të Kushtetutës i njeh të drejtën fëmijëve të jenë të mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, nën moshën minimale për punën e fëmijëve (që sipas legjislacionit tonë është mosha 16 vjeç), që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal.

284. Ne baze te Kodit te Familjes, kur gjykata konstaton se prindi shperdoron te drejten prinderore ose tregon pakujdesi te rende ne ushtrimin e saj, ose me veprimet e tij ndikon ne menyre te demshme ne edukimin e femijes, me vendim gjyqesor i hiqet e drejta prinderore (neni 76).

285. Ne Kodin e Familjes parashikohen rastet kur prindi te cilit nuk i eshte besuar femija per rritje dhe edukim pas zgjidhjes se martesese, nuk i gjen me vend veprimet ose masat e marra nga prindi qe ushtron te drejten prinderore, mund t'i drejtohet Keshillit te Kujdestarise per te marre masat e nevojshme (neni 68). Kodi i Familjes nuk specifikon llojet e veprimeve te kryera kundrejt femijes, por nga doktrina dhe praktika gjyqesore rezulton se behet fjale per veprime qe mund te jene te lidhura me keqtrajtimin e femijes, me dhunen fizike, fyerjen deri dhe abuzimin seksual. Problemi i keqtrajtimit dhe abuzimit te femijeve, per raste te caktuara, parashikohet edhe ne Kodin Penal ku shoqerohet dhe me masat perkatese te denimit.

286. Ne baze te Kodit Penal mosdhenia e mjeteve te nevojshme per jetesen e femijeve nga personi, qe ne zbatim te nje vendimi gjyqesor detyrohet te jape, perben kundervajtje penale dhe denohet me gjobe ose me burgim deri ne 1 vit (neni 125).

287. Gjithashtu, Kodi Penal parashikon si veper penale braktisjen e femijes nen moshen 14 vjeç nga prindi, ose personi qe eshte i detyruar te kujdeset per te. Ne kete rast ai denohet me gjobe ose me burgim deri ne tre vjet. Nese si pasoje e konsumimit te nje vepre te tille eshte shkaktuar demtim i rende i shendetit ose vdekja e femijes, denimet jane nga tre deri ne dhjete vjet burg (neni 124). Megjithate, Kodi Penal nuk parashikon sanksione ose masa denimi te vecanta per rastet e fyerjes, mosperfilljes, dhunes mendore ndaj femijes etj. Keto raste i nenshtrohen dispozitave te Kodit Penal si per te gjitha rastet e tjera.

288. Ne projektin e ndryshimeve te Kodit Penal, parashikohet si kundervajtje penale dhe denohet me gjobe ose me burgim deri ne dy vjet kanosja serioze per hakmarrje, ose per gjakmarrje qe i behet personit te ngujuar duke penguar levizjen e lire te tij te femijeve a te miturve, qe per kete shkak qendrojne te ngujuar dhe braktisin shkollen. Ky ndryshim ne Kodin Penal eshte i rendesishem ne kushtet kur te miturit te ngujuar i mohohet e drejta e levizjes se lire, e informacionit, e drejta per arsim dhe ne menyre indirekte ushtrohet nje dhune mendore me pasoja per te miturin.

289. Keqtrajtimi i femijeve eshte sot nje nder problemet me te mprehta me te cilat ballafaqohet shoqeria shqiptare. Gjithnje e me teper po behet i pranishem realiteti i hidhur i keqtrajtimit te femijeve ne forma te ndryshme brenda dhe jashte familjes.

290. Një problem shqetësues i dhjetevjeçarit të fundit është gjakmarrja dhe hakmarrja, prej së cilës preken edhe fëmijët drejtpërdrejt ose indirekt, si autorë apo si palë e dëmtuar. Shumë të mitur janë të detyruar të mos ndjekin shkollën për shkak të këtij fenomeni.

291. Fëmijët e rrugës përfaqësojnë kategorinë më të pambrojtur, më të ekspozuar ndaj shumë rreziqeve si keqtrajtimi, pasiguria, analfabetizmi, kequshqyerja etj. Margjinalizimi i kësaj kategorie ushqehet nga shumë faktorë

ekonomikë, sociale, kulturore, arsimore dhe familjare. Sipas disa të dhënave të përshtesha vetëm në Tiranë janë identifikuar rreth 800 fëmijë të rrugës, të cilët ushtrojnë "profesionin" e lypësit, shitësit ambulant, të llustraxhiut etj.

292. Fëmijët e pambrojtur, jetimë dhe me prindër të divorcuar bien shpesh "pre" e shfrytëzimit dhe dhunimit në format më të larmishme. Këto kanë qenë objekt shkrimesh në media dhe lajme në TV dhe një pjesë e tyre të trajtuar nga shoqata bamirëse.

293. Fëmijët e përfshirë në punë dhe aktivitete të tjera fitimprurëse janë fëmijë të cilët e kanë braktisur përfundimisht shkollën, ndërsa të tjerë e frekuentojnë atë dhe kryejnë punë të ndryshme, kryesisht pas mësimit, duke u aktivizuar në ekonominë familjare ose aktivitete jashtë familjes. Në praktiken gjyqësore të koheve të fundit, vihen re raste vendimesh gjyqësore të cilat nuk trajtojnë siç duhet shkaqet që kanë sjelle keqtrajtimin e fëmijes ose anashkalojnë, në dëm të interesit të të miturit, situatën e krijuar në familje.

294. Kodi Penal parashikon si vepra penale rastet e marrëdhënieve seksuale, ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari. Në bazë të dispozitës përkatëse, kryerja e marrëdhënieve seksuale, homoseksuale, si dhe akteve të tjera seksuale, ndërmjet prindit dhe fëmijes, vëllait dhe motres, ose me persona që ndodhen në raporte kujdestarie apo të biresimit, denohet me burgim deri në pesë vjet.

295. Me projektin për ndryshimet e Kodit Penal, parashikohet që për marrëdhënie homoseksuale, si dhe për akte të tjera seksuale masa e denimit të shtohet nga pesë vjet në 7 vjet. Me ndryshimet që parashikohen përveç të tjerave, synohet të bëhet një përcaktim më i plotë i dispozitës.

296. Sipas nenit 54 të Kushtetutës, fëmijët (dhe këtu kërket parasysh si fëmijët mbi 14 vjeç ashtu dhe ata nën 14 vjeç) kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti. Problemi kryesor në këto kuader nuk qëndron në mbrojtjen juridike të fëmijes, por në realizimin efektiv të kësaj mbrojtjeje sidomos në kushtet kur familjet janë shpesh tepër të mbyllura dhe nuk lejojnë njohjen e situatës dhe marrjen në kohë të masave mbrojtëse dhe parandaluese në interes të fëmijes.

297. Deri më tani në Shqipëri nuk janë bërë studime të mirëfillta për të përcaktuar llojet e keqtrajtimit të fëmijëve dhe statistikat përkatëse. Në një nga studimet e bëra në këto drejtim është arritur në konkluzionin se një rol të rëndësishëm në sensibilizimin e shoqërisë në teresi dhe të fëmijëve në veçanti luan media e shkruar dhe ajo elektronike e cila duhet t'i vijë në ndihmë prindërve dhe fëmijëve në trajtimin sidomos të dhunës psikologjike apo neglizhencën, dukuri që në shumicën e rasteve qëndrojnë në gjendje të fshehur.

298. Ngritja e qendrave të veçanta për të mbështetur fëmijët që ndodhen në situata të tilla do të jepte një mbështetje emocionale dhe gradualisht do të çonte në kapërcimin e pasojave të keqtrajtimit nga ana e tyre. Me Vendimin e Këshillit të



Ministrave nr. 415, date 01.07.1998 “Per krijimin dhe funksionimin e Komitetit Gruaja dhe Familja”, parashikohet krijimi i Komitetit si strukture me vete ne varesi te Keshillit te Ministrave.

299. Legjislacioni shqiptar nuk ka parashikuar dispozita te veçanta, te permbledhura ne nje akt ligjor per trajtimin e femijeve, qe jane viktimat te shfrytezimit, keqtrajtimit, tortures, etj, por keto masa i gjejme te shperndara ne ligje te veçanta, sipas rastit konkret.

300. Trajtimi i refugjateve qe vijne ne Shqiperi dhe masat qe merren per riintegrimin e tyre jane parashikuar ne ligjin qe ben fjale per refugjatet. Ndersa, ne Kodin e Procedures Penale parashikohet menyra e riparimit te demit jopasuror te rrjedhur nga vepra penale.

#### J. Rishikimi periodik i vendbanimit (neni 25)

301. Sipas ligjit “Per Shendetin Mendor”, mbrojtja e shendetit mendor sigurohet nga strukturat e administrates shteterore dhe institucionet publike e private te caktuara per kete qellim. Shoqatat, fondacionet, organizatat bamirese, organizmat e tjere joqeveritare si dhe grupimet e pacinteve a familjareve te tyre ndihmojne ne mbrojtjen e shendetit mendor.

302. Trajtimi shendetesor publik per personat me zhvillim te vonuar dhe ata me crregullime mendore, perfshire edhe femijet, eshte falas. Kur personat jane nen 18 vjec dhe kurohen ne institucione private, shteti mbulon koston e shpenzimeve ne keto institucione te barabarte me koston ne institucionet shteterore. Ministria e Shendetesise dhe e Mbrojtjes se Mjedisit, ne bashkepunim me Ministrine e Punes, Emigracionit, Perkrahesjes Sociale dhe ish-te Perndjekurve Politike percakton parimet baze te politikës rehabilituese dhe edukative per femijet dhe te rinjte me shkalle te ndryshme prapambetjeje mendore.

303. Nje shkolle e vecante funksionon per te gjithë femijet me prapambetje me te lehte mendore. Aty behet ekzaminimi periodik i trajtimit per te pare dhe shkallen e zhvillimit te tyre. Kjo shkolle varet nga Ministria e Arsimit dhe trajtimi i femijeve behet, pervec te tjerave, edhe ne drejtim te edukimit dhe arsimimit te tyre per te patur mundesine e integritit ne shoqeri per aq sa e lejon niveli i tyre.

304. Ndersa per femijet me prapamendje te rende mendore funksionon nje Institut i vecante ku trajtohen keta femije. Ne kete Institut eshte programuar nje trajtim i veçante nga Ministria e Punes dhe e Çeshtjeve Sociale nga e cila Instituti varet. Persa i perket femijeve qe vuajne nga semundje te renda psikike, ligji per shendetin mendor parashikon ekzaminimin periodik te trajtimit te ketyre femijeve dhe menyren e realizimit te ketij ekzaminimi.

#### **SHENDETI THEMELOR DHE MIREQENIA (Neni 6 paragrafi 2, neni 23, 24, 26, 18 paragrafi 3 dhe neni 27 paragrafet 1-3)**

#### A. Mbijetesa dhe zhvillimi (neni 6, parag 2)

305. Duke qene nje nga objektivat sociale, te parashikuar nga Kushtetuta, shteti i kushton nje rendesi te vecante mbijeteses dhe zhvillimit te femijes. Kushtetuta e Republikes se Shqiperise parashikon nje mbrojtje te vecante te femijeve dhe te rinjve nga shteti.

1. Femijet, te rinjte, grate shtatzena dhe nenat e reja kane te drejten e nje mbrojtje te vecante nga shteti.
2. Femijet e lindur jashte martesese kane te drejta te barabarta me te lindurit nga martesesa.
3. Cdo femije ka te drejte te jete i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytezimi dhe perdorimi per pune, e vecanerisht nen moshen minimale per punen e femijeve, qe mund te demtoje shendetin, moralin ose te rrezikojte jeten a zhvillimin e tij normal. (neni 54).

#### B. Fëmijët e paaftë (neni 23)

306. Femijet me paaftesi mendore e fizike ne Shqiperi deri ne vitet 90-te trajtoheshin nga Ministria e Shendetsise dhe per pasoje kujdesin kryesor, institucionet perkatese, e perqendronin ne shendetin e femijeve. Duke patur parasysh kushtet e reja ne te cilat hyri Shqiperia mbas viteve 90-te, lindi domosdoshmeria e ndryshimit te trajtimit te kesaj kategorie femijesh dhe theksi u vu kryesisht ne integrimin e tyre ne shoqerine shqiptare.

307. E drejta shqiptare merr ne konsiderate objektivat e Konventes per kete kategori femijesh. Kushtetuta e Republikes se Shqiperise, kur trajton objektivat sociale, parashikon pergjegjesine dhe synimin e shtetit qe brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve qe disponon te kujdeset per riaftesimin shendetsor, edukimin e specializuar dhe integrimin ne shoqeri te te paaftëve, si dhe permiresimin ne vazhdimesi te kushteve te tyre te jeteses.

308. Sipas Kushtetutes, permbushja e objektivave sociale nuk mund te kerkohej drejtperdrejte ne gjykate. Kushtet dhe masa e realizimit te ketyre objektivave percaktohen me ligje te vecanta.

309. Ligji nr. 8092, date 21.03.1996 "Per shendetin mendor", parashikon politikat parandaluese per mbrojtjen e shendetit mendor si dhe institucionet qe i realizojne ato. Keto institucione ndahen ne institucione per personat me prapambetje mendore, te cilet merren me rehabilitimin, edukimin dhe kujdesin per kete kategori personash ku hyjne dhe femijet ne institucionet psikiatrike dhe rehabilituese, si spitalet dhe shtepite e kurimit (neni 4). Femijet me zhvillim mendor te vonuar dhe ata me çrregullime mendore trajtohen falas ne institucionet publike te kurimit, rehabilitimit arsimimit dhe edukimit. Kur femijet trajtohen ne

institucione private, shteti mbulon pjesen e shpenzimeve te barabarte me koston e trajtimit ne institucionet publike (neni 6).

310. Ministria e Shendetesise dhe Ministria e Punes dhe Çeshtjeve Sociale percaktojne parimet baze te politikës rehabilituese dhe edukative per femijet me shkalle te ndryshme dhe prapambetje mendore. Ne baze te Ligjit "Per shendetin mendor", ne keto institucione, Ministria e Punes dhe Çeshtjeve Sociale duhet te caktojë punonjes sociale te cilet mbikqyrin trajtimin e pacientit nga pikpamja sociale dhe e mbrojtjes se tyre.

311. Duke vleresuar rolin e rendesishem te shoqatave, fondacioneve dhe ne pergjithesi te organizmave joqeveritare, ne pjesen hyrese te ligjit, ato jane konsideruar si partnere dhe ndihmes ne mbrojtjen e shendetit mendor. Nje kujdes te veçante ligji i kushton veçanerisht te semureve me çrregullime mendore duke i perfshire ne veprimtari dhe pune te ndryshme duke lehtesuar riintegrimin e tyre ne jeten shoqerore.

312. Ligji i ri i siperpermendur, ne permbajtje te tij eshte bashkekohor dhe ai i fut femijet ne kuadrin e trajtimit te gjithe personave qe futen ne keto kategori, dhe vetem ne dispozita te vecanta parashikon ne menyre te shprehur kategorine e femijeve. Ne dispozitat qe parashikojne lidhjet e personit me familjen, vendosjen e kujdestarit nga gjykata me kerkese te komisionit psikiatriko - ligjor dhe menyren e trajtimit te tyre, nuk behet diferencim per femijen. Por, ne nje dispozite percaktohet se parashikimet e ketij ligji per kete pjese jane te vlefshme edhe per kujdestarin ligjor te te miturit. Kodi i Familjes, per kete kategori personash qe kane nevojë per kujdestar pasi nuk jane te zote te veprojne parashikon procedure tjeter, duke ia dhene kompetencen e caktimit te kujdestarit Keshillit te Kujdestarise, (neni 110). Projekti i Kodit te Familjes e ka unifikuar duke ia lene gjykates te drejten e caktimit te kujdestarit edhe per kete kategori femijesh, sikurse dhe Kodi i Procedures Civile.

313. Fëmijët e paaftë dhe me zhvillim të vonuar janë një pjesë e komunitetit të gjerë të personave të paaftë në vendin tonë. Për trajtimin e fëmijëve me prapambetje zhvillimi dhe të paaftë ofrohen shërbime institucionale në qendra trajtimi dhe rehabilitimi si: Qendra rezidenciale të zhvillimit në disa qytete dhe Qendra Ditore të zhvillimit në Shkodër dhe në Lezhë.

314. Në këto institucione trajtohen rreth 250 fëmijë të cilët marrin shërbime sociale dhe shëndetësore. Kapaciteti i këtyre institucioneve është i kufizuar në raport me kërkesat e nevojat për këto shërbime. Për plotësimin e nevojave në këtë sektor një rol dhe kontribut të rëndësishëm luajnë fondacionet dhe organizatat jo-qeveritare, të cilat sigurojnë një gamë të gjerë shërbimesh duke sjellë ndryshime cilësore jo vetëm në konceptimin por edhe strukturën e shërbimeve të ofruara.

315. Sipas ligjit nr. 8092, datë 1.03.1996 "Për shëndetin mendor", në personat me çrregullime mendore, ku përfshihen dhe fëmijët, bëjnë pjesë: personat me probleme të funksionimit mendor, personat me prapambetje mendore, personat

që paraqesin çrregullime mendore psikosociale. Personat me zhvillim mendor të vonuar dhe ata me çrregullime mendore, trajtohen falas në institucionet publike të kurimit, të rehabilitimit, të arsimimit dhe edukimit. Kur personat janë nën 18 vjeç dhe trajtohen në institucione private, shteti mbulon pjesën e shpenzimeve në masë të barabartë me koston e trajtimit të tyre në institucionet publike. Pra ligji u jep fëmijëve një përkrahje të veçantë duke u siguruar atyre një pjesë të financimit për ta, në rastet e vendosjes së tyre në institucionet private të përkujdesit social.

316. Legjislacioni shqiptar për kategori të caktuar të femijëve me paaftesi ka parashikuar kritere të veçanta.

317. Ligji nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verberve”, përcakton përgjegjësitë e shtetit dhe të shoqërisë për këto kategori personash ku futen dhe femijet. Sipas ligjit, shteti dhe shoqëria marrin në mbrojtje personat e verber dhe krijojnë të gjitha kushtet për integrimin në jetën normale nëpërmjet punësimit të tyre duke përcaktuar profesionet që i pershtaten gjendjes së tyre fizike, sigurimin e kushteve optimale të jetes, dhenien e fondeve për depistimin dhe ridiagnostikimin në klinikat brenda dhe jashtë vendit etj (neni 2).

318. Gjithashtu ligji sanksionon detyrimin e shtetit për të mbrojtur të verberit nga të gjitha llojet e shfrytëzimit, diskriminimit, abuzimit, fyerjes dhe talljes.

319. Për të nxitur punësimin e kësaj kategorie personash, punëdhënësi përfiton ulje të tatimit mbi fitimin të barabartë me përqindjen e fuqisë punëtore të verber (neni 6).

320. Ligji parashikon dhe mundësinë e arsimimit falas të të verberve në sistemin shtetëror, por njëkohësisht dhe integrimin e tyre në arsimin e zakonshëm të mesëm ose të lartë, shpenzimet e të cilit përballohen nga shteti. Shkolla e specializuar 8-vjeçare për të verberit ka funksionuar shumë kohe para këtij Ligji, por ligji i fundit i siguron kësaj kategorie femijesh një mbrojtje me të madhe si në aspektin moral dhe në atë financiar. Sigurimi shëndetësor i femijes së verber bëhet nga shteti si dhe pagesa për mjekimin dhe medikamentet e nevojshme. Një rol të rëndësishëm në mbrojtje të të drejtave të të verberve luan dhe Shoqata e të Verberve të Shqipërisë, e cila jep mendime si për hartimin dhe ndryshimin e legjislacionit të lidhur me këto fushë dhe për mënyrën e zgjidhjes së problemeve të tyre.

321. Në ligjin nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, janë përfshirë kategoritë e personave që kanë shkallë të ndryshme të paaftesisë fizike, dhe të drejtat që kanë ata sidomos në aspektin ekonomik, si sigurimi i nivelit ekonomik të nevojshëm për të jetuar në mënyrë dinjitoze, punë të pershtatshme, lehtësim nga pagimi i taksave, mundësi për kurim, arsimim dhe veprimtari çlodhëse dhe argetuese.

322. Po t'i referohemi realitetit, ai eshte me pak favorizues nga parashikimet ligjore qe jane ne pjesen me te madhe te tyre favorizuese dhe ne nivelin e duhur per kushtet e Shqiperise, per kete kategori personash.

323. Persa i perket arsimimit te femijve me paaftesi mendore e fizike, ne ligjin nr. 7952, date 21.06.1995 "Per sistemin arsimor parauniversitar" eshte parashikuar nje kapitull per arsimin special publik, i cili trajtohet si pjese perberese e sistemit arsimor publik ne Republiken e Shqiperise. Sipas ligjit arsimit special publik synon te siguroje zhvillimin sa me te plote te mundesive te femijeve qe paraqesin paaftesi fizike, mendore ose emocionale, ne perputhje me nevojat e tyre dhe kerkesat per nje jete sa me dinjitoze. (neni 39). N.q.s eshte ne interes te femijes dhe me pelqimin e prinderve, arsimimi i ketyre femijeve kryhet falas ne institucionet arsimore publike. Ne kete rast shteti merr masa per sigurimin gradual te kushteve te nevojshme per realizimin e integritimit te tyre. Per femijet, kerkesat e te cileve nuk mund te plotesohen brenda sistemit shkollor te zakonshem, ngrihen klasa dhe institucione te posaçme, ku trajtimi i specializuar behet falas. (neni 40). Programet mesimore per femijet e paafta hartohen deri ne mbarim te arsimit te detyrueshem shkollor.

324. Megjithese ligji parashikon hapjen e degeve dhe kurseve per kualifikimin e kuadrove te arsimit special, kjo fushe le per te deshiruar, sidomos per trajtimin e femijve me paaftesi qe ndjekin sistemin e zakonshem arsimor. Per kete qellim jane bere perpjekje te vazhdueshme npr. seminareve dhe kurseve te kualifikimit edhe me ndihmen e OJQ-ve qe veprojne ne kete fushe, per ngritjen e kualifikimit te kuadrove.

325. Pavec percaktimit te statusit te invalidit ne pergjithesi, me ligjin nr 8626, date 22.06.2000, Kuvendi miratoi statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik. Nga ky ligj perfitojne te gjithe invalidet paraplegjike dhe tetraplegjike, pavaresisht nga mosha, koha, vendndodhja e aksidentit dhe casti i sigurimit. Pra, ligji parashikon edhe trajtimin e femijeve te mitur, pavaresisht se nuk shprehet ne menyre te vecante per ta.

326. Gjithashtu, ligji percakton detyrimin e shtetit per t'u krijuar kushte te semureve paraplegjike dhe tetraplegjike, me qellim qe ata te marrin pjese ne jeten shoqerore njelloj si te tjeret, duke iu siguruar nje nivel ekonomik te nevojshem per te jetuar ne menyre dinjitoze, kushte banimi, jetese e pune te pershtatshme, si dhe u krijon mundesi normale per kurim, arsimim, veprimtari clodhese, argetuese dhe sportive.

327. Personat juridike, shtetore ose private qe punesojne te semure paraplegjike dhe tetraplegjike, pavec kritereteve te percaktuara ne ligjin nr. 7955, date 20.09.1995 "Per nxitjen e punesimit", perfitojne per cdo vit kalendarik ulje tatimi mbi fitimin, te barabarte ne perqindjen e fuqise punetore te invalideve paraplegjike dhe tetraplegjike.

328. Ligji percakton detyrimin e shtetit per te marre masa per ngritjen e shkollave dhe te institucioneve per arsimimin, edukimin dhe rehabilitimin e invalideve paraplegjike dhe tetraplegjike. Gjithashtu, shteti e perjashton kete kategori personash nga pagesat per sigurimin shendetesor dhe u jep atyre te drejten e perfitimit falas te barnave per semundjen, pasoje e invaliditetit. Ligji gjithashtu parashikon edhe lehtesira te tjera per invalidet.

329. Ligji nr.7995, date 20.09.1995 "Per nxitjen e punesimit" ka parashikuar punesimin e personave me aftesi te kufizuar, kategori ku futen dhe femijet, per te cilet edhe ne kete ligj nuk ka kriteret e vecanta, por zbatohen dispozitat e parashikuara edhe per personat e moshave te tjera me aftesi te kufizuar. Ligji parashikon politikat shteterore te punesimit, nje nga synimet e te cilave eshte dhe riaftesimi profesional dhe zhvillimi i formave te tjera te mbeshtetjes per punesimin e personave me aftesi te kufizuar.

330. Gjithashtu, sipas ligjit, shteti merr te gjitha masat e nevojshme, te mundshme e praktike, per te krijuar dhe zhvilluar brenda kuadrit te zyrave te punesimit sherbimet e specializuara te formimit profesional per personat me aftesi te kufizuar, qe kerkojne ndihme ne zgjedhjen dhe nderrimin e punes (neni 14).

331. Ligji per punesimin detyron punedhenesit qe ne 25 te punesuar njeri te jete me aftesi te kufizuar. Per te inkurajuar punedhenesin zyrtar e punesimit kane te drejte te subvencionojne punedhenesin per te pajisur sic duhet vendin e punes te personit me aftesi te kufizuar. Te njejtat dispozita vlejne edhe per femijet invalide.

### C. Shëndeti dhe shërbimet shëndetësore (neni 24)

332. Kushtetuta ne nenin 55 sanksionon te drejten e shtetasve te gëzojnë në mënyrë të barabartë kujdesin shëndetësor shteteror. Sherbimi shendetesor ne Shqiperi rregullohet me ligjin nr. 3766, date 17.12.1963 "Per kujdesin shendetësor" me ndryshimet qe ka pesuar me vone me ligjin nr. 7718, date 03.06.1993 dhe Ligjin Nr. 7738, date 21.07.1993.

333. Ligji parashikon organizimin e sherbimit shendetësor ne institucione te ndryshme shteterore dhe private. Sipas ligjit kujdesi shendetesor shteteror sigurohet nepermjet edukimit shendetesor, kontrollit dhe masave profilaktike te pergjithshme, te vecanta dhe institucioneve perkatese, diagnostikimit, mjekimit dhe rehabilitimit te te semurit, etj.

334. Ligji nr 8167, date 21.11.1996 "Per sherbimin shendetesor stomatologjik" me ndryshimet perkatese, parashikon realizimin e sherbimit shendetesor stomatologjik, profilaktik dhe mjekues me shpenzimet e buxhetit te shtetit. Sherbimet shendetesore stomatologjike jane ngritur prane institucioneve shkollore me pajisje te siguruara nga Ministria e Shendetesise.

335. Kujdesi shëndetësor tregohet që para lindjes së fëmijës, me lindjen e tij dhe në vazhdimësi. Kjo është e lidhur me kujdesin që tregohet për nënën. Konkretisht

Kodi i Punës parashikon dhënien e lejes së paralindjes dhe paslindjes (neni 104 Kodi i Punës) dhe VKM nr. 397 datë 20.05.1996 "Për mbrojtjen e veçantë të grave shtatzëna dhe të amësisë".

Për fëmijët deri në 1 vjeç shteti siguron dhënien e ilaceve falas. Vaksinimi i fëmijëve nga 0-15 vjeç është i detyrueshëm për mbrojtjen nga sëmundjet ngjitëse (Ligji 7761 datë 19.10.1993 "Për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse"). Vaksinimi është falas.

336. Ligji nr. 8876 datë 4.4.2002 "Për shëndetin riprodhues" Neni 3 pika c, parashikon dhënien e shërbimeve për edukimin e fëmijëve, adoleshentët etj. Neni 7 i po këtij ligji parashikon mëmësi të sigurt që është e drejta e çdo gruaje të marrë kujdesin që i nevojitet për të patur një shëndet të mirë nga shtatzania dhe deri në lindjen e fëmijës.

337. Në po këtë ligj (kreu VI neni 37) theksohet se gjatë përdorimit të teknologjive riprodhuese të asistuara, nuk lejohet zgjedhja e seksit të ardhshëm të fëmijës. Kjo ka lidhje edhe njëhere me parimin e mosdiskriminimit në bazë seksi.

338. Vdekshmëria foshnjore 0-12 muaj dhe ajo feminare 0-5 vjeç, ka pësuar një ulje të vazhdueshme për këto dhjetë vitet e fundit. Aktualisht ajo është ulur 1/2 e nivelit të viteve 80-90. Por përsëri kjo vdekshmëri vazhdon të mbetet ndër më të lartat në Europë. Sëmundjet e rrugëve të frymëmarrjes, sëmundjet e të porsalindurit dhe sëmundjet diarrike janë shkaqet kryesore të kësaj vdekshmërie. Kequshqyerja dhe deficitet në disa vitamina dhe mikronutriente si vitamina A, D, jodi, hekuri, mbetet ende një problem madhor. Kështu rreth 25% e fëmijëve të moshës 0-3 vjeç në nivel kombëtar, vuajnë nga forma e mesme dhe e lehtë e kequshqyerjes, ndërsa 10% janë me formë të rëndë kequshqyerje. Kjo shifër është dy herë më e lartë në zonat verilindore të vendit.

339. Pamjaftueshmëria jodike e formës së rëndë është vërejtur në 63% të fëmijëve të grupmoshës 10-12 vjeç.

340. Në qytete ka njësi konsultore për gruan që funksionojnë me vete, por që janë në vartësi të qendrave shëndetësore ose poliklinikave. E njëjta gjë funksionon edhe për konsultorin e fëmijës. Numri i konsultoreve në qytete është 92 konsultore për gratë dhe 157 për fëmijët.

341. Në fshat konsultoret e nënës dhe fëmijës janë shërbime të përfshira në qendrat shëndetësore të komunave dhe, ose në ambulancat e fshatrave. Numri i ambulancave (pra dhe i konsultoreve) në fshatra është 1 300 dhe 530 konsultore në qendrat shëndetësore të komunave. Pra përveç ambulancave që ofrojnë këto shërbime, ekzistojnë edhe qendra të shpejta vetëm për shërbimin e gruas dhe fëmijës. Të gjitha spitalet ofrojnë shërbimet pediatrike dhe obstetrike-gjinekologjike.

342. Numri i përgjithshëm i mjekëve obstetrik gjinekologë është 194, i mjekëve pediater 214 dhe i pediaterve neonate 45. Raporti ndërmjet obstetër-gjinekologëve

dhe grave eshte 1 obsteter per 412 gra. Raporti ndermjet pediaterve dhe femijeve eshte 1 pediater per 349 femije.

343. Nje rendesi te madhe ne fushen e kujdesit shendetesor ka dhe ligji nr 7761, date 19.10.1993 “Per parandalimin dhe luftimin e semundjeve ngjitese”. Sipas ligjit, ne raste te dyshimit te semundjeve ngjitese ne institucionet shkollore dhe parashkollore, mjeku i institucionit eshte i detyruar te njoftoje organet perkatese dhe te kujdeset qe semundjet te mos prekin femijet e tjere si dhe femijet e semure te marrin kujdesin e duhur shendetesor.

344. Per shmangien e ketyre semundjeve, behet vaksinimi i detyrueshem, qe sipas ligjit, perfshin moshat nga 0-15 vjec. Per çdo femije qe hyn per here te pare ne shkolle, detyrohet pajisja e tij nga institucionet shendetesore me nje dokument qe provon vaksinimin e tyre sipas kalendarit.

345. Persa i perket te ushqyerit me gji, Kuvendi i Republikes se Shqiperise ka miratuar ligjin nr 8528, date 23.09.1999 “Per nxitjen dhe mbrojtjen e te ushqyerit me gji”. Ky ligj ka per qellim te nxise dhe te mbroje te ushqyerit me gji, si dhe te rregulloje tregtimin e zevendesuesve te qumeshtit te gjirit per te ushqyerit e shendetshem te femijeve. Ligji detyron prodhuesit, qe etiketa e prodhimit te permbaje formulimin se “ushqimi i gjirit eshte ushqimi ideal per rritjen e shendetshme dhe per zhvillimin e femijes”. Gjithashtu, ligji detyron qendrat shendetesore, vendore dhe kombetare, te nxisin, te mbeshtesin dhe te mbrojne te ushqyerit me gji dhe te bejne publike mangesite e medha qe krijon te ushqyerit alternativ.

346. Sherbimet ne fushen e planifikimit familjar jane ngritur prane materniteteve sidomos ne Tirane, por roli qe luajne ato eshte ende larg nivelit te duhur sidomos per zonat e fshatrave ku ky sherbim pothuajse nuk njihet. Vitet e fundit kene filluar te funksionojne dhe organizma jo-qeveritare ne formen e shoqatave ose fondacioneve ne fushen e planifikimit familjar, por qe jane ende te pakta ne numer.

347. Persa i perket kujdesit ndaj grave para dhe pas lindjes, ne Kodin e Punes jane parashikuar dispozita te veçanta per mbrojtjen e tyre. Sipas Kodit te Punes, ndalohet puna per grate shtatzena gjate 35 diteve qe paraprijne daten e parashikuar per lindje, 60 dite pas femijes se pare dhe 42 dite pas lindjes. (neni 104). Te ardhurat qe perfitojne ne rast lindje jane percaktuar ne “Ligjin mbi Sigurimet Shoqerore”, sipas te cilit Kodi i Punes i njeh te drejten e lejes se parashikuar nga Ligji mbi Sigurimet Shoqerore edhe ne rast se gruaja bireson nje femije te porsalindur.

348. Ne projekligjin “Per shendetin riprodhues”, ne pjesen “kujdesi per shendetin riprodhues”, perfshihen dhe:

- ? sherbimet e planifikimit familjar;
- ? kujdesi per gruan para, gjate dhe pas lindjes;
- ? kujdesi per femijen 0-6 vjec;



? informimi, edukimi dhe keshillimi per shendetin riprodhues.

349. Gjithashtu, projektligji percakton dhe nje sere te drejtash, lidhur me nenen dhe femijen, si e drejta per edukim ne fushen e te drejtave riprodhuese, e drejta per kujdes mjekesor dhe per sherbimet e nevojshme mjekesore, etj. Eshte menduar qe ne pjese te vecanta te tij projektligji te jete me shume deklarativ i cili nuk percakton se si funksionojne sherbimet e planifikimit familjar, si realizohet kujdesi per gruan, per femijen, etj. Te gjitha keto probleme dhe probleme te tjera te mundshme te cilat mund te verehen gjate dhe pas hyrjes se tij ne fuqi, sipas projektit, do te rregullohen me akte nenligjore te nxjerra nga Ministri i Shendetesise.

350. Ministria e Shendetesise ne bashkepunim me UNICEF ka ndermarre keto programe Kombetare:

- ✍ Nxitja e ushqyerjes me gji;
- ✍ Spitalet mig te femijeve;
- ✍ Administrimi i integruar i semundshmerise pediatrike MISP;
- ✍ Programi kombetar per vaksinimin;
- ✍ Programi kombetar per sistemin e alertit.

Ministria e Shendetesise publikon keto botime periodike:

- ✍ Revisten Shendeti Riprodhues
- ✍ Revisten periodike ENTERNOUS

351. Më poshtë paraqiten disa të dhëna statistikore mbi shëndetin publik në Republikën e Shqipërisë. (Burimi INSTAT)

Emertimi - Item	Treguesit e vaksinimit - Selected indicators										19
	1990	1991	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998		
<b>Femije te vaksinuar per tuberkulozin</b> Infants immunized aginst tuberculosis	94	80	81	82	87	97	94	94	87		
<b>Femije te vaksinuar per difterine</b> Infants immunized against diphtheria	90	78	94	99	96.3	97	98	98.6	96		
<b>Femije te vaksinuar per tetanozin</b> Infants immunized against tetanus	90	78	94	99	96.3	97	98	98.6	96		
<b>Femije te vaksinuar per pertusin</b> Infants immunized against pertussis	90	78	94	99	96.3	97	98	98.6	96		
<b>Femije te vaksinuar per fruthin</b> Infants immunized against measles	85	80	87	76	81.2	91	92	95	90		
<b>Femije te vaksinuar per poliometitin</b>	80	82	97	97	97	98	99.6	99.9	97		

## Vdekja Foshnjore Infant Mortality Rate

Emertimi - Item	VITET - YEARS								
	1990	1991	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998
<b>Numri i lindjeve</b> Number of Live births	82125	77361	75425	67730	72179	72081	68358	61739	60139
<b>Numri I vdekjeve</b> Number of deaths	2061	2547	2550	2401	2547	2162	1762	1387	1215
<b>Vdekshmeria foshnjore(per1000 lindje)</b> Infant mortality	28.3	32.9	32.8	35.4	28.3	30	25.8	22.5	20.5
<b>Vdekjet Perinatale ( per 1000 L.B)</b> Perinatal deaths	12.5	14.1	11.5	11.2	14.6	13.4	14.4	15.2	14.3
	ne %								
<b>Semundjet Respiratore</b> Respiratory diseases		37.2	39.4	41.5	42.5	37.7	34.8	30.9	30.3
<b>Semundjet gastrointestinale</b> Gastroinstinale diseases		9.1	10.5	9.4	11.1	13.1	7.7	8.1	8.8
<b>Semundje te te porsalindurit</b> New born diseases		9.9	11	11.1	10.9	13.3	19.8	22.6	24.7
<b>Semundje kongenitale</b> Congenital diseases		14.7	10	8.5	7.9	7.4	9.9	10.5	13.6
<b>Semundje infektive</b> Infection diseases		7.4	4.5	5.2	5.4	4.5	4.9	6	4.5
<b>Pa diagnoze</b> Without diagnosis		6.6	9.2	5.3	7.3	8.7	8.5	9.5	8.5

### STRUKTURA E VDEKSHMERISE FOSHNJORE INFANT MORTALITY STRUCTURE

Emertimi	1994	1995	1996	1997	1998	1999	Item
<b>LINDJET E GJALLA</b>	<b>72179</b>	<b>72081</b>	<b>68358</b>	<b>61739</b>	<b>60139</b>	<b>57948</b>	<b>NUMBER OF LIVE BORN</b>
<b>VDEKJET SIPAS GJINISE</b>	<b>2547</b>	<b>2162</b>	<b>1762</b>	<b>1387</b>	<b>1215</b>	<b>957</b>	<b>DEATHS BY SEX</b>
meshkuj	1390	1207	911	737	644	507	male
femra	1152	931	825	628	571	450	female
panjohur	5	24	26	22	...	...	unknown
<b>VDEKJET SIPAS VENDBANIMIT</b>	<b>2547</b>	<b>2162</b>	<b>1762</b>	<b>1387</b>	<b>1215</b>	<b>957</b>	<b>DEATHS BY RESIDENCE</b>
qytet	759	654	597	457	413	353	urban
fshat	1788	1508	1165	930	802	604	rural
<b>VDEKJET PER RRETH LINDJES</b>	<b>1040</b>	<b>966</b>	<b>984</b>	<b>937</b>	<b>851</b>	<b>733</b>	<b>NEONATAL DEATHS</b>
para lindjes	369	268	343	383	328	296	pre births
gate lindjes	161	121	128	90	70	46	during births
pas lindjes - d.e 6	510	577	513	464	453	391	after births-d.e6

**AKTIVITETI I KONSULTORIT TE FEMIJEVE**

Emertimi - Item	VITET – YEARS									
	1990	1991	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999
<b>Numri i konsultoreve te femijes</b> No. of child consultation	2890	2685	2480	2406	2268	2167	2167	2026	1661	1677
qytet- urban	160	143	157	164	191	176	181	177	175	157
fshat - rural	2730	2542	2323	2242	2077	1991	1986	1849	1486	1520
<b>Nr I vizitave ne konsultor ( ne mije)</b> Visit's number in consultation ( in thousand)	8167	5860	4249	4070	2272	2009	2363	1669	1374	1222
<b>Nr i vizitave ne konsultor fshat ( ne mije)</b> Visit's number in consultation ( in thousand)	5319	3500	2297	2210	1510	1303	1269	1077	791	826

**AKTIVITETI I QENDRAVE  
SHENDETESORE, POLIKLINIKAVE &  
AMBULANCAVE**

Emertimi - Item	VITET – YEARS										
	1990	1991	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	20
<b>Numri i institucioneve gjithsej</b> Number of institutions total	3302	3260	2967	3022	2733	2507	2437	2155	2253	2242	22
<b>Qendra shendetesore -Health Centres</b>	1046	1061	916	770	702	622	637	602	637	567	6
<b>Ambulanca -Ambulances</b>	2196	2139	1995	2191	1973	1832	1747	1500	1563	1624	15
<b>Poliklinika - Polyclinic</b>	60	60	56	61	58	53	53	53	53	51	

**TREGUES TE SHERBIMIT SPITALOR  
INDICATORS OF HOSPITAL SERVICE**

Emertimi	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	Item
	<b>Spitale</b>	51	51	51	51	51	51	
<b>shtriter gjithsej</b>	9661	10371	10319	10133	9480	10237	10197	<b>Total beds</b>
<b>shtrime gjithsej</b>	28199	288856	289268	255203	250043	265321	260770	<b>Total hospitalizations</b>

D. Sigurimi shoqëror, shërbimet dhe lehtësitë e kujdesit për fëmijën (neni 26 dhe 18, parag. 3)

352. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon të drejtën e kujtudo për sigurime shoqërore në pleqëri ose kur është i paafte për punë, sipas një sistemi të përcaktuar me ligj. Kushtetuta parashikon, gjithashtu të drejtën e ndihmës në kushtet e parashikuara me ligj, për kedo që mbetet pa punë, për shkak të pavarurisë nga vullneti i tij dhe që nuk ka mjete të tjera jetese. Pra, Kushtetuta nuk i ka

trajtuar ne menyre te vecante te drejtat e femijeve ne fushen e perkrahjes sociale dhe te sigurimeve shoqerore.

353. Ne ligjet per perkrahjen sociale dhe sigurimet shoqerore, sikurse ne Kushtetute, te drejtat e femijeve jane te trajtuara ne kuadrin e familjes dhe te kategorive te personave qe perfitojne prej tyre. Sistemi i ndihmes dhe i perkujdesjes shoqerore parashikohet ne ligjin nr. 7710, dt 18.05.1993 "Per Ndhimen dhe Perkujdesjen Shoqerore", ndryshuar me ligjin nr. 7886, dt 8.12.1994 dhe ligjin nr. 8008, dt 05.10.1995 si edhe me aktet nenligjore te nxjerra ne zbatim te tij nga Keshilli i Ministrave dhe Ministria e Punes dhe e Ceshtjeve Sociale.

354. Ndhime ekonomike mund t'u jepet familjeve qe perkujdesen per nje ose me shume anetare te saj, duke perfshire dhe femijet, te cilet jane:

- te verber
- te paafta mendore;
- me paaftesi te rende zhvillimi;
- personi i paafta qe nuk mund te kujdeset per vetveten dhe per pasoje ka nevojte per ndihmen e nje personi tjetar, me kusht qe keta te paafta te mos kene te ardhura ose t'i kene ato te pamjaftueshme dhe te mos jene te vendosur ne ndonje institucion publik te perkujdesjes shoqerore.

355. Me Vendimin nr. 311, date 11.07.1994, ndryshuar me vendimin nr. 457, date 21.08.1995 dhe me Udhezimin nr. 12, date 16.06.1998, parashikohen rastet per perfitimin e paaftesise. Perfitim paaftesie marrin:

- Te gjitha personat e lindur te paafta, ose qe jane bere te tille para moshes 21 vjec dhe deri ne moshen 24 vjec kur vazhdojne studimet e larta, te vertetuar nga Komisioni Mjekesor i Caktimit te Aftesise per Pune. Pagesa e perfitimit te paaftesise behet nje here ne muaj, duke filluar nga muaji pasardhes pas dates qe Komisioni percakton paaftesine. Masa e perfitimit te paaftesise eshte 70% e vleres se pages minimale dhe ndryshon sa here qe ndryshon kjo page. Te drejten e perfitimit te paaftesise e humbasin te gjitha personat e paafta, te cilet jane vendosur ne qendra rezidenciale riaftesuese publike per aq kohe sa qendrojne ne keto qendra si dhe personat e paafta qe hyjne ne marredhenie pune.
- Personat e paafta qe vazhdojne shkollen e mesme perfitojne dyfishin e pageses se paaftesise te percaktuar me lart dhe kur vazhdojne shkollen e larte perfitojne trefishin e pageses se paaftesise.
- Personat e paafta, ne rastet kur ne zonat qe ata banojne mungojne sherbimet ditore apo arsimi special dhe Komisioni Mjekesor i Caktimit te Aftesise per Pune percakton se keta persona kane nevojte per asistenc te panderprere, atehere nje anetar i familjes merr perfitim kujdestarie nese ai nuk ka te ardhura personale, masa e te ciles eshte 60% e vleres se pages minimale. Ky perfitim nuk merret ne rast se personi i paafta trajtohet prane qendrave ditore apo ne shkollat speciale.

356. Me ligjin per ndihmen dhe perkujdesjen shoqerore dhe me Vendimin nr. 307, date 24.05.1994 percaktohen sherbimet e perkujdesjes shoqerore. Sherbimet e perkujdesjes shoqerore perfshijne institucionet per personat e moshuar, per te paaftet fizike apo mendore, jetimet si dhe institucionet e tjera te ngjashme qe ndodhen ne vartesi te pushtetit qendror apo lokal. Keto sherbime perfshijne:

- sherbimet jashte institucionit, si qendra ditore (per femijet me paaftesi mendore dhe fizike, femije te rruges), sherbimet ne shtepi, ndihmat emergjente;
- sherbimet ne institucion per femijet jetime dhe te braktisur, femijet me paaftesi fizike dhe mendore, te paaftete per t'u kujdesur per veten, etj.

357. Jetimet dhe personat e paaftete pa asnje te ardhur pranohen pa pagese ne institucionet publike te perkujdesjes shoqerore. Shteti mbulon shpenzimet e mbajtjes se tyre ne institucion, si dhe nje kuote per shpenzime vetiake. Prinderit te cilet per arsye te ndryshme kerkojne te vendosin femijet ne shtepine e foshnjes e te femijes, marrin pjese ne shpenzimet e nevojshme ne raport me te ardhurat e tyre.

358. Personave qe jane vendosur ne institucionet publike te perkujdesjes shoqerore, mund t'u permiresohen kushtet e tyre kundrejt pageses per sherbime suplementare. Kerkesa per vendosje ne institucion per jetimet, individet me paaftesi fizike dhe mendore i drejtohet Keshillit te Rrethit, Bashkise ose Komunes sipas vartesis dhe behet nga kryefamiljari, nga administratori shoqeror, ose komisioni eksperto-mjekesor. Institucionet e perkujdesjes shoqerore mund te administrohen nga personat private dhe organizata jo-qeveritare ne baze te nje kontrate qe duhet te lidhin me Ministrine e Punes dhe Çeshtjeve Sociale.

359. Me Vendimin nr. 52, date 8.1.1996 te Keshillit te Ministrave "Per krijimin dhe funksionimin e Keshillit te Pergjithshem te Ndhimes dhe Sherbimeve Sociale si edhe te Administrates se Pergjithshme te Ndhimes dhe Sherbimeve Sociale", qe ka dale ne zbatim te ligjit "Per ndihmen dhe Perkujdesjen Shoqerore", eshte percaktuar organizimi dhe funksionimi i Keshillit te Pergjithshem te Ndhimes dhe Sherbimeve Sociale dhe te Administrates se Ndhimes Ekonomike dhe Perkujdesit Shoqerore, i cili luan nje rol te rendesishem ne kete fushe.

360. Keshilli krijon Administraten, e cila kryen detyren e drejtimit te pergjithshem te politikës sociale ne fushen e ndihmes sociale dhe te sherbimeve sociale. Administrata e pergjithshme e Ndhimes dhe Sherbimeve Sociale drejton sistemin e ndihmes dhe sherbimeve sociale, grumbullon te ardhura per kete qellim, financon projekte dhe programe te dorezuara dhe te administruara nga organet lokale, nga organizmat jo-qeveritare, nga donatore te huaj, me qellim perfitimin e ndihmes dhe te sherbimeve sociale. Administrata vepron nepermjet zyrave rajonale dhe lokale qe veprojne ne te gjithe vendin, per te zbutur varferine dhe per te siguruar sherbime te tjera nepermjet granteve te akorduara sipas programeve te ndihmes dhe sherbimeve sociale neper bashki dhe komuna.

361. Persa i perket perfitimit nga sigurimet shoqerore, femijet perfitojne ne forma te ndryshme sipas pozicionit ne te cilin ndodhen. Ne baze te ligjit nr. 7703, date 11.05.1993 "Per Sigurimet Shoqerore ne Republiken e Shqiperise", femijet perfitojne nga sigurimi i detyrueshem kur jane te punesuar ne raste te paafetise se perkoheshme ne pune per shkak semundjeje, invaliditeti, humbjen e mbajtesit te familjes, aksidenti ne pune dhe semundjeje profesionale, papunesie. Perfiton pension familjar nga personi qe vdes dhe qe perfitonte ose kishte kushtet per pension shteteror suplementar, jetimi, i cili eshte ne ngarkim te personit te siperpermendur ne masen 25 % te pages referuese sipas percaktimit te ligjit.

362. I siguruari qe merr pension invaliditeti kur ka femije ne ngarkim deri ne moshen 15 vjeç, merr nje te ardhur shtese familiare per çdo femije ne masen 5 % te pensionit baze, por jo me shume se 20 %. Pension familjar merr jetimi kur provohet se ai ishte ne ngarkim te personit qe vdiq dhe ka nje moshe nen 18 vjeç, ose deri ne 25 vjeç ne qofte se studion, ose eshte i paafte per pune, para se te arrije moshat e mesiperme.

363. Jetimi ka te drejten e nje pensioni familjar edhe ne qoftese prindi qe jeton eshte i punesuar ose merr nje pension. Ne kete rast shuma e pensionit qe i jepet jetimit nuk kapercen 50 % te pensionit qe merrte ose qe do te merrte personi qe vdes.

364. Persa i perket te ardhures nga papunesia keto te ardhura jane nje shume baze qe siguron te pakten nje nivel jetese-minimal, çdo vit e indeksuar me vendim te Keshillit te Ministrave. Perfituesi me femije ne ngarkim deri ne moshen 15 vjeç merr nje shtese familjare per çdo femije ne masen 5 % te te ardhurave mujore nga papunesia, por jo me teper se 20 % per te gjithë femijet ne ngarkim. Kur njeri nga prinderit eshte ne marredhenie pune ose merr pension te plote, shtesa familjare pergjysmohet, d.m.th. 2.5 % per çdo femije deri 15 vjeç ne ngarkim, por jo me shume se 10 % per te gjithë femijet ne ngarkim.

365. Kur prinderit jane te divorcuar, shtesen familjare e merr prindi qe ka femijet ne ngarkim. Ne rast se prindi tjetër paguan detyrimin ushqimor, shtesa familjare jepet ne masen 2.5 %.

366. Ne Shqiperi, sidomos ne plan lokal, ekziston nje numer i konsiderueshem institucionesh dhe sherbimesh shteterore ose private, te cilat ndihmojne prinderit ne menyra te ndryshme. Prinderit qe ndodhen ne marredhenie pune, ose qe nuk kane mundesi te kujdesen gjate dites per femijet e tyre mund t'i lene nen kujdesin e personave te specializuar ne çerdhe, kopshte, dhe ne shkolla per ata femije qe kane arritur moshen perkatese.

367. Pas viteve 90-te ne vendin tone jane verifikuar dhe mjaft sherbime te tjera te specializuara te huaja ose shqiptare per kujdesin ndaj femijeve. Nje pjese e konsiderueshme e ketyre institucioneve dhe sherbimeve administrohen nga shteti ne perpjekje per te ofruar sherbime sa me bashkekohore dhe cilesore. Ne kete drejtim nje ndihmese kane dhene dhe O.J.Q.-te vendase dhe te huaja, qe me

projektet e tyre kane bere te mundur permiresimin e sherbimeve ekzistuese, ose krijimin e sherbimeve te reja.

368. Detyra e shtetit per te mbeshtetur prinderit ne permbushjen e detyrimeve te tyre kundrejt femijes shprehet edhe ne fushen e te drejtes se punes dhe te sigurimeve shoqerore. Keshtu, ne dispozitat e Kodit e Punes parashikohet perfitimi i pages per jo me shume se kater dite ne vit per punemarresin ne rast perkujdesje per femijet ne ngarkim. Gjithashtu Kodi i Punes i jep te drejten e pushimit te siperpermendur per tu kujdesur per femijen, si nenes ashtu edhe babait, duke konfirmuar dhe nje here pergjegjesine e perbashket ne edukimin dhe zhvillimin e femijes.

369. Projekti i ri i Kodit te Familjes, ne trajtimin e pergjegjesive prinderore, ka marre ne konsiderate te plote aktet nderkombetare, sidomos Konventen per te drejten e Femijes dhe Rezolutat e Keshillit te Europes.

#### E. Standarti i jeteses (neni 27, paragrafët 1 dhe 2)

370. Ne Kodin e Familjes, parashikohet pergjegjesia e prinderve per mirerritjen dhe edukimin e femijes (neni 7). Ligji parashikon dhenien e ndihmes ekonomike familjeve te shtetasve shqiptare te cileve u mungojne te ardhurat dhe mjetet e jeteses krejtesisht, ose i kane ato te pamjaftueshme. Ne rastet kur eshte e nevojshme dhe e mundshme, ne vend te ndihmes ekonomike, ose si shtese e saj, ofrohen sherbimet publike te perkujdesjes shoqerore.

371. Ndhima ekonomike u jepet familjeve te shtetasve shqiptare te cilet kane te ardhura te pamjaftueshme ose nuk kane te ardhura materiale jetese nga veprimtari te ligjshme te parashikuara ne ligj.

372. Ndhime ekonomike e pjesshme mund t'u jepet edhe familjeve bujqesore per te plotesuar te ardhurat e pamjaftueshme duke marre ne konsiderate gjate percaktimit te se drejtes se perfitimit te ndihmes ekonomike, burimet e te ardhurave te tyre nga:

- toka (pervec tokes ne proces shfrytezimi);
- bagetia, kafshet dhe shpendet;
- vreshtat, kopshtaria dhe mbajtja e bleteve.

373. Ndhima ekonomike e plote dhe e pjesshme jepet periodikisht si pagese e menjehershme. Organi qe percakton masen e ndihmes ekonomike mujore per familjen eshte Keshilli i Bashkise dhe i Komunes.

374. Masa e ndihmes ekonomike mujore qe u akordohet familjeve, nuk mund te jete me e madhe se 100% e nivelit maksimal te ndihmes ekonomike te percaktuar nga Keshilli i Ministrave. Sasia e ndihmes ekonomike i jepet familjes, ne baze te

vendimit qe merret nga keshilli bashkise ose komunes, pasi jane analizuar nevojat e saj. Ndihma eshte:

- e plote, per rastet kur mungojne te ardhurat krejtesisht;
- e pjesshme, kur ploteson te ardhurat e pamjaftueshme ne baze te vendimit te keshillit te Bashkise ose Komunes.

375. Ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 620, date 6.11.1995 "Per dhenien e ndihmes ekonomike" parashikohet se per te percaktuar nivelin maksimal te ndihmes ekonomike te plote mujore, merret ne konsiderate niveli baze i pageses se papunesise. Niveli maksimal i ndihmes ekonomike te plote mujore qe perfiton familja nuk mund te jete me i madh se 250% te nivelit baze te pageses se papunesise.

376. Masa e ndihmes ekonomike te plote mujore per familjen perbehet nga dy pjese:

- shuma baze e cila i jepet vetem kryefamiljarit dhe nuk mund te jete me e madhe se 95% e nivelit baze te pageses mujore te papunesise;
- nje perqindje mbi shumen baze, per cdo anetar tjeter te familjes, si me poshte:
  1. jo me shume se 100% e kryefamiljarit, nese anetari eshte mbi moshe pune, ose i paaft fizikisht a menderisht,
  2. jo me shume se 20% e kryefamiljarit, nese eshte ne moshe pune,
  3. jo me shume se 25% e kryefamiljarit, nese eshte nen moshen e punes.

377. Niveli maksimal i ndihmes ekonomike mujore te plote ndryshon ne perputhje me ndryshimin e nivelit baze te pageses mujore te papunesise. Ndihma ekonomike mujore e pjesshme qe perfiton familja eshte diferenca midis nivelit maksimal te ndihmes ekonomike mujore te plote dhe te ardhurave aktuale te familjes te siperpermendura.

378. Familja qe pretendon ndihme ekonomike perjashtohet nga perfitimi i ndihmes, neqoftese te pakten nje anetar i familjes ploteson nje nga kushtet e meposhtme:

- eshte pronar i cdo lloj kapitali, me perjashtim te shtepise se banimit dhe tokes bujqesore qe shfrytezon;
- eshte i vetepunesuar ose i punesuar te tjeret;
- eshte jashte shtetit per cdo arsye, me perjashtim te studimit ose kurimit mjekesor per nje periudhe per 6 muaj;
- nuk eshte regjistruar ne zyren e punes si i papune dhe si kerkues pune, me perjashtim te anetareve te familjes bujqesore;



- refuzon pjesemarrjen ne pune, kur ajo i ofrohet nje anetari te afte per pune dhe ne moshe pune;
- nuk ka paguar detyrimet ndaj shtetit ne periudhen kur ka qene i punesuar;
- refuzon kualifikimin dhe rikualifikimin;
- ndryshon vendbanimin, duke braktisur ne vendbanimin e vjeter pronat e tij dhe burimet e jeteses. Perjashtohen nga ky rregull personat qe ndryshojne vendbanimin per arsye te detyruara, ose te kerkuara nga shteti dhe kur perben rast te vecante, sipas vendimit te Keshillit te Komunes se vendbanimit te vjeter;
- nuk terheq ndihmen ekonomike te akorduar brenda periudhes per te cilen jepet;
- konstatohet se ndermerr veprime te qellimshme per te perfituar ndihme ekonomike, si shmangie e punesimit dhe e kualifikimit per punesim, dhurim spekulativ i kapitalit, deklarim jo real i kushteve te jeteses, etj.

379. Zyrat e punes, organet tatimore, Inspektoriati i Punes dhe Inspektoriati i Ndhimes Ekonomike, informojne Keshillat e Bashkive dhe Komunave per cdo familje qe perjashtohet nga perfitimi i ndihmes. Keshilli i Bashkise, ose komunes percakton periudhen e perfitimit ne perputhje me natyren e tij.

380. Periudha e perfitimit si rregull nuk e kalon afatin 1-mujor. Familja dhe personat qe perfitojne ndihmen, deklarojne se kushtet e tyre nuk kane ndryshuar ne menyre qe te perfitojne pagesen per periudhen pasardhese. Deklarimi shoqerohet me vertetimin e zyres se punes perkatese, se nuk ka mundesi punesimi.

381. Femijet e mbetur pa prinder dhe pa perkrahje rriten dhe edukohen nga shteti (neni 10). Sipas Kodit te Familjes, prinderit detyrohen te ushqejne femijet e tyre te mitur kur keta nuk kane mjete te mjaftueshme per te jetuar. Detyrimi per ushqim vazhdon edhe per kohen qe femijet ndjekin shkollen e mesme ose te larte deri ne moshen 25 vjeç. Prinderit nuk shkarkohen nga detyrimi per te ushqyer femijet e tyre edhe sikur tu jete hequr e drejta prinderore (neni 79,80).

382. Ne Kodin e Procedures Civile parashikohet se ne padine per shkuorezim kerkohet edhe detyrimi i bashkeshortit tjetër per te perballuar shpenzimin per ushqimin dhe edukimin e femijeve me perjashtim te rastit kur kjo do te veshpiresonte shqyrtimin e çeshtjes (neni 364). Ndersa ne Kodin e Familjes eshte percaktuar se me vendimin e zgjidhjes se martesës gjykata zgjidh edhe çeshtjen se cilit prind do t'i besohet femija per rritje dhe edukim dhe cili do te jete kontributi i nevojshem per rritjen dhe edukimin e femijes (neni 97,99).

383. Pra, Kodi i Familjes e percakton qarte se eshte e detyrueshme per gjykatën qe ne vendimin e zgjidhjes se martesës te vendose edhe per kontributin e nevojshem, qe duhet per rritjen dhe edukimin e femijes, nderkohe qe Kodi i Procedures Civile le shteg kur shprehet "me perjashtim te rastit kur kjo do te

veshtiresonte shqyrtimin e çeshtjes”. Kodi i Familjes parashikon detyrimin per ushqim qe prinderit kane ndaj femijes se tyre. Sipas ketij kodi, prinderit nuk shkarkohen nga detyrimi per ta ushqyer femijen e tyre edhe sikur t’u jete hequr e drejta prinderore (neni 79). Prinderit kane detyrimin te ushqejne femijen e tyre te mitur kur keta nuk kane mjete te mjaftueshme per te jetuar, detyrim ky qe vazhdon deri ne moshen 25 vjec, ne qofte se femija ndjek shkollen e mesme ose te larte (femija konsiderohet i mitur deri ne 18 vjec).

384. Ne rastin kur prinderit zgjidhin martesen, Gjykata ne vendimin e saj per zgjidhjen e marteses percakton edhe detyrimin ushqimor qe duhet te paguaje prindi, te cilit nuk i eshte lene femija per rritje dhe edukim. Kodi i Procedures Civile parashikon si detyrim edhe caktimin ne kerkese padi per zgjidhjen e marteses, te burimeve dhe te sasise se te ardhurave qe siguron cdo bashkeshort, nese kane femije te mitur, ose ndonjeri prej tyre eshte i paaftë per pune (neni 358). Kjo dispozite detyron jo vetem bashkeshortet, por edhe gjykatën te percaktoje ne menyre te sakte dhe te detyrueshme te ardhurat e bashkeshortëve dhe ne raporte me te ardhurat e tyre dhe detyrimet qe ka prindi ndaj femijes. Ne qofte se keto detyrime nuk percaktohen qarte, atehere personat qe kane nevojë per ndihme financiare do te perfitojne nga ndihma sociale, sipas kerkesave te ligjit per te patur burime financiare te nevojshme per te jetuar.

385. Nga pushteti gjyqesor vitet e fundit vihen re dy te meta:

- a. detyrimi ushqimor qe akordon gjykata ne pergjithesi, nuk eshte i mjaftueshem per te siguruar rritjen dhe edukimin e femijes. Ne pjesen me te madhe te rasteve vendimet e gjykates nuk japin argumentet e nevojshme per te justifikuar percaktimin e mases se pensionit ushqimor. Ne raste te tjera ka veshtiresi te provohen te ardhurat qe siguron prindi, i cili nuk ka femijen ne ngarkim, por qe duhet te paguaje detyrimin per ushqim. Kjo ndodh per faktin se nje numer i konsiderueshem personash nuk regjistrojne aktivitetin e tyre sipas kerkesave te ligjit, ose nuk kane lidhur kontrate per punen qe kryejne. Sigurisht, kjo bie ndesh me interesat e te miturit per t’iu siguruar nje nivel jetese te mjaftueshem per zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror.
- b. Gjykatat keto dy vitet e fundit, ne nje pjese te vendimeve te tyre nuk shprehen fare per detyrimin per ushqim, nderkohe qe ne Kodin e Familjes, i cili eshte ende ne fuqi, ky eshte nje detyrim.

386. Nga studimi i praktikës gjyqesore konkrete te 10 viteve te fundit rezulton se ka raste kur prindi ushtron veprimtari private por nuk paguan tatimet dhe nuk e deklarën kete aktivitet. Gjykata, ne rast se nuk ka dokumentacionin e duhur nuk vendos mbi bazen e nje burimi financiar. Po keshtu problematike eshte edhe emigrimi i shume prinderve (kryesisht burra) te cilet duke qene larg, kane zgjidhur martesën dhe nuk paguaje detyrimin ushqimor. Ne keto raste gjykata nuk mund te njohe burimet financiare reale te tyre dhe pergjithesisht vendos nje shume mbi bazen e pageses qe i jepet ne rastet e papunesise. Keto vendime mbeten te pazbatuara sepse prindi debitor nuk merr me pagese papunesie, pasi eshte larguar

dhe nuk ploteson kushtet e ligjit për ta përfituar, ose në raste të tjera problem është moszbatimi i vendimeve, pasi organet kompetente të shteteve ku kanë emigruar nuk i njohin vendimet e gjykatave shqiptare.

## **ARSIMI, KOHA E LIRE DHE AKTIVITETET KULTURORE (nenet 28, 29 dhe 31)**

### A. Arsimimi, duke përfshirë trajnimin profesional dhe administrimin (neni 28)

387. Në Kushtetuten e Republikës së Shqipërisë është sanksionuar parimi se kushdo ka të drejtën për arsimim (neni 57). Fushë e rëndësishme e zbatimit të të drejtave të fëmijës është arsimi dhe shkolla, legjislacioni arsimor, veprimtaria mësimore-edukative në shkollë dhe jashtë saj.

388. Aspektet e ligjit “Për sistemin arsimor parauniversitar”, përfshijnë kërkesat e Marrëveshjeve Ndërkombëtare të sipërpërmendura dhe të ratifikuara nga Shqipëria, në mënyrë të veçantë, të drejtat arsimore të fëmijës, sipas: nenit 26 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut; neneve 27-28 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, neneve 13-14 të “Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale e Kulturore”, nenit 18 të “Paktit ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike”, nenit 9-12 të Konventës Europiane “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore”, nenit 7 të Konventës ndërkombëtare “Për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial”, nenit 10 të Konventës “Për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave”, neneve 2-5 të Konventës “Për Luftën Kundër Diskriminimit në Fushën e Arsimit”.

389. Përgatitja e fëmijëve për të hyrë në arsimin e detyrueshëm 8-vjeçar, kryhet në kopshte, drejtimi dhe administrimi i të cilave bëhet nga shteti dhe nga subjektet private. Ministria e Arsimit është organi përgjegjës për administrimin e kopshteve shtetërore në të cilat pranojnë fëmijë të moshës 3-6 vjeç.

390. Tabelat e mëposhtme nga Instituti i Statistikes - INSTAT, japin një pasqyrë të plotë të sistemit parashkollor në Republikën e Shqipërisë për periudhën 1990-2000.

**NIVELI 0 - KOPSHTE GJITHSEJ DHE ME USHQIM**  
**LEVEL 0 - TOTAL NUMBER OF KINDERGARDEN AND WITH MEAL**

Viti shkollor School year	Kopshte gjithsej Kindergardens			Kopshte me ushqim With food	
	Gjithsej	Qytet	Fshat	Gjithsej	Ne fshat
	Total	Urban	Rural	Total	Rural
1990-91	3426	804	2622	665	351
1991-92	3174	793	2381	384	69
1992-93	2784	676	2108	221	9
1993-94	2656	362	2294	111	3
1994-95	2668	334	2334	90	-
1995-96	2670	333	2337	93	-
1996-97	2656	338	2318	100	-
1997-98	2408	328	2080	100	-
1998-99	2330	382	1948	97	-
1999-2000	2111	380	1731	97	-

**NIVELI 0 - FEMIJE TE REGJISTRUAR NE KOPSHTE GJITHSEJ**  
**DHE ME USHQIM**  
**LEVEL 0 - NUMBER OF CHILDREN REGISTERED IN**  
**KINDERGARDEN AND WITH MEAL**

Viti shkollor School year	Femije ne kopshte gjithsej Total childrens			Ne kopshte me ushqim With food	
	Gjithsej	Qytet	Fshat	Qytet	Ne fshat
	Total	Urban	Rural	Urban	Rural
1990-91	130007	61192	68815	31820	5342
1991-92	108889	54573	54316	23823	1088
1992-93	81117	38055	43062	9047	162
1993-94	80395	32274	48121	4290	-
1994-95	80394	32650	47734	5448	-
1995-96	84536	34495	50041	6846	-
1996-97	84232	34389	49843	8726	-
1997-98	80418	33741	46677	8370	-
1998-99	81734	37013	44721	9173	-
1999-2000	80337	36600	43737	10185	-

**NIVELI 0 - EDUKATORE NE KOPSHTE DHE FEMIJE PER NJE EDUKATORE**  
**LEVEL 0 - NURSEMAIDS AND CHILDREN / NURSEMAIDS RATIO**

Viti shkollor School year	Numri i edukatoreve Nursemaids				Femije per nje edukatore Children/nursemaid ratio	
	Gjithsej Total	Ne qytet In urban	Ne fshat In rural	Me arsim te larte ne % As tertiary education in %	Gjithsej Total	Ne fshat In rural
1990	5664	2771	2893	5	23	24
1991	5440	2787	2653	5	20	20
1992	5081	2407	2674	5	16	16
1993	4578	1789	2789	4	18	17
1994	4428	1691	2737	4	18	17
1995	4416	1697	2719	6	19	18
1996	4463	1732	2731	8	19	18
1997	4116	1704	2412	7	20	19
1998	4092	1779	2313	10	20	19
1999	3806	1737	2069	15	21	21

**NIVELI 0 - FEMIJE NE KOPSHT NE RAPORT ME GRUP-MOSHEN**

**3 DERI 5 VJEÇ TE POPULLSISE**

**LEVEL 0 - NUMBER OF CHILDREN IN KINDERGARDEN,  
COMPARED WITH 3-5 YEAR AGE-GROUPS OF POPULATION**

	Viti shkollor - School year	
	1998/99	1999/00
<b>1 - Grup-mosha 3-5 vjeç e popullsisë</b>	<b>218696</b>	<b>214200</b>
Age-grups 3-5 year of population		
- Meshkuj - Male	112766	110363
- Femra - Female	105930	103837
<b>2 - Femije ne kopshte gjithsej</b>	<b>81734</b>	<b>80337</b>
Total children		
- Meshkuj - Male	40784	39549
- Femra - Female	40950	40788
<b>3 - Diferenca (1-2) femije qe nuk shkojne ne kopshte</b>	<b>136962</b>	<b>133863</b>
Change (1-2) children not including in kindergardens		
- Meshkuj - Male	71982	70814
- Femra - Female	64980	63049
<b>4 - % e femijeve te regjistruar ne kopshte</b>	<b>37</b>	<b>38</b>
In % registered children in kindergardens		
- Meshkuj - Male	36	36
- Femra - Female	39	39

NIVELI 0 - ARSIMI PARASHKOLLOR SIPAS RRETHEVE VITI 1999/2000  
 LEVEL 0-PRE-PRIMARY EDUCATION BY DISTRICTS, YEAR 1999/2000

Rrethet Districts	Kopshte Kindergardens	Femije te rregjistruar Registered childrens	Edukatore Nursemaids
Gjithsej - Total	<b>2111</b>	<b>80337</b>	<b>3806</b>
Berati	83	3220	139
Bulqiza	34	938	52
Delvina	23	573	35
Devolli	35	1761	68
Dibra	100	2478	130
Durresi	78	4135	177
Elbasani	108	5010	243
Fieri	92	3781	174
Gramshi	58	1502	77
Gjirokastra	94	2009	113
Hasi	26	599	29
Kavaja	58	2384	102
Kolonja	21	765	45
Korca	107	5407	256
Kruja	31	1556	72
Kucova	22	973	48
Kukes	69	2604	110
Kurbini	21	1460	58
Lezha	47	1979	89
Librazhdi	81	2301	111
Lushnja	121	4040	184
M. Madhe	39	938	45
Mallakastra	18	725	37
Mati	46	1550	71
Mirdita	45	1049	57
Peqini	27	754	33
Permet	30	1097	47
Pogradec	46	2695	116
Puke	52	1230	69
Sarande	29	1045	52
Skrapar	38	1160	62
Shkoder	104	3770	177
Tepelene	74	1480	74
Tirane	102	3037	137
B. Tiranës	39	5349	252
Tropoje	19	555	38
Vlore	94	4428	277

391. Legjislacioni arsimor shqiptar, ashtu si legjislacioni shqiptar në tërësi, është fryt edhe i përpjekjeve për ta përshtatur atë ndaj standarteve demokratike të legjislacionit ndërkombëtar, përkatësisht akteve të OKB-se dhe atyre europiane, si një shprehje e aspiratës mbarë-shqiptare për integrimin Euro-Atlantik.

392. Neni 122 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcakton se marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara përbëjnë pjesë të sistemit të brendshëm juridik dhe kanë epërsi mbi ligjet e vendit. Neni 1 i ligjit për Sistemin arsimor parauniversitar thekson se “Arsimi në Republikën e Shqipërisë është përparësi kombëtare”, “kryhet në përputhje me marrëveshjet dhe traktatet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe respekton të drejtat e fëmijës dhe të të rriturve të sanksionuara në këto dokumenta”.

393. Në dekadën e fundit të shekullit të 20-të, në Shqipëri kishte një sistem kombëtar arsimor të kompletuar me institucione arsimore të të gjitha niveleve nga ai parashkollor deri në institucione arsimore pasuniversitare. Treguesit sasiorë të zhvillimit të arsimit parauniversitar në vitin 1990 vlerësonin se e ndiqnin: arsimin parashkollor 56% të fëmijëve 3-5 vjeçarë, arsimin e detyruar 8-vjeçar 96-98% e nxënësve, që i përfshinte detyrimi shkollor, arsimin e mesëm rreth 70% të nxënësve që përfundonin klasën e 8-të.

394. Gjatë periudhës së tranzicionit një ndër dukuritë negative, që u shfaq në arsim, ishte fakti që, në grupmosha të ndryshme fëmijësh ulet ndjeshëm mundësia për të përfituar veçanërisht nga arsimi parashkollor dhe ai i mesëm, edhe në arsimin e detyruar 8-vjeçar ulet numri i nxënësve.

395. Treguesit statistikorë të regjistrimit të fëmijëve në institucionet arsimore në vitin 2000 janë përkatësisht: në arsimin parashkollor: 36% e fëmijëve 3-5 vjeçarë, në arsimin e detyruar 8-vjeçar 543.967 nxënës dhe në atë të mesëm 102.971 nxënës.

396. Në vitin shkollor 2000-2001 kanë funksionuar 2002 institucione parashkollore (kopshte fëmijësh) me 80.443 fëmijë dhe 3.749 mesuese parashkollore, nga 80.337 fëmijë në vitin shkollor 1999-2000. Është rritur përfshirja e 5000 fëmijëve.

397. Fëmijët përfshihen në arsimin e detyruar pasi mbushin moshën 6 vjeç. Fëmijët mund ta zgjedhin pjesërisht arsimimin apo formën e trajnimit në shkolla të veçanta të arsimit të detyruar, si ato të artit, por më shumë fëmijët realizojnë zgjedhjet e tyre në shkollat e arsimit të mesëm dhe të lartë.

398. Në vitin shkollor 2000-2001 funksionojnë 1.820 shkolla 8-vjeçare dhe 1.395 shkolla vartëse, me 535.238 nxënës (prej të cilëve 259.931 femra) dhe 28.321 mësues. Është ulur përqindja e nxënësve që kanë braktisur shkollën 8-vjeçare të detyruar: nga 3,01 % (16.730 nxënës) në qershor të vitit shkollor 1998 - 1999, në 2,6% (14.163 nxënës) në qershor të vitit shkollor 1999 - 2000.



399. Në vitin shkollor 1999-2000 në të gjithë vendin kanë funksionuar 388 shkolla të arsimit të mesëm (nga të cilat 43 shkolla teknike e profesionale), ku kanë studiuar 102.971 nxënës. Është rritur numri me 4.250 nxënës në krahasim me vitin 1998. Në vitin shkollor 2000-2001 kanë funksionuar 373 shkolla të arsimit të mesëm (nga të cilat 43 shkolla teknike e profesionale), me 107.435 nxënës. Ka një rritje prej 4.500 nxënësish në krahasim me vitin e kaluar mësimor 1999 - 2000.

400. Në vitin shkollor 2000-2001 janë tërhequr në arsimin e mesëm 63% të nxënësve, që kanë mbaruar arsimin 8- vjeçar ose 2% më shumë se në vitin mësimor 1999-2000.

401. Dispozitat ligjore mbi arsimin e detyrueshëm përfshihen në ligjin nr. 7952, datë 21.06.1995 "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar". Ky ligj sanksionon në tërësi kërkesat, parimet dhe standartet e Marrëveshjeve Ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, veçanërisht të të drejtave të fëmijëve, në fushën e arsimit.

402. Ky Ligj sanksionon:

- të drejtën e barabartë të shtetasve të Republikës së Shqipërisë për t'u arsimuar në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, pavarësisht nga gjendja sociale, kombesia, gjuha, seksi, feja, raca, bindjet politike, gjendja shendetesore dhe niveli ekonomik (neni 3);
- të drejtën e pakicave kombëtare për arsimim në gjuhën amtare, për mësimin e historisë dhe të kulturës kombëtare të tyre (neni 10);
- të drejtën e fëmijëve të moshës 3-6 vjeç për arsimim parashkollor publik (nenet 17-19);
- arsimin e detyruar publik, i njësuar dhe i përgjithshëm në gjithë territorin e Republikës, (8-vjeçar, në dy cikle 4-vjeçare, fillor dhe të lartë), (nenet 20, 22);
- detyrimin e prindërve për dërgimin e fëmijëve të moshës 1-16 vjeç në arsimin e detyruar (neni 24) dhe denimin për kundërvajtje administrative me gjobe të prindërve, fëmijët e të cilëve braktisin pa arsye arsimin e detyruar (nenet 59);
- ndalimin e punësimit të fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor dhe, në rast të kundërt, denimin e punëdhënesit shtetëror ose privat për kundërvajtje administrative me gjobe (neni 60);
- të drejtën e shtetasve për arsimim në shkollat e mesme publike, të përgjithshme dhe profesionale, pas përfundimit të arsimit të detyruar (nenet 26-28 dhe 33-37);
- të drejtën e nxënësve për arsimim në kurse me lende me zgjedhje në arsimin e mesëm të përgjithshëm publik (neni 31);
- të drejtën e fëmijëve me nevojë të vecanta për arsimim special publik falas dhe detyrimin e shtetit për sigurimin gradual të kushteve të nevojshme për këtë qëllim (neni 40);
- të drejtën e fëmijëve, që përbëjnë raste të vecanta, për arsimim të detyruar pranë familjeve në rrugë private (neni 49);
- të drejtën e kuadrit arsimor publik për kualifikim (nenet 14,41);
- të drejtën e shtetasve shqiptarë dhe të huaj për ndjekjen e arsimit privat, laik e fetar (nenet 43-48) dhe për kalim nga shkollat private në ato publike (neni 45);

- të drejtën e shtetasve për ndjekjen e strukturave plotësuese të arsimit (neni 50);
  - detyrimin e shtetit për të garantuar të drejtën e sigurimit të jetës dhe të veprimtarisë së mësuesve dhe të nxënësve, si dhe paprekshmërinë e institucioneve arsimore dhe të territoreve të tyre (neni 66);
  - synimin dhe misionin e arsimit parauniversitar shqiptar: për emancipimin shpirtëror;
- progresin material dhe zhvillimin social të individit (neni 2); për zhvillimin e aftësive intelektuale, krijuese, praktike e fizike dhe të personalitetit të nxënësve në arsimin e detyruar publik (neni 21); për zhvillimin në mënyrë të plotë dhe harmonike të personalitetit të nxënësve në arsimin e mesëm publik (neni 26).


403. Statistikat e fundit në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për numrin e shkollave të sistemit parauniversitar, për vitin 2000-2001 janë:

Institucione:	publike:	private:
- Kopshte	1852	55
- Shkolla 8-vjeçare	1798	55
- Shkolla të mesme	375	32

404. Përsa i përket arsimit të mesëm publik, ky arsim organizohet sipas niveleve të ndryshme të shkollimit, dhe dallimeve të përmbajtjes dhe të profileve profesionale, ndërsa për fusha specifike, si ato artistike, social kulturore etj funksionojnë shkolla të mesme publike të veçanta (neni 27,32).

405. Numri i përgjithshëm i nxënësve dhe i mësuesëve në 10 vitet e fundit:

<u>Institucionet:</u>	<u>N x ë n ë s</u>		<u>M ë s u e s</u>	
	<u>Viti: '90/91</u>	<u>Viti: '00/01</u>	<u>Viti: '90/91</u>	<u>Viti: '00/01</u>
Kopshte:	130.000	78690	5664	3547
Shk.8-vjeçare:	557000	528 733	28798	27672
Shk. të mesme:	206 000	117623	9708	5720



406. Bursa te dhena 10 vitet e fundit:

Institucionet:	Numri i bursave:	
	Viti '90/91	Viti '00-'01
Shkolla 8-vjeçare:	430	40
Shkolla të mesme:	450	2500

407. Ligji parashikon detyrimin e femijeve te moshes 6 vjeçare deri ne moshen 16 vjeçare per te ndjekur arsimin e detyruar, i cili zgjat jo me pak se 8 vjet. Prinderit jane te detyruar t'i dergojne femijet e tyre, te cilet i perfshin detyrimi shkollor, ne institucionet publike ose private te arsimit te detyruar.

408. Masat, për të realizuar pjesëmarrjen sa më të madhe të nxënësve në procesin mësimor, janë në tre drejtime:

1. për krijimin e kushteve të përshtatshme objektive,
2. për ndërgjegjësimin e fëmijëve dhe të prindërve për rëndësinë e mësimin dhe të shkollës, si dhe
3. masa detyruese e shtrënguese apo sanksione.

Së pari, krijimi i kushteve objektive të përshtatshme.

Ministria e Arsimit dhe Shkences, drejtoritë arsimore të qarqeve dhe rretheve, si organe të saj vartëse, në bashkëpunim me Organet e pushtetit vendor, kanë marrë një radhë masash të tilla, si:

- Vendosja e transportit publik të posaçëm dhe me tarifa të reduktuara për mësuesit dhe nxënësit e shkollave publike. Kjo aplikohet sidomos për at o zona, ku një pjesë e nxënësve e kanë larg shkollën.

- Grupimi i disa shkollave publike në bazë zone. Si pasojë e imigrimit të brëndshëm, e lëvizjes së një përqindjeje të konsiderueshme të popullsisë nga zonat

rurale, sidomos nga zonat malore e kodrinore, drejt qendrave urbane, sidomos pranë qyteteve bregdetarë, vihet re fenomeni se në fshatra e zona të caktuara, sidomos veri-lindore, por dhe në disa zona të tjera malore, kanë mbetur aq pak fëmijë (nxënës) saqë është e pamundur që të qendrojnë e funksionojnë shkolla të arsimit të detyrueshëm në cdo fshat, si disa kohë më parë.

Për këtë arsye, fëmijët (nxënësit) e mbetur të shkollave të disa fshatrave janë grumbulluar në një shkollë në bazë zone, duke iu krijuar atyre lehtësira për transport. Grupimi, në këtë mënyrë, i disa shkollave në bazë zone krijon mundësi edhe për zhvillimin në nivel cilësor të procesit mësimor, sepse klasat nuk janë kolektive (me nxënës të klasave të ndryshme), sigurohet më mirë baza materiale didaktike e nevojshme, etj.

- Akordimi nga shteti i një kuote bursash. Nëpërmjet tyre është bërë e mundur që të rritet pjesëmarrja e fëmijëve në procesin mësimor. Kjo sepse një kontigjent fëmijësh, nga familjet me gjendje ekonomike jo të mirë dhe që, për këtë arsye, do ta kishin të pamundur vazhdimin e shkollës, përkundrazi me bursat e akorduara arrijnë të ndjekin procesin mësimor.

- Mësues dhe programe të posaçme për fëmijë të ngujuar dhe me probleme shëndetësore. Këto masa përcaktohen në aktin e Ministrise se Arsimit dhe Shkences të datës 31 Korrik 1996 “Dispozita Normative për Shkollat Publike”, neni 11: Nxënësi, që përfshihet në detyrimin shkollor, në raste të veçanta, kur aksidentohet ose sëmuret rëndë, merr mësim në shtëpi, sipas një programi të posaçëm dhe me mësues të caktuar nga Drejtoria Arsimore. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe për fëmijët (nxënës) të ngujuar për shkak të gjakmarrjes, sidomos në Shqipërinë Veriore.

- Shtirja dhe përhapja e kopështëve dhe e shkollave private është një faktor tjetër që rrit pjesëmarrjen e nxënësve në procesin mësimor. Kjo është bërë e mundur në sajë të lëshimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkences të një numri në rritje të licensave përkatëse (sigurisht në bazë të përmbushjes së kushteve dhe standarteve përkatëse ligjore) subjekteve, që dëshirojnë të zhvillojnë arsimin privat.

Së dyti, masat për sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e fëmijëve (nxënësve) dhe të prindërve. Këto masa synojnë që fëmijët dhe prindërit e tyre të kuptojnë rolin dhe rëndësinë e shkollës dhe të arsimit në progresin e secilit dhe të shoqërtisë në tërësi, të bëhen të vetëdijshëm për domosdoshmërinë e pjesëmarrjes në procesin mësimor, e vazhdimin dhe e përfundimit të paktën të arsimit të detyruar. Këto synime realizohen përmes punës pedagogjike të mësuesëve me fëmijet dhe me komunitetin e prindërve, përmes forumit të zgjedhur të Këshillit të prindërve pranë shkollës, përmes bashkëpunimit të shkollës me komunitetin e shoqërisë civile, etj. Gjithë kjo punë është e fokusuar më shumë me fëmijët e larguar dhe me prindërit e tyre, me qëllim kthimin e fëmijëve të larguar në shkollë.

Së treti, aplikimi i sanksioneve ndaj prindërve, fëmijët e të cilëve braktisin shkollën. Këto masa aplikohen në bazë të ligjit nr. 7952, datë 21.06.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”. Neni 59 i këtij ligji parashikon dënime për kundërvajtje administrative me gjobë nga 5.000 lekë deri 50.000 lekë, për prindërit,

fëmijët e të cilëve mungojnë pa arsye në shkollë ose e braktisin atë. Ky ligj parashikon sanksione për punësimin e fëmijëve, që përfshihen në detyrimin shkollor, pasi ky punësim është një nga arsyet e mungesave dhe të largimit të fëmijëve nga shkolla. Konkretisht neni 60 i këtij Ligji sanksionon dënimin për kundërvajtje administrative nga inspektori i punës me gjobë nga 100.000 lekë deri 200.000 lekë, të punëdhënësve, shtetërorë ose privat, që punësojnë fëmijë të moshës së detyrimit shkollor. Masat e ndermarra në mënyrë që disiplina shkollore të zbatohet në mënyrë të pajtueshme me dinjitetin njerezor të fëmijes dhe në përputhje me këto konvente.

409. Masat për shkeljen e rregullores së procesit mësimor përcaktohen në “Dispozitat Normative për Shkollat Publike” të datës 31 Korrik 1996 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, të cilat përfaqësojnë një akt nënligjor shumë të rëndësishëm për procesin mësimor. Ato përcaktojnë normativat konkrete të procesit mësimor-edukativ, përfshirë të drejtat dhe detyrat e nxënësve dhe të mësuesëve, që përshkohen edhe nga fryma e dokumentave të tilla të rëndësishme, si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e OKB dhe Konventa e të Drejtave të Fëmijës e OKB. Për nxënësit dhe mësuesit, kur ata nuk realizojnë detyrat e tyre dhe shkelin rregulloren e procesit mësimor, atëherë merren masa disiplinore, krahas dhe pas një pune edukative të vazhdueshme.

410. Masat për nxënësit, që parashikohen në këto “Dispozita Normative për Shkollat Publike” dhe që aplikohen në shkolla, janë:

- a.- Këshillim,
- b.- Vërejtje - kompetencë e mësuesit kujdestar,
- c.- Paralajmërim për përjashtim nga shkolla,
- d.- Përjashtim nga shkolla - kompetencë e drejtorit të shkollës.

411. Masat për mësuesin, kur shkel rregulloren e procesit mësimor, janë që nga këshillimet e vërejtjet deri në pezullime e largim nga puna, por ato bazohen në Kodin e Punës (neni 37 dhe sipas nenit 13.2) dhe duhet parashikohen në Kontratën Kolektive.

412. Ligji nr. 8387, date 30.07.1998, i cili ndryshoi ligjin për sistemin arsimor parauniversitar në pjesën e sanksioneve, parashikon se prinderit që nuk dergojnë në shkollë fëmijët e moshës 6-16 vjeç, ose kur këta mungojnë pa arsye në shkollë, apo e braktisin atë denohen për kundërvajtje administrative me gjobe nga 1000 deri në 10 000 leke.

413. Kur nxënësi mungon në mesim pa arsye 30-50 % të kohës në dy muaj të njëpasnjeshëm, masa e gjobes është 1000 deri 3000 leke dhe në rast perseritje gjatë po atij viti gjoba bëhet 5000 leke. Kur nxënësi mungon pa arsye mbi 50% të kohës në dy muaj të njëpasnjeshëm masa e gjobes është 5000 deri 7000 leke dhe në rast perseritje, ose braktisje të shkolles, gjoba bëhet 10 000 leke.

414. Vendimi i gjobes jepet nga kryetari i bashkisë ose i komunes, sipas propozimit të drejtorit të shkolles. Kunder vendimit të gjobitjes mund të bëhet

ankim, brenda 10 diteve nga dita e shpalljes se njoftimit, ne gjykatën e rrethit ku është kryer kundervajtja. Perjashtohen nga gjoha ata prinder, femijet e te cileve jane regjistruar ne nje shkolle jashte vendit. Por, po ti referohemi realitetit, keto sanksione kane mbetur pothuajse te pazbatuara. Numri i femijeve qe nuk ndjekin arsimin e detyruar është rritur si per shkak te levizjes se familjeve nga zonat rurale ne zona ku nuk ka patur me pare banore dhe per pasoje as shkolle, edhe per shkak te futjes ne pune te femijeve, sidomos ne zonat rurale.

415. Shteti, ne institucionet arsimore publike u siguron falas nxenesve mjediset mesimore, bazen materiale dhe personelin mesimdhenes. Institucionet shkollore kane pesuar demtime te medha ne periudhen 1990-1992 dhe ne ngjarjet e vitit 1997 te cilat i shtuan keto demtime.


416. Për këtë qëllim janë realizuar investime të konsiderueshme gjatë vitit 2000: 1.5 miliard lekë nga buxheti i shtetit, 1 055,138 milion lekë në 12 prefekturat, me të cilat u plotësuan nevojat per rikonstruktimin dhe ndërtimin e objekteve shkollore.

417. Konkretisht është realizuar kjo rritje e investimeve:

<b>Vepimtaria</b>	<b>Viti 1999</b>	<b>Viti 2000</b>
Investimet ne 000/leke Ne fonde	3 753 939 (me shtesat per Kosoven)	1 520 000
Objekte	578	153
Klasa	2792	1595
Nxenes qe perfitojne	69 800	39 875
Kopshte te rikonstr. Me buxhetin e shtetit	23	14
Shkolla 8-vj te reja (me buxhetin e shtetit)	38	16
Shkolla 8-vj te rikon. (me buxhetin e shtetit)	111	61
Shkolla mesme te reja (me buxhetin e shtetit)	1	0
Shkolla meme te rikon. (me buxhetin e shtetit)	58	32
Objekte univ. reja (me	0	0

buxhetin e shtetit)		
Objekte univ. rikon (me buxhetin e shtetit)	30	10

418. Gjithashtu, ne perputhje dhe me nenin 28/3 te Konventes, ligji parashikon te drejten e Ministrise se Arsimit dhe Shkences per te eksperimentuar per permiresimin e cilesise ne arsim, ne perputhje me standartet nderkombetare ne bashkepunim me institucione te vendit dhe te huaja.



### B. Objektivat e arsimit (neni 29)

419. Kushtetuta e Shqiperise parashikon se shteti synon arsimimin dhe kualifikimin sipas aftesive te femijeve dhe te te rinjve (neni 59). Gjithashtu, ne ligjin per sistemin arsimor parauniversitar parashikohet se arsimi ka per mision emancipimin shpirtor, progresin material dhe zhvillimin social te individit si dhe

respekton te drejtat e femijeve te percaktuara ne ligj. Ngritja e nivelit mesimor-edukativ te nxenesve dhe integrimi optimal i tyre ne jeten, emancipimin dhe perparimin e vendit realizohet nga komuniteti i shkollave publike i perbere nga nxenesit, mesuesit, prinderit dhe partnere te tjere social.

420. Sipas ligjit, arsimi i detyruar publik synon te zhvilloje aftesite intelektuale, krijuese, praktike dhe fizike te nxenesve, te zhvilloje personalitetin e tyre dhe t'i pajise ata me elementet themelore te kultures se pergjithshme dhe edukaten qytetare (neni 21). Ndersa, arsimi i mesem publik synon te zhvilloje ne menyre sa me te plote e harmonike personalitetin dhe potencialin e nxenesve, per t'i aftesuar ata te kontribuojne ne menyre sa me aktive ne zhvillimet ekonomike, politike, sociale e kulturore te vendit.

421. Realizimi i të Drejtave të Njeriut në praktikën arsimore, përveç sa më sipër, ka dhe një anë tjetër, edukimin e fëmijëve në frymën e njohjes dhe të respektimit të të drejtave të njeriut. Ky edukim është synuar të realizohet nëpërmjet një bashkëpunimi të ngushtë, në bazë të një marrëveshjeje të përbashkët të Ministrise se Arsimit dhe Shkences me Qendrën Shqiptare për të Drejtat e Njeriut (QShDNj), dhe përfshin këto drejtime:

- Trajnime të mësuesve dhe të drejtuesve të shkollave, nëpërmjet seminareve përkatëse, për njohjen më mirë të kuadrit të të drejtave të njeriut dhe të realizimit të këtyre të drejtave në veprimtarinë shkollore ( rreth 5000 të tillë);

- Aftësimin, nëpërmjet kursesh të caktuara, i një grupi trainuesish për organizimin e veprimtarive cilësore për respektimin e të drejtave të njeriut (janë aftësuar 464 të tillë) ;

- Ngritja e një sistemi shkollash-pilot apo model në 24 rrethe të vendit për realizimin më efikas të edukimit në frymën e njohjes dhe të respektimit të të drejtave të njeriut; ato përfshijnë ndër të tjera, trajnimin më special të mësuesve, ngritjen e këndeve dhe të kabineteve per mesimin e të drejtave të njeriut, përgatitjen dhe veprimtarinë e mësuesve të posaçëm apo të formatorëve të të drejtave të njeriut, etj.;

- Veprimtari për integrimin e të mësuarit të drejtave të njeriut brenda procesit mesimor-edukativ në shkolla të mesme, me synim përfshirjen e aspekteve të të drejtave të njeriut në disa lëndë, hartimin e kurrikulave të caktuara, etj.

- Organizimi i shkollave verore të fëmijëve, për njohjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut, nëpërmjet veprimtarive argëtuese e çlodhëse (konkurse, koncerte, ekskursione, ekspozita me vizatime dhe punime dore, etj); në to janë përfshirë 17.189 fëmijë, rreth gjysma e të cilëve kanë qenë femijë nga Kosova;

- Veprimtari përgatitore për përfshirjen e kurseve të leksioneve e të seminareve për të drejtat e njeriut me studentët në degët universitare, që përgatisin mësues;

- Botime në ndihmë të mësuesve dhe të nxënësve për të gjitha ciklet e shkollimit: manuale, libri i nxënësit për klasat 1-8, broshura “Të drejtat e mia” për fëmijët dhe adoleshentët, module për studentët e degëve të mësuesisë, etj.

422. Ne te njejten kohe, shkolla ne pergjithesi ka një bashkëpunim të gjerë me komunitetin, veçanërisht me prindërit e femijëve. Prindërit marrin pjesë në borde të shkollës dhe aktivizohen për organizimin dhe mbarëvajtjen e saj. Prindërit e



fëmijëve të çdo shkolle informohen rregullisht nga mësuesit për ecurinë e fëmijëve në shkollë, për problemet që ata kanë dhe për mënyrat se si mund të rritin kujdesin dhe kontrollin ndaj fëmijëve.

423. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përcakton gjithashtu mundësinë, që kanë nxenesit, për të arsimuar edhe në shkollat jo-publike, kur ato janë krijuar dhe funksionojnë në bazë të ligjit. Në ligjin nr.7952, datë 21.06.1995 "Për arsimin parauniversitar", të ndryshuar me ligjin 8387, datë 30.07.1998, krijimi i institucioneve arsimore private lejohet në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Ndërsa, për institucionet arsimore publike parauniversitare lejohen të privatizohen vetëm institucionet e arsimit profesional. Për të siguruar një arsimim të plotë të fëmijëve, ligji parashikon edhe krijimin e strukturave të tjera që mbështesin dhe pasurojnë sistemin arsimor, si qendra kulturore, qendra të dokumentacionit shkollor, lektoriume, kurse speciale, qendra të formimit profesional etj.

### C. Koha e lirë, aktivitetet rekreative dhe kulturore (neni 31)

424. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në kreun për objektivat sociale, parashikon synimin e shtetit për zhvillimin e sportit dhe të veprimtarive ripërteritese (neni 59).

425. Një komponent i rëndësishëm i jetesës së fëmijëve është argëtimi i tyre. Sot, në Shqipëri, një pjesë e madhe e infrastrukurës kulturore e argëtuese për fëmijë nuk funksionon, ka ndërruar destinacion, apo është drejt degradimit të plotë. Si pasojë mjedise për argëtim a edukim të të rinjve dhe të fëmijëve ka shumë pak. Përsa i përket kendeve të lojrave, ku fëmijet mund të argetohen, ato pothuajse nuk ekzistojnë. Edhe ato që kanë funksionuar zhduken çdo ditë, duke ia lenë vendin ndertimeve të reja, që pa meshire zhdukin ato pak ambiente argëtimi për fëmijet, që janë të pafuqishëm t'i ndalojnë.

426. Të vetmet mjedise mbeten banesa ku mund të luajnë, të shohin televizorin dhe të përdorin lojrat elektronike. Në qytete ekziston vetëm nga një qendër kulturore e financuar nga shteti që merret me organizimin e festivalit të këngës së fëmijëve që organizohet për çdo 1 Qershor.

427. Të detyruar nga mungesa e mjediseve të hapura për ta, fëmijët kalojnë me orë të tëra përpara ekraneve të TV. Ndikimi i tij është aq i dukshëm, sa ka spostuar në nivelet më të ulta, interesat e tjera natyrore të moshës. Në perceptimin intensiv të realitetit televiziv, në ndikimin e fuqishëm të skenave të dhunës në rrafshin emotiv të fëmijëve dhe në tendencën për të imituar në jetë skenat që ata përjetojnë aq intensivisht në ekran, psikologët dhe sociologët e sotëm, gjejnë burimin kryesor të rritjes së kriminalitetit në moshën e fëmijërisë dhe atë të adoleshencës. Ndaj në këtë drejtim legjislacioni përkatës shërben për të parandaluar dhe minimizuar ndikimin negativ të medias elektronike në rritjen e dhunës në këto moshë. Niveli i ulët ekonomik i prindërve bën të pamundur plotësimin e shumë nevojave kulturore e argëtuese për fëmijët e tyre.

428. Në shkolla janë tepër të kufizuara mundësitë për kalimin e kohës së lirë dhe të argëtimit pas procesit mësimor megjithatë, veprimtaritë e ndryshme, qofshin ato kulturore ose sportive, në pjesën më të madhe të tyre zhvillohen nga shkollat, ndërsa në një pjesë janë prinderit vetë që kujdesen për arëtimin e fëmijëve të tyre.

429. Edhe kur familja mund t'i kushtojë fëmijëve të gjithë kohën e duhur shpesh prinderit nuk kanë përgatitjen e mjaftueshme për të rritur një fëmijë të lumtur. Gjendja sociale ekonomike e fëmijëve është e njëjtë me të gjithë popullit shqiptar, por veçoritë e lartpërmendura shtojnë nevojën e krijimit të mundësive për zbutjen shkallë shkallë të pasojave negative të tranzicionit të vështirë që kalon vendi ynë që fëmijët të jetojnë fëmijërinë e të marrin pjesë në shoqëri bazuar në të drejtat e tyre.

## **VIII. MASAT E VEÇANTA TË MBROJTJES (nenet 22, 38, 39, 40, 37 b, c, d, neni 37 a, 39, 32, 33, 34, 36, 35, 30)**

### A. Fëmijët me status refugjati (neni 22)

430. Në ligjin nr. 8432, datë 14.12.1998 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë” parashikohen kriteret për të përfituar statusin e refugjatit dhe ndihma që jep shteti në këto raste për refugjatet në përgjithësi dhe për fëmijët në veçanti. Në ligj parashikohen edhe rastet e personave që nuk përmbushin kriteret për të përfituar statusin e refugjatit. Në këtë rast personit i ofrohet mbrojtje e perkoheshme mbi baza humanitare, duke mos e larguar nga Shqipëria nisur nga arsyet perkatese të shprehura edhe në Konventën për të drejtat e fëmijës, krahas konventave të tjera, në të cilat Republika e Shqipërisë është pale. Pra, ligji në mënyrë të shprehur ofron mbrojtje për fëmijët që nuk fitojnë statusin e refugjatit (neni 5).

431. Gjithashtu, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin nr. 8492, datë 27.05.1999 “Për të Huajt”, i cili rregullon regjimin e hyrjes, të qëndrimit, qarkullimit, punësimit të të huajve në Republikën e Shqipërisë, si dhe të daljes së tyre prej territorit të saj. Për të miturit nën 16 vjeç, ligji parashikon të drejtën për të aplikuar për vize leje ose të drejtën të hyjnë në Republikën e Shqipërisë me lejen e kujdestarit ligjor dhe të shoqëruar nga persona madhore. Nga ky rregull bëjnë përjashtim të miturit që hyjnë si azilkerkues.

432. Në zbatim të ligjit për të huajt, Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr. 439, datë 04.08.2000 “Për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, i cili përcakton, në mënyrë të detajuar, kriteret e levizjes së shtetasve të huaj në Republikën e Shqipërisë, midis tyre edhe fëmijëve të mitur.

433. Konform neni 22/2 të Konventës, ligji nr. 8432 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë” ka përcaktuar dhenien e azilit mbi bazën e parimit të bashkimit familjar. Sipas ligjit, të drejtën e azilit me të njëjtin status e përfitojnë edhe bashkeshortit dhe fëmijët e moshës nën 18 vjeç të refugjatit, të cilit i është dhënë azil, me kusht që ata të jetojnë së bashku.

434. Femijet qe gezojne azil ne perputhje me parimin e bashkimit familjar vazhdojne ta gezojne ate kur mbushin moshen 18 vjeç edhe ne rastin e zgjidhjes se martesës, ndarjes apo vdekjes se refugjatit per shkak te te cilit femija fitoi te drejten e azilit ne Shqiperi (neni 6). Refugjati qe perfiton azil gezon te drejten e trajtimit social ne te njejten mase si dhe shtetasit shqiptar, si dhe perkrahje sociale, te cilat i merr nga zyra per refugjatet.

435. Ne qofte se azilkerkuesi qe hyn ilegalisht ne territorin e Republikës se Shqiperise eshte nje femije i pashoqeruar nen moshen 16 vjeç, veprohet ne perputhje me normat nderkombetare mbi te drejtat e femijeve te cilat Republika e Shqiperise i ka ratifikuar (neni 16).

436. Organi kompetent qe merret me aplikimet per azil eshte Zyra per Refugjatet. Kjo Zyrë drejtohet nga Komisioneri Kombetar per Refugjatet. Komisioneri Kombetar per Refugjatet siguron per çdo azilkerkues te pashoqeruar nen moshen 18 vjeç, apo me te meta mendore, nje kujdestar te caktuar ne perputhje me legjislacionin shqiptar. Kunder vendimeve te Zyres se Refugjateve mund te behet ankim ne Komisionin Kombetar per Refugjatet.

437. Ligji Nr 8492 “Per te Huajt” percakton rastet ne te cilat jepet leja e qendrimit si rezultat i bashkimit familjar. Sipas ligjit, nje i huaj lejohet te aplikojë per leje qendrimi per shkak te bashkimit familjar, nese nje nga pjestaret e familjes eshte shtetas shqiptar, refugjat ose i huaj rezident me leje qendrimi jo me pak se nje vit. Me Dekretin e Presidentit te Republikës Nr. 200, date 03.06.1992, Republika e Shqiperise aderoi ne Konventen per statusin e refugjateve, nenshkruar ne Gjeneve 28.07.1951 dhe ne Protokollin per statusin e refugjateve nenshkruar ne New York me 31.01.1967. Gjithashtu, me ligjin nr.7833, date 22.06.1994 Kuvendi Popullor ratifikoi “Marreveshjen ndermjet Qeverise se Republikës se Shqiperise dhe Komisarariatit te Larte te Kombeve te Bashkuara per Refugjatet”.

438. Me 28.01.1999, Kuvendi miratoi ligjin nr. 8451 “Per denoncimin e Konventes nr. 21 te Organizates Nderkombetare te Punes (ILO), Inspektimi i Emigranteve”.

439. Problemi kryesor ne Shqiperi eshte largimi i femijeve nga Shqiperia me, ose pa familje dhe qe shpesh here nuk e gjejne ne vende te tjera, trajtimin qe kerkon Konventa e OKB-se per te drejtat e femijes, megjithese keto shtete jane pale ne kete Konvente. Largimi i femijeve nga Shqiperia ka filluar qe ne vitet 1990-1991 dhe vazhdon ende, sidomos ne shtetet fqinje.

440. Ne zbatim te nenit 22/2 te Konventes (CRC), Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 8456, date 11.02.1999 “Per funksionin e perfaqesuesit ligjor prane organizmave nderkombetare per te drejtat e njeriut”. Sipas ketij ligji, perfaqesuesi ligjor perfaqeson zyrtarisht shtetin shqiptar, ne te gjitha rastet e shtruara per shqyrtim, para organizatave nderkombetare per gjendjen e te drejtave te njeriut ne Shqiperi. Gjithashtu, perfaqesuesi ligjor, udhezoi dhe u kerkon shpjegime organeve

perkatese, per ndjekjen e ceshtjeve dhe per zbatimin e traktateve nderkombetare te drejtave te njeriut ku Shqiperia eshte pale. Pra, nuk mungojne mekanizmat per te siguruar realizimin ne praktike edhe te drejtave te femijeve shqiptare ne vendet ku ata emigrojne.

#### B. Fëmijët në konflikte të armatosura (neni 38), duke përfshirë rikuperimin fizik dhe psikologjik, si dhe riintegrimin shoqëror (neni 39)

441. Me ligjin nr.7527, date 11.12.1991 “Per sherbimin ushtarak ne Forcat e Armatosura te Republikes se Shqiperise” me ndryshimet perkatese, moshja e rekrutimit ne Forcat e Armatosura per kryerjen e sherbimit ushtarak eshte 19 vjec.

442. Praktikisht, Shqiperia nuk ka patur probleme as me mbrojtjen dhe kujdesin per femijet e prekur nga konflikti i armatosur, meqenese ne Shqiperi nuk ka patur nje konflikt te tille deri tani. Legjislacioni shqiptar permban rregulla te caktuara per strehimin e popullsisë dhe trajtimin e saj ne rast konflikti.

443. Legjislacioni shqiptar nuk ka parashikuar dispozita te veçanta te permbledhura ne nje akt ligjor per trajtimin e femijeve qe jane viktime te shfrytezimit, keqtrajtimit, tortures, etj, por keto masa i gjejme te shperndara ne ligje te veçanta, sipas rastit konkret. Trajtimi i refugjateve qe vijne ne Shqiperi dhe masat qe merren per integrimin e tyre jane parashikuar ne ligjin qe ben fjale per refugjatet.

444. Ndersa, ne Kodin e Procedures Penale parashikohet menyra e riparimit te demit jopasuror te rrjedhur nga vepra penale. Kohet e fundit u ndeshem me trajtimin ç’njerezor qe iu be femijeve kosovare ne Kosove, nje pjese e te cileve qendruan per disa kohe ne Shqiperi. Pikerisht, per te realizuar jo vetem trajtimin ushqimor, por dhe riaftesimin fizik dhe psikologjik te ketyre femijeve te tmerruar u be nje pune e madhe dhe graduale nga struktura shteterore dhe jo-shteterore, si dhe persona te specializuar.

#### C. Administrimi i drejtësisë për fëmijët (neni 40)

445. Ne Kushtetuten shqiptare parashikohet se cdo person, te cilit i eshte hequr liria ka te drejten e trajtimit njerezor dhe te respektimit te dinjitetit te tij. Ne baze te legjislacionit shqiptar, te pandehurit te mitur i sigurohet ndihme juridike dhe psikologjike, ne cdo gjendje dhe shkalle te procedimit, me pranine e prindit ose te personave te tjere te kerkuar nga i mituri dhe te pranuar nga autoriteti qe procedon.

446. Gjate fazes se gjykimit, sipas moshes te te miturit, gjykata mban parasysh kerkesen per te mos nderprere proceset edukative konkrete. Statusi i posacem i te miturve sipas Kodit Penal nuk percaktohet thjesht nga kufizimi ne moshen e pergjegjesise penale, duke percaktuar moshen 14 vjec kur kemi te bejme me nje veper penale te rende (kryerje krimi) dhe moshen 16 vjec per nje kundravajtje.

447. Kodi i Procedures Penale, percakton nje sere garancish per mbrojtjen e te miturve dhe personalitetit te tyre dhe konkretisht;

- ≈ Pyetja e te miturve ne seance me dyer te mbyllura.
- ≈ E drejta e perfaqesuesit ligjor te te miturit per te mbrojtur interesat e tij me cilesine e te demtuarit akuzues.
- ≈ Mbrojtja e detyrueshme profesionale per te miturin nen 18 vjec.
- ≈ Ndalimi i publikimit te gjeneraliteteve dhe te fotografive te te pandehurve dhe te deshmitareve te mitur te akuzuar ose te demtuar nga vepra penale.
- ≈ Mos arrestimi per nje veper penale e cila parashikohet si kundravajtje penale.

Keto garanci plotesojne kuadrin ligjor procedural ne procesin penal, dhe u japin te miturve mjete te nevojshme mbrojtese qe u takojne per shkak te moshes.

448. Kushtetuta e Republikes se Shqiperise parashikon se askush nuk mund te akuzohet ose te deklarohet fajtor per nje veper penale, e cila nuk konsiderohet e tille me ligj ne kohen e kryerjes se saj, me perjashtim te veprave, te cilat ne kohen e kryerjes se tyre perbenin krime lufte ose krime kunder njerezimit sipas te drejtes nderkombetare (neni 29). Gjithashtu, ne Kodin Penal parashikohet se askush nuk mund te denohet per nje veper, qe sipas ligjit te kohes kur eshte kryer nuk perbente veper penale. Kushtetuta parashikon te drejten e kujtudo qe gjate procesit penal t'u beje pyetje deshmitareve te pranishem dhe te kerkoje paraqitjen e deshmitareve, eksperteve, dhe personave te tjere, te cilet mund te sqarojne faktet. Kushtetuta shqiptare parashikon se cilido ka te drejte te vihet ne dijeni menjehere dhe hollesisht per akuzen qe i behet, per te drejtat e tij si dhe t'i krijohet mundesia per te njoftuar familjen ose te afermit e tij. Cilido ka te drejte te kete kohen dhe lehtesite e mjaftueshme per te pergatitur mbrojtjen e vet (neni 31).

449. Persa i perket ndihmes juridike qe duhet t'i sigurohet te miturit, ne Kodin e Procedures Penale eshte parashikuar se te pandehurit te mitur i sigurohet ndihme juridike dhe psikologjike, ne çdo gjendje dhe shkalle te procedimit, me pranine e prindit ose personave te tjere te kerkuar nga i mituri dhe te pranuar nga autoriteti qe procedon.

450. Ndersa, ne Kodin e Procedures Penale percaktohet, se kur i pandehuri eshte nen moshen 18 vjec, ndihma nga nje mbrojttes eshte e detyrueshme. Kodi i Procedures Penale i miratuar ne vitin 1995 parashikon nje sere rregullash qe i referohen ne radhe te pare aktoreve te procesit dhe rregullave qe percaktojne marredheniet midis tyre dhe ne cdo rast ne dispozita te ndryshme Kodi ndalet posacerisht per te miturit. Keshtu ne nenin 35 te tij te miturit gezojne ndihme te posacme juridike dhe psikologjike ne cdo shkalle te procedimit, ne prani te prindit apo personave te kerkuar nga vete i mituri. Kodi parashikon dispozita persa i perket kujdesit qe duhet bere nga organi procedues ne lidhje me percaktimin e sakte te moshes dhe personalitetit te te miturit. Kete e parashikon neni 41 i Kodit te Procedures Penale.

451. Gjithashtu neni 42 i tij shpreh qarte se organi procedues duhet te marre te dhena per kushtet e jetes personale, familjare dhe shoqerore te te pandehurit te mitur me qellim sqarimin e pergjegjshmerise dhe shkallen e pergjegjesise, vleresimin e rendesise shoqerore te faktit per te caktuar masen e pershtatshme te denimit penal.

452. Vendimi nr 30, date 28.01.1999 i Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte, duke i'u referuar nenit 40/b(iii) te Konventes, pranoi mbrojtjen e vendosur per te miturit ne te gjitha fazat e gjykimit pavaresisht ne se eshte ne mungese, ose jo. Po kete qendrim ka mbajtur edhe Gjykata Kushtetuese Referimi ne Konvente u be duke u mbeshtetur ne nenin 122 te Kushtetutes shqiptare, sipas te ciles, çdo marreveshje nderkombetare e ratifikuar perben pjese te sistemit te brendeshem juridik pasi botohet ne Fletoren Zyrtare. Nje marreveshje nderkombetare e ratifikuar me ligj ka epersi mbi ligjet e vendit qe nuk pajtohen me te.

453. Kushtetuta shqiptare parashikon se askush nuk mund te detyrohet te deshmoje kunder vetvetes ose familjes se tij dhe as te pohoje fajesine e tij (neni 32), kushdo ka te drejte te ankohej kunder nje vendimi gjyqesor ne nje gjykate me te larte (neni 43). Edhe Kodi i Procedures Penale parashikon ankimin dhe rekursin ne instancat me te larta gjyqesore, sipas çeshtjes konkrete (neni 249,407).

454. Konform nenit 40/2(b) te Konventes, Kushtetuta e Shqiperise parashikon ndihmen pa pagese te nje perkthyesi, kur femija nuk flet ose nuk kupton gjuhen shqipe (neni 31). Kodi i Procedures Penale e sakteson me teper ndihmen qe duhet te jape nje perkthyes, duke ndihmuar te pandehurin e mitur te kuptoje akuzen dhe te ndjeke veprimet qe kryhen gjate procesit penal.

455. Per te respektuar jeten private te femijes, ne te gjitha fazat e procedures, perveç sa parashikohet ne Kushtetute, Kodi i Procedures Penale ndalon publikimin e gjeneraliteteve dhe fotografive te te pandehurit te mitur, te akuzuar per vepren penale per te cilen dyshohet.

456. Gjithashtu, Kodi i Procedures Penale percakton dhe rregullat se ne ç'raste mund te behet kontrolli i baneses dhe pergjimi i bisedimeve ose komunikimeve (neni 202,221,222).

457. Kodi i Procedures Civile i miratuar me ligjin nr. 8116, date 29.3.1996, ka parashikuar krijimin prane Gjykatave te Shkalles se Pare te seksioneve te vecanta per gjykimin e mosmarreveshjeve qe lidhen me te miturit dhe familjen (nenet 320, 349, 368). Kjo ka bere te mundur qe problemet me te miturit te trajtohen ne menyre me te specializuar. Kjo dispozite parashikon se kur disa nga procedimet e lidhura ndermjet tyre i perkasin kompetences se gjykates se zakonshme dhe te tjerat gjykates qe shqyrton çeshtjen me te mitur, kompetente per te gjitha procedimet eshte kjo e fundit.

458. Rregullimi i herepashershem i legjislacionit do te beje te mundur trajtimin e femijeve, me qellim parandalimin e veprave penale. Gjithashtu duke pare

momentalisht numrin e te miturve te gjykuar i cili arrin ato permasa te medha, ne zbatim te nenit 13 te Kodit te Procedures Penale gjykimi i ketyre te miturve mund te behet nga gjyqtare te kualifikuar dhe ngarkuar posacerisht me kete detyre. Ne gjykatat e shkalles se pare funksionojne seksione te posacme per gjykimin e te miturve, si ne fushen civile ashtu edhe penale. Trajnimi i ketyre gjyqtareve eshte mundesuar nga projekte te Ministrise se Drejtesise Shqiptare ne bashkepunim me shkollen e Magjistratures Shqiptare dhe me specialiste te Ministrise se Drejtesise Franceze e gjyqtare qe gjykojne ceshtje te te miturve Francë.

459. Sipas nenit 25 te ligjit mbi “Organizimin e pushtetit Gjyqesor”, eshte parashikuar perberja ne trupin gjykues ne ceshtjet e te miturve edhe te nje psikologu. Pavaresisht nga keto ngritja e Gjykates se te Miturve mbetet prioritet per Ministrine e Drejtesise. Aktualisht ky prioritet eshte ne fazen e studimit.

460. Konform nenit 40/3(a) per percaktimin e moshes minimale per pergjegjesi penale te femijes, Kodi Penal parashikon se pergjegjesi penale ka personi qe ne kohen e kryerje se nje krimi ka mbushur moshen 14 vjeç, ndersa kur kryen nje kundervajtje penale ka pergjegjesi kur ka mbushur moshen 16 vjeç (neni 12).

461. Persa i perket paragrafit te trete, germa “b” e nenit 40 te Konventes, ne ligjin nr. 8465, date 11.03.1999 “Per ndermjetesimin ne zgjidhjen e konflikteve” eshte parashikuar zgjidhja e kundervajtjeve penale pa iu drejtuar procedures gjyqesore. Ligji nuk shprehet ne menyre te veçante per te miturit, por i perfshin ata ne kategorine e personave qe kane kryer nje kundervajtje penale pavaresisht nga mosha. Nje nga masat e parashikuara ne kete paragraf eshte edhe zgjidhja e konfliktit te krijuar per shkak te kundervajtjes penale te kryer nga i mituri pa iu drejtuar procedures gjyqesore.

462. Nje rendesi te madhe ka dhe njohja e te drejtave te parashikuara ne kete Konvente nga femijet dhe te rriturit, ku te paret duhet te njohin per t’i kerkuar ato dhe te dytet duhet t’i njohin per t’u krijuar kushte femijeve t’i bejne ato realitet. Edukimi i femijeve me te drejtat e tyre aktualisht ka hyre ne programet mesimore ne shkolle, por nje rol te rendesishem ne kete drejtim luajne dhe OJQ-te qe merren me te drejtat e njeriut perfshi dhe te drejtat e femijeve.

463. Ne Projektin e Kodit te Procedures Penale, qe eshte ne fazen e diskutimit, eshte parashikuar gjykimi i te miturve per te gjitha veprat penale, perfshire dhe krimet e renda, nga seksione perkatese te krijuara ne gjykatat e rretheve gjyqesore. Projekti parashikon se gjykimi i te miturve do te behet nga nje trup gjykues i perbere nga dy gjyqtare dhe nje specialist psikolog, me status gjyqtari.

D. Fëmijët e privuar nga liria, duke përfshirë çdo formë ndalimi, burgosjeje, apo vendosje në ambiente të mbikqyrura (neni 37 (b), (c))

464. Ne legjislacionin shqiptar nuk jane parashikuar dispozita ne lidhje me mbajtjen e femijeve ne roberi dhe aktualisht nuk konfirmohen situata te tilla, per te thene ndryshe se realiteti shqiptar nuk eshte ndeshur me fenomene te kesaj

natyre. I mituri nën 18 vjec gëzon mbrojtje të detyrueshme në procesin e pyetjeve dhe atë gjyqësor.

465. Sipas ligjit nr. 8331 datë 21.04.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale" dhe ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burg", ekzekutimi i vendimeve penale bëhet në vende dhe mënyra favorizuese sipas përcaktimeve ligjore. Gjithashtu ligji "Per te drejtat dhe trajtimin e te denuarve" i njeh atyre te drejtat themelore te meposhtme:

- ☞ Respektimin e dinjitetit
- ☞ Mosdiskriminimin
- ☞ Te drejten e kerkeses dhe te ankimit, etj.

466. Masa e denimit ekzekutohet në institucionet e posacme të edukimit të të miturit. Aktualisht në Krujë është ngritur një godinë ku do të vuajnë dënimin të miturit, moderne dhe e planifikuar për ti shërbyer sa më mirë edukimit të kësaj kategorie fëmijësh të cilët kanë nevojë të rihyjnë në jetën shoqërore. Sipas statistikave ne Institucionin e vuajtjes se denimit Vaqarr, numri i te miturve qe vuajne denimin eshte 8.

467. Neni 17 i ligjit "Per te drejtat dhe trajtimin e te denuarve", parashikon se grate dhe te miturit vuajne denimin ne institucione te posacme per ta, ose ne seksione te vecanta te institucioneve te tjera. Aktualisht keta te mitur vuajne denimin ne seksione te vecante nga te rriturit. Ata trajtohen nga punonjes civile edukues e sociologe krahas punonjesve te policise qe merren me ruajtjen e institucioneve, te rregullit e disipline ne to.

468. Nje forme tjetere denimi e te miturit eshte edhe copezimi i denimit me burgim. Kjo dipozite parashikohet vetem per denimet deri ne nje vit burgim, ose kur ekzistojne rrethana te renda familjare, mjekesore, profesionale, apo shoqerore. Copezimi nenkupton ekzekutimin e denimit jo me pak se dy dite ne jave per nje periudhe jo me te gjate se tre vjet.

469. Gjithashtu ne nenin 59 te Kodit Penal eshte parashikuar edhe pezullimi i ekzekutimit te vendimit me burgim i cili gjen zbatim ne rastet ku ekziston rrezikshmeria e paket e personit, dhe kjo nenkupton venien ne prove te personit per nje afat nga 18 muaj deri ne 5 vjet. Gjate kesaj periudhe personit mund ti kerkohen nje sere detyrimesh kryesisht te karakterit social. Ky lloj denimi sherben si mase edukuese, apo riintegruese. Po ashtu sipas nenit 63 te Kodit Penal eshte parashikuar edhe ekzekutimi i vendimit duke kryer nje pune ne interes publik. Kjo lloj pune sjell automatikisht rehabilitimin e personit.

470. Rregullorja e Pergjithshme e Burgjeve sanksionon kushte humane, sic jane hapesirat per strehim, sherbimet higjenike, ushqimi, sherbimet shendetesore etj



471. Institucioni i vuajtjes se denimit ne Vaqarr eshte i pajisur me nje biblioteke qe eshte e frekuentueshme. Te miturit aktivizohen ne kurse kompjuteri dhe ne mesimin e gjuheve te huaja, si dhe kurse per studimin e fese. Eshte ndertuar nje fushe sportive qe i lejon ata te merren me aktivitete sportive. Ne ndihme te te miturve te denuar eshte edukatori ligjor, qe i njih ata me te drejtat qe kane per t'u ankuar e per te patur ndihme juridike. Gjithashtu funksionon punonjesi social, i cili me bashkebisedimet e vazhdueshme qe zhvillon, ndikon ne integrimin e tyre ne shoqeri dhe ne parandalimin e kthimit te tyre ne recidiviste.

472. Te miturit ndjekin rregullisht arsimin shkollor brenda institucionit, realizuar kjo nepermjet nje marreveshje dypaleshe ndermjet Ministrise se Drejtesise dhe Ministrise se Arsimit dhe Shkences.

473. Te miturit brenda institucionit zhvillojne aktivitete te ndryshme, si lojra sportive, ndjekin kurse te ndryshme te gjuheve te huaja ne kuader projektesh, marrin pjese ne sherbesa fetare etj.

474. Keta te mitur jane te denuar per vepra te ndryshme penale, kryesisht per vjedhje me arme ose vrasje. Moshja minimale e tyre eshte 15 vjec dhe maksimale 17 vjec. Masa me e larte e denimit te dhene eshte deri ne 10 vjet. Sipas statistikave te miturit e denuar vijne kryesisht nga familje me prejardhje punetore ose bujqesore.

475. Aktualisht ne vendin tone nuk funksionojne qendra riedukimi (riintegrimi), por Ministria e Drejtesise ka dhene rekomandimet e saj persa i perket ngritjes dhe funksionimit te ketyre qendrave ne nje raport te perbashket me UNICEF, dhe ka nje nder prioritetet kryesore realizimin e tyre duke percaktuar edhe qellimet ne kete drejtim.

476. Keto qendra do te sherbejne si faze per gatitore per te miturin perpara se ai te lirohet, pra ai do te kaloje ne keto qendra kohen e fundit te denimit dhe do te per gatitet per te qene i lire dhe per te perballur realitetin jashte. Ne kete aspekt eshte mbajtur parasysh se nje njeri te cilit i eshte kufizuar liria ne momentin e pare qe ajo i kthehet ai peson "dehjen me lirin" dhe menaxhimi i saj eshte shume i veshtire. Kjo faze e ndermjetme ndihmon ne perballimin e ketij fenomeni.

477. Qendrat e riintegrimit mund dhe duhet te sherbejne edhe per te miturit te cilet:

1. nuk kane familje;
2. nuk jane te mirepritur nga familja e tyre;
3. ekziston rreziku i konflikti me palen e demtuar;

478. Kjo zgjidhje mendohet se do te ndihmoje:

1. ne kapercimin e veshtiresive te para ekonomike qe hasen pas periudhes se burgut duke bashkepunuar ne kete kohe me zyrat e punes, me organet lokale per sistemimin e tyre ne pune;

2. do të ndihmonte në zgjidhjen e konflikteve dhe për këtë në rradhë të parë duhet të punojnë vet punonjësit e Qendres në bashkëpunim me struktura të tjera shtetërore dhe jo shtetërore.

E. Dënimi i fëmijëve, në veçanti ndalimi i dënimit kapital dhe burgimit të përjetshëm (neni 37 (a))

479. Të drejtat e parashikuara në Konvente, gjejnë pasqyrim në legjislacionin shqiptar në kuadrin e përgjithshëm të të drejtave të njeriut, duke mos e konsideruar të nevojshme pasqyrimin në mënyrë të veçantë të të drejtave të fëmijëve në disa prej tyre.

480. Kushtetuta Shqiptare parashikon se askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, ç'njerezor ose poshterues (neni 25). Në Kodin e Procedurave Penale, në pjesën e dispozitave të përgjithshme është parashikuar se askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit poshterues.

481. Me ligjin nr. 7727, datë 30.06.1993, Republika e Shqipërisë ka aderuar në "Konventën kundër torturës dhe vuajtjeve të tjera ose trajtimit mizor, ç'njerezor e degradues". Dënimi me vdekje nuk parashikohet nga legjislacioni shqiptar. Përsa i përket dënimit me burgim të përjetshëm, legjislacioni penal shqiptar e ndalon dënimin e kësaj mase dënimi për personat nën moshën 18 vjeç. Për më tepër, në Kodin Penal parashikohet që edhe dënimi me burgim për të miturit, që nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç nuk mund të jete me shumë se gjysma e dënimit që parashikon ligji për veprën penale të kryer (neni 51). Në rastet kur vepra penale është e një rëndësie të paket dhe sjellja e mëparshme e të miturit është e mirë, gjykata mund ta përjashtojë atë nga dënimi dhe mund të vendosë dërgimin e tij në një institucion edukimi.

482. Në Kodin e Procedurave Penale është parashikuar sigurimi i trajtimit njerezor dhe rehabilitimi moral i të denuarve me burgim (neni 5/3). Në pjesën e legjislacionit shqiptar që parashikon trajtimin e personave të denuar me heqje lirie, një vëmendje e veçantë i është kushtuar ruajtjes, përmirësimit, ose rivendosjes të lidhjeve të të miturit me familjen, duke përgatitur një program favorizues. Si subjekt i veprave penale Kodi Penal përcakton si moshë minimale për përgjegjësi penale moshën 14 vjeç kur kryen një veprë penale dhe 16 vjeç kur kryen një kundërvajtje penale.

483. Përsa i përket marrjes së masës së sigurimit, Kodi i Procedurave Penale parashikon kriteret dhe rrethanat që duhet të ketë parasysh gjykata, sidomos kur bëhet fjalë për vepra penale të kryera nga të miturit. Kur i pandehuri është i mitur gjykata mban parasysh dhe kërkesën për të mos nderprerë proceset edukative konkrete. Në qoftë se i mituri ka kryer kundërvajtje penale nuk zbatohet masa e arrestit për të.

## F. Shfrytëzimi ekonomik, duke përfshirë punën e fëmijëve (neni 32)

484. Puna e femijeve perben nje problem teper urgjent edhe ne plan nderkombetar dhe eshte ngushtesisht e lidhur me veshtiresite ekonomike te vendeve ne zhvillim (ne te cilat ben pjese dhe Shqiperia), qe kerkojne nje bashkepunim ne rang nderkombetar. Kushtetuta e Republikes se Shqiperise parashikon se çdo femije ka te drejte te jete i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytezimi dhe perdorimi per pune, e veçanerisht nen moshen minimale per pune te femijeve, qe mund te demtoje shendetin, moralin, ose te rrezikojte jeten a zhvillimin e tij normal.

485. Ndryshimet ekonomike, sociale dhe politike, mbyllja e shume industrive dhe ndermarrjeve shteterore, zhvillimi i sektorit privat, levizja e popullise nga zonat rurale ne ato urbane si dhe emigrimi gjate 10-vjecarit te fundit, e futen familjen shqiptare nen presion. Keto reforma politike, ose jo-politike ndikuan ne papunesine, sidomos te femrave dhe meshkujve nga mosha 40-50 vjec.

486. Shumica e tyre kishin familje dhe femije per te mbajtur numri i te cileve ne zonat rurale eshte me i madh ne krahasim me ato urbane. Duke patur parasysh keto fakte, shkaqet kryesore te punes se femijeve jane varferia, tradita familjare dhe pamundesia per arsimim ne zonat e veshtira te vendit.

487. Nga vezhgimet e bera deri tani, femijet e angazhuar ne pune, ne Shqiperi punojne si:

- ✍ Shites ne rruge te cigareve, cakmakeve dhe sendeve te tjera;
- ✍ Shites neper dyqane te ndryshme perimesh apo sendesh;
- ✍ Lypesa brenda, apo jashte Shqiperise;
- ✍ Fermere, apo shites te produkteve blegtorale dhe bujqesore;
- ✍ Bari me dhen;
- ✍ Llustrues kepucesh;
- ✍ Fatorino ne mjete motorrike private per transport personash;
- ✍ Peshkatore me mjete te ndryshme;
- ✍ Lares makinash, shites lulesh dhe shites gazetash etj.

488. Kodi i Punes parashikon nje mbrojtje te veçante per te miturit. Moshja minimale e pranimit ne pune eshte 16 vjeç. Kodi i Punes parashikon edhe mosha te tjera te pranimit ne pune (mosha 14 vjeç), por punesimi ne ke to raste duhet te behet ne pune te lehta qe nuk demtojne shendetin e tyre, te cilat percaktohen me vendim te Keshillit te Ministrave dhe vetem gjate pushimeve shkollore (neni 99). Per punemarresit nen moshen 18 vjeç ndalohet puna e nates dhe pranimi ne pun e behet vetem pas nje kontrolli mjekesor te plote, i cili i njeh si te afte per pune, shpenzimet e te cilit perballohen nga punemarresi (neni 103). Kohezgjatja ditore e punes, per punemarresin nen moshen 18 vjeç, eshte jo me shume se 6 ore ne dite, nga 8 ore qe eshte koha normale e punes (neni 78). Ne rast se punedhenesi pranon ne pune nje punemarres qe nuk ka mbushur moshen minimale per pune, Kodi i Punes parashikon sanksione dhe konkretisht shkelja e kesaj dispozite denohet me

gjobe deri ne pesedhjetefishin e pages minimale mujore (qe percaktohet me vendim te Keshillit te Ministrave).

489. Ne zbatim te Kodit te Punes eshte miratuar Vendimi i Keshillit te Ministrave nr. 384, date 20.05.1996, "Per mbrojtjen e te miturve ne pune", i cili percakton kushtet e punes, punet e lehta dhe te veshtira, pushimet, etj. Sipas ketij Vendimi, kushtet e punes te punemarresve nen moshen 18 vjec duhet te jene te tilla qe te mos demtojne shendetin, zhvillimin fizik, psikologjik, moral dhe social ose t'u kompromentoje edukimin. Te miturit nga mosha 14 deri 16 vjec mund te punojne vetem gjate pushimeve shkollore, me kusht qe te punesohen ne pune te lehta dhe inspektoriat i punes te kete leshuar nje autorizim per punedhenesin. Te pakten nje here ne vit te miturit nga 14-16 vjec duhet te kryejne nje periudhe pushimi prej 4 javesh te lire nga cdo veprimtari shkollore dhe nga cdo lloj pune. Per femijet nga mosha 16-18 vjec, te cilet punesohen ne pune te veshtira ose te rrezikshme, njoftohet inspektoriat i punes, i cili kontrollon kriteret e punesimit te tyre dhe nese demtojne shendetin e femijes ose jo. Kohezgjatja e punes per keta femije, nuk mund te jete me shume se 8 ore ne dite dhe 40 ore ne jave. Kohezgjatja e pushimeve vjetore eshte te pakten 4 jave. Ne rastin e marrjes ne pune te te miturve deri ne moshen 18 vjec, me qellim pjesemarrje ne veprimtari te natyres kulturore, artistike, sportive, apo publicistike i nenshtrohet nje autorizimi paraprak te leshuar nga Inspektoriat i Punes. Per me teper ne baze te ligjit "Per Inspektoriatin Shteteror te Punes", Inspektoriat ka te drejte te inspektojne regullisht punesimin e grave dhe femijeve. Keto te drejta zbatohen kundrejt te gjithë punedhenesve, punemarresve, personave te vetepunesuar dhe anetareve te familjeve te tyre, qe zhvillojne aktivitet ne Republiken e Shqiperise, pavaresisht nga shtetesia e tyre.

490. Persa i perket pushimit javor, per cdo periudhe prej 7 ditesh, te miturit nen moshen 18 vjec perfitojne nje periudhe minimale prej dy ditesh pa nderprerje, ku perfshihet dhe e diela. Te miturit nen 18 vjec perfitojne, ne rastin kur kohezgjatja e punes se dites kalon 4 ore e gjysem, nje pushim prej te pakten 30 minutash te panderprere.

491. Inspektoriat Shteteror i Punës (IShP) përcakton grupet e synuara, rajonet specifike, sektorët dhe format e punësimit që janë me përparësi në fushën e punës, bashkëpunon me të gjithë institucionet relevante për zbutjen dhe zbatimin e ligjeve në këtë fushë. Inspektorët e Punës veprojnë në përputhje me politikat strategjike shtetërore dhe vlerësimin e zgjidhjen e situatave për marrëdhëniet e punës së fëmijëve në vendet e punës që operojnë. Prej tyre punohet gjithashtu në përcaktimin e target grupeve prioritare, fëmijët e punësuar që duhet të mbështeten të parët dhe fëmijët që kanë punuar në punët e vështira me më pak mbrojtje.

492. Ne kete kuader, Shqiperia ka nenshkruar Konventen nr.182 e ILO-s per "Punën e rëndë të fëmijëve". Rëndësi te veçantë ka trajnimi i kombinuar me fëmijët e punësuar, punëdhënësit e tyre dhe familjet, pra bashkëpunimi i të gjithë sektorëve: punëdhënës, departamente të qeverisjes lokale, OJQ që veprojnë në

fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, grupe profesionistësh, sindikata, institucione shëndetësore dhe universitete etj.

493. Qeveria shqiptare është e angazhuar për anetaresimin e Shqipërisë në Konventën nr.182, "Format më të këqija të Punës së Fëmijëve, 1999" dhe Rekomandimin nr.190 "Për Eliminimin e Formave më të këqija të Punës së Fëmijëve" të Organizatës Botërore të Punës. Për ratifikimit të kësaj Konvente duhet të parashikohen amendamente në Kodin e Punës (për arsye se Kodi i Punës është miratuar me përpara se Konventa), për sa i takon kritereve të punës, specifikimin e të drejtave dhe detyrimeve të punëmarrësit lidhur me të miturit si dhe përgjegjësia e personit juridik për shkeljet eventuale.

494. Gjithashtu do duhet të rishikohet ligji për Inspektoriatin Shtetëror të Punës, si në aspektin administrativ, duke krijuar hallka të posaçme lidhur me të miturit, ashtu edhe në aspektin juridik, duke i dhënë prioritet kontrollit lidhur me punën e të miturve. Me përparësi është ndërtimi i kapaciteteve nëpërmjet trajnimit të inspektorëve të punës për pajisjen e tyre me njohuri dhe aftësi të tilla teknike e profesionale që ka puna e fëmijëve si kategori tepër specifike në tërë punëmarrësit në përgjithësi.

495. Republika e Shqipërisë, me ligjin nr. 8086, date 13.03.1996 ka aderuar në Konventat e Organizatës Nderkombetare të Punës, nr. 105 "Për zhdukjen e punës së detyruar", dhe nr.111 "Për diskriminimin në punë dhe profesion", nr.138 "Për moshën minimale për tu pranuar në punë", dispozitat e të cilave automatikisht janë bërë pjesë e sistemit të brendshëm juridik.

#### G. Abuzimi me drogat (neni 33)

496. Në Shqipëri përdorimi i drogës nuk ka qenë fenomen shqetësues për shkak të izolimit të plotë të Shqipërisë. Pas viteve 1992-1993 përdorimi i drogës si dhe trafiku i saj u shtuan dhe kryesisht në të u përfshinë moshat nga 14 deri 25 vjeç. Adoloshentët (fëmijët 14-18 vjeç) të rrezikuar nga marrja e drogës po shfaqen si grupi marginal më i ri në Shqipëri.

497. Mbi bazën e disa vlerësimeve të OJQ-ve, të cilat veprojnë në këtë fushë, në vendin tonë llogariten rreth 10.000 përdorues drogë, 80% e tyre në Tiranë, nga të cilët 40% janë fëmijë dhe të rinj. Ky grup është prezent jo vetëm në Tiranë dhe qendrat e tjera të mëdha urbane, por po shtohet me shpejtësi edhe në qytetet më të vogla.

498. Më të rrezikuar nga droga janë të rinjtë e familjeve qytetare me gjendje ekonomike të mirë, sepse mundësia për të blerë drogë është faktor për përfshirjen në grupet e përdorimit të saj. Adoloshentët janë më të rrezikuar, sidomos në mjediset e shkollave, sepse në to droga shpërndahet falas. Po kështu të rrezikuar janë edhe të rinjtë të cilët e shpërndajnë dhe e tregëtojnë atë.

499. Per percaktimin sa me te sakte te perhapjes se droges do te behet nje studim i posacem i cili do te pasohet dhe me ngritjen e qendrave te posacme perkatese per kurimin e kesaj kategorie personash dhe sidomos femijeve, qe jane perdoruesit me te medhenj te saj.

500. Me ligjin nr. 8494, date 27.05.1999 eshte miratuar Marreveshja ndermjet Qeverise se Republikes se Shqiperise, Shoqates "Komuniteti Emanuel" dhe Caritas-it Shqiptar per ngritjen dhe funksionimin e Qendres Sociale Polivalente ne Vaqarr, Tirane. Sherbimi Social Shteteror, nje agjensi shteterore, bashkepunon me nje numer te konsiderueshem OJQ-sh qe veprojne ne fushen e sherbimeve sociale ne vecanti me Qendren Emanuel qe ofron sherbime rehabilitimi per personat perdorues te droges dhe alkoolit. Nga relacionet e derguara ne Sherbimin Social Shteteror, gjate vitit 2000 ne kete Qender Rezidenciale u trajtuan 13 persona. Ne kete Qender trajtohen me perparesi femijet dhe grate ne nevoje, si dhe te rinj perdorues te droges dhe alkoolit, sidomos ne zonat urbane, te cilet kane nevoje per ndihmen e shtetit dhe te shoqerise. Qendra e ngritur ka filluar te trajtoje, sidomos femijet e droguar dhe po sherben si nje eksperience e mire per hapjen e Qendrave te tjera ne Shqiperi ne perputhje me nevojat konkrete ne kete drejtim.

501. Ligji nr. 7975, date 26.07.1995 "Per barnat narkotike dhe lendet psikotrope", percakton rregullat e prodhimit, fabrikimit, importimit, eksportimit, tregtimit, perdorimit, kontrollit dhe ruajtjes se barnave narkotike dhe lendeve psikotrope. Ky ligj eshte hartuar sipas Konventes Unike per Barnat Narkotike te vitit 1961 dhe Konventes per Lendet Psikotrope te vitit 1971.

502. Ligji parashikon, gjithashtu, ndalimin ne territorin e Republikes se Shqiperise te prodhimit, fabrikimit, tregtimit dhe shperndarjes me shumice dhe pakice, transportimin, mbajtjen, furnizimin, dhenien me para ose falas, blerjen, perdorimin, importimin, eksportimin, kalimin tranzit te bimeve dhe lendeve me rrezikshmeri te larte qe nuk perdoren ne mjekesi.

503. Keshilli i Ministrave me Vendimin nr. 412, date 20.05.1996 "Per ngritjen e Komitetit Kombetar per Drogen", ka krijuar kete te fundit si organ nderdikasterial i kryesuar nga Zv/Kryeministri. Per realizimin e detyrave dhe objektive te caktuara nga ky Komitet, Vendimi parashikon ndermjet te tjerash edhe krijimin e Qendres Kombetare te Sistemit te Informacionit per Drogen prane Institutit te Shendetit Publik.

504. Kodi Penal i vitit 1995 pesoi ndryshime te rendesishme me ligjin nr.8279, date 15.01.1998 dhe priten permiresime te tjera gjate vitit 2001 persa i perket veprave penale te lidhura me drogen.

505. Kodi Penal parashikon vepren penale te prodhimit dhe shitjes se cdo lloj droge narkotike ose substance psikotrope te bere ne kundersizim me ligjin (neni 283), vepren penale te trafikimit te narkotikeve (neni 283/a), te krijimit te lehtesirave per marrjen dhe perdorimin e droges (neni 283/b), te kultivimit te bimeve narkotike, te prodhimit dhe fabrikimit te lendeve narkotike dhe psikotrope

(neni 284/c), vepron penale te organizimit dhe drejtimit te organizatave kriminale me qellim kultivimin, prodhimin, fabrikimin e paligjshem te narkotikeve (neni 284/a), dhe vepron penale te mbajtjes, prodhimit dhe transportimit te substancave kimike (neni 285). Kodi Penal nuk parashikon ndonje dispozite te veçante per terheqjen e femijeve ne shitjen dhe trafikun e droges, por ka nje dispozite te pergjithshme qe mund te zbatohet edhe ne kete rast, sipas se ciles shtytja ose terheqja e te miturve nen moshen 14 vjeç, per te kryer krim, denohet me burgim deri ne pese vjet.

506. Nje rol te madh ne ndergjegjesimin e te rinjve per njohjen me pasojat e droges dhe demet e saj, luan edhe shkolla. Duke patur parasysh se numri me i madh i perdoruesve te saj eshte ne Tirane, Drejtoria Arsimore e Rrethit ka ndermarre ne periudha te caktuara, fushata ndergjegjesimi te cilat perfshijne metoda te ndryshme efikase.

#### H. Shfrytëzimi dhe abuzimi seksual (neni 34)

507. Ne Shqiperi problemi i shfrytezimit seksual te femijeve, kryesisht vajza, ka marre permasa shqetesuese, sidomos vitet e fundit. Megjithese eshte bere nje problem shoqeror, nuk eshte arritur te percaktohet se cila eshte gjendja reale, numri i femijeve qe shfrytezohen, nderkohe qe ka te dhena se edhe ne Shqiperi ky fenomen eshte jo pak i perhapur. Nje pjese e mire e vajzave, qe terhiqen ne kete rruge, nuk marrin informacionin e duhur dhe bien ne gracken e mashtrimit te shfrytezuesve dhe te ketij fenomeni te ri te panjohur per to.

508. Ne Kodin Penal krimet seksuale kane pesuar ndryshime me ligjin nr. 8279, ne vitin 1998 dhe priten ndryshime te tjera gjate vitit 2001. Ne ndryshimet e fundit te Kodit Penal parashikohet qe termi “e mitur” te zevendesohet me termin “te mitur” dhe te shtohen marredheniet homoseksuale, si dhe cdo akt tjetër seksual.

509. Aktualisht, Kodi Penal parashikon si veper penale marredheniet seksuale, homoseksuale, si dhe cdo akt tjetër seksual me femije te mitur, qe nuk ka arritur moshen 14 vjeç, ose me femijen e mitur qe nuk ka arritur pjekurine seksuale, veper per te cilen kur kryhet me dhune, ose sjell si pasoje vdekjen ose vetvrasjen e femijes se mitur, zbatohet nje denim me i rende se ne rastin e pare (neni 100).

510. Ne Kodin Penal jane parashikuar gjithashtu dhe veprat penale te marredhenieve seksuale me dhune me femije te mitur te moshes 14-18 vjeç, ose me persona te pazote per tu mbrojtur, pazotesi fizike ose mendore ku perfshihen edhe femijet 14-18 vjeç (neni 101,103). Gjithashtu, ne Kodin Penal parashikohet si veper penale dhe kryerja e veprave te turpshme me te mitur qe kane arritur moshen 14 vjeç (neni 108).

511. Ne vitet 1993-1994 krimi i marredhenies seksuale me dhune me te miturat nga 14-18 vjeç mori permasa te konsiderueshme. Praktika gjyqesore tregon se denimet e dhena fillimisht kane qene teper te ulta dhe vetem kur permasat e ketij

krimi u bene shqetesuese per shoqerine, gjykata rriti ne menyre te ndjeshme masen e denimit, sidomos dhe me miratimin e Kodit te ri Penal ne vitin 1995.

512. Persa i perket shfrytezimit te femijeve per qellime prostitucioni, ne Kodin Penal parashikohet si veper penale dhe denohet me rende, kur shtytja, ndermjetesimi, ose marrja shperblim per ushrimin e prostitucionit kryhet ndaj nje te miture.

513. Duke pare se ne Shqiperi per te realizuar shfrytezimin e prostitucionit u perdor mashtrimi, shtrengimi, dhuna si dhe lidhjet e aferta te gjinise, krushqise, kujdestarise etj, me ligjin nr. 8279, date 15.01.1998, dispozita e Kodit Penal mbi shfrytezimin e prostitucionit ndryshoi.

514. Ne shfrytezimin e prostitucionit ne rrethana renduese u perfshine dhe elementet e siperpermendur. Gjithashtu, u parashikua si veper penale edhe shfrytezimi i prostitucionit i kryer ndaj nje personi qe shtyhet ose shtrengohet per te ushtruar prostitucion jashte territorit te Republikes se Shqiperise. Kjo veper penale u parashikua per shkak te shfrytezimit te prostitucionit me teper ne vende te tjera se ne Shqiperi.

515. Projekti per ndryshimet e reja ne Kodin Penal do te sjelle dhe miratimin e nje dispozite te re mbi trafikimin e femrave per prostitucion. Sipas kesaj dispozite te parashikuar, trafikimi i femrave per prostitucion, me qellim fitimi material, ose cdo perfitimi tjeter, denohet me burgim nga shtate deri ne pesembedhjete vjet. Po kjo veper, kur kryhet ne bashkepunim ose me shume se nje here ose shoqerohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhune fizike ose psikike te viktimes per te punuar a kryer veprime te ndryshme, ose sjell pasoja te renda, denohet me burgim jo me pak se pesembedhjete vjet ose me burgim te perjetshem..

516. Lidhur me pornografine, Kodi Penal e parashikon si veper penale kur prodhimi, shperndarja, reklamimi, importimi, shitja e botimi i materialeve pornografike behet ne ambjentet e te miturve.

517. Nje nga arsytet qe e kane shtyre Qeverine shqiptare ne hapat e saj per hapjen e Qendres Antitrafik ne qytetin e Vlores, eshte ne rradhe te pare edhe ndalimi i trafikut te grave dhe femijeve, sidomos te atyre personave te destinuar per tregun e prostitucionit ne vendet fqinje.

#### I. Forma të tjera shfrytëzimi (neni 36)

518. Deri me tani nuk ka te dhena per forma te tjera te shfrytezimit pervec formave te cilat jane shqyrtuar ne nenet e mesiperme te Konventes, ne vecanti shfrytezimit ekonomik dhe seksual. Sigurisht qe pervec shfrytezimit ekonomik dhe seksual te parashikuara ne dispozitat e meparshme, mund te lindin edhe forma te tjera te shfrytezimit.



## J. Shitja, trafikimi dhe rrëmbimi (neni 35)

519. Kodi Penal, i ndryshuar ne vitin 1998 dhe ndryshimet e pritshme ne vitin 2001, parashikojne si veper penale rrëmbimin ose mbajtjen peng te femijes nen moshen 14 vjeç, veper qe denohet me burgim jo me pak se pesembedhjete vjet. Po kjo veper, kur ka shkaktuar vdekje ose zhdukje te femijes se mitur denohet me burgim jo me pak se njezet vjet, ose me burgim te perjetshem. Gjithashtu, Kodi Penal parashikon si veper penale dhe fshehjen ose nderrimin e femijes me nje tjetër, e kryer nga personeli mjekesor, veper qe denohet me burgim nga tre deri ne tete vjet.

520. Ne ndryshimet e fundit qe pritet te pesoje Kodi Penal, gjate vitit 2001, parashikohet si veper penale trafikimi i femijeve. Sipas ketyre ndryshimeve, trafikimi i femijeve me qellim fitimi material, ose cdo perfitim tjetër, do denohet me burgim nga dhjete deri ne njezet vjet. Po kjo veper, kur kryhet ne bashkepunim ose me shume se nje here, apo shoqerohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhune fizike ose psikike te viktimes per te punuar a kryer veprime te ndryshme, ose sjell pasoja te renda, denohet me burgim jo me pak se pesembedhjete vjet ose me burgim te perjetshem.

521. Nje forme tjetër e trafikut te femijeve eshte edhe ajo qe behet nepermjet biresimit, sidomos biresimit nderkombetar. Praktika ne rastin e Shqiperise ka treguar se eshte i nevojshem nje bashkepunim me i madh nderkombetar per te zbuluar rastet e abuzimit ne fushen e biresimit dhe per te permisuar situaten.

522. Ne ligjin nr.7650, date 17.12.1992 "Per biresimin nga shtetas te huaj", ka nje dispozite penale sipas te ciles pranimi, kerkesa per marrje, ose marrja e parave dhe e te mirave materiale nga ana e prindit, kujdestarit, ose e çdo personi tjetër, per vete apo per te tretet, ne procesin e biresimit te nje te mituri denohet deri me pese vjet heqje lirie.

523. Ligji nr.8193, date 06.02.1997 "Per transplantimin e organeve", ka nje dispozite sipas se ciles ndalohet shitblerja e transplanteve si dhe çdo lloj veprimtarie qe favorizon reklamimin, tregtimin dhe trafikun e paligjshem te transplanteve. Ne paragrafin e dyte te kesaj dispozite parashikohet se keto veprimtari denohen sipas dispozitave te Kodit Penal.

524. Ne Shqiperi, vitet e fundit, eshte folur per trafikun e femijeve dhe te transplanteve, sidomos nga shtypi. Por, konkretisht nuk eshte arritur te zbulohet ky rrjet trafikantesh, nese ekziston. Perkundrazi, rastet e rrëmbimit te femijeve u kthyen nje kohe ne nje mjet fitimi per rrembyesit e tyre. Praktika gjyqesore njeh mjaft raste te tilla, por dhe shume raste te tjera nuk kane arritur te zbulohen ende nga organet kompetente, pasoje kjo edhe e mungeses se kualifikimit te personave qe punojne ne keto organe, meqenese per Shqiperine jane pothuajse krime te reja, por edhe per mangesi te mjeteve te nevojshme per zbulimin e tyre.

## K. Fëmijët që i përkasin minoriteteve apo grupeve indigjene (neni 30)

525. Ne Kushtetuten e Republikës së Shqipërisë parashikohet e drejta e pakicave kombëtare për të shprehur lirisht, pa u ndaluar as detyruar, perkatesinë e tyre etnike, kulturore, fetare e gjuhësore. Ata kanë të drejtë t'i ruajnë e zhvillojnë ato, të mesojnë dhe të mesohen në gjuhën e tyre amtare, si dhe të bashkohen në organizata dhe shoqata për mbrojtjen e interesave dhe të identitetit të tyre.

526. Kjo dispozitë nuk specifikon të drejtat e fëmijëve, që u përkasin pakicave kombëtare, por i përfshin ato, në termin e përdorur nga Kushtetuta, "personat që i përkasin pakicave kombëtare".

527. Në Shqipëri, të drejtat e përmendura në nenin 30 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, në parim, janë të garantuara për fëmijët e çdo grupi etnik, fetar ose gjuhësor, të cilët mund ta gëzojnë realisht lirinë individuale të besimit dhe ndërgjegjes, të arsimimit, të organizimit dhe grumbullimit. Pakicat kombëtare janë trajtuar pothuajse me të njëjtat të drejta që kanë edhe shtetasit shqiptarë dhe nuk ka përberë asnjehere problem trajtimi i tyre.

528. Për më tepër, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 396, datë 22.08.1994 "Për arsimin tetevjeçar në gjuhën amtare të personave të pakicave kombëtare", parashikohet e drejta e personave, që u përkasin pakicave kombëtare, të mesojnë në gjuhën e tyre amtare, në njësi shkollimi dhe institucione arsimore shtetërore të caktuara.

529. Në kuadrin e programit shkollor, nxenesve të pakicave kombëtare, në këto njësi, u krijohen mundësi për të studiuar historinë, traditën dhe kulturën e tyre. Vendimi i Këshillit të Ministrave parashikon edhe rastet kur në qendra banimi jetojnë persona që iu përkasin pakicave kombëtare, por që nuk plotësojnë numrin për të hapur shkollë të veçante për ta, kështu personave u krijohet mundësia të mesojnë në mënyrë fakultative gjuhën e tyre amtare, në kuadrin e sistemit shtetëror të arsimit të detyruar.

530. Me ligjin nr 8496, datë 03.06.1999, Shqipëria ratifikoi "Konventën Kuadër të Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Minoriteteve", duke marrë përsipër angazhimin për zbatimin e kësaj Konvente.

531. Mbrojtja ligjore në Shqipëri është garantuar si nga legjislacioni i brendshëm, ashtu edhe nga instrumentat ndërkombëtare të miratuara, mbron çdo individ nga akte të diskriminimit, armiqësisë, apo dhunës dhe parashikon sanksione të rënda penale për ata që i kryejnë ato.

532. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, në pjesën e tij të posaçme, në nenin 73, parashikon se "Zbatimi i një plani të paramenduar që synon shkatërrimin teresisht apo pjesërisht të një grupi nacional, etnik, racialet apo fetar i drejtuar kundër anëtarëve të grupit dhe i shoqëruar me veprat që vijnë, si: vrasje me

dashje te anetareve te grupit, demtime te renda fizike dhe psikike, vendosja ne kushte jetese te renda qe shkaktojne shkaterrimin fizik, zbatimi i masave qe synojne pengimin e lindjeve, si dhe transferimi i detyrueshem i femijeve te nje grupi ne nje grup tjetër, denohet me burgim jo me pak se dhjete vjet ose me burgim te perjetshem a me vdekje”.

533. Ndersa neni 74, i ketij Kodi, parashikon se “Vrasjet, shfarosjet, kthimi ne skllever, internimet dhe debimet, si dhe çdo lloj torture apo dhune tjetër çnjerezore te kryera per motive politike, ideologjike, raciale, etnike e fetare, denohen jo me pak se pesembedhjete vjet ose me burgim te perjetshem”. Çdo individ, i cili eshte viktime e diskriminimit etnik apo racial, qofte ky i hapur apo i fshehte, mund t’i drejtohet gjykates per mbrojtje juridike. Ne praktiken gjyqesore shqiptare nuk ka ndonje padi te ngritur nga pjesetare te pakicave kombetare lidhur me akte diskriminimi, armiqesie, apo dhune per shkak te perkatesise se tyre etnike, kulturore, gjuhesore, ose fetare.

534. Nje zhvillim te dukshem pas viteve ‘90 ka marre veprimtaria kulturore e artistike e pjestareve te pakicave kombetare. Te gjitha pakicat kane krijuar dhe nder ta veprojne aktivisht organizata e shoqata te ndryshme, te cilat luajne nje rol te madh ne njohjen e historise, traditave dhe kultures se ketyre pakicave.

535. Ne tekstet e reja per shkollat e pakicave kombetare greke e maqedonase, “Gjuhe e lexim letrar”, “Gjuhe shqipe e lexim letrar”, te pergatitura e botuara nga Shtepia Botuese e Librit shkollor, ne gjuhet e pakicave dhe ne gjuhen shqipe, jane perfshire pjese te zgjedhura nga folklori i pakices greke dhe maqedonase, nga shkrimtare e poete te ketyre pakicave, si dhe nga shkrimtare e poete te shquar te letersise greke dhe maqedonase te periudhave te ndryshme.

536. Gjithashtu, jane shtuar botimet per lexime jashteshkollore nga letersia e pakicave dhe letersise greke dhe maqedonase. Nje kontribut te rendesishem japin edhe Biblioteka dhe Qendra e Kultures Greke, shoqatat arumune, organizata te ndryshme joqeveritare, Lidhja e Shkrimtareve dhe Artisteve te Shqiperise, Muzeu Kombetar, Galeria e Arteve etj, te cilet kane organizuar here pas here veprimtari te ndryshme me nje pjesmarrje te gjere te personaliteteve me te shquara shqiptare dhe te pakicave nga fushat e letersise, artit, kultures, historise etj, per te perkujtuar ngjarje te rendesishme te jetes se pakicave dhe kombeve ame te tyre, te personaliteteve te tyre te shquara, per te promovuar botime e libra etj.

537. Ministria e Kultures, Rinise dhe Sporteve ne bashkepunim me nje agjensi private, ne qershor te vitit 2000, organizoi ne Tirane Festivalin e Femijeve te Pakicave Kombetare, i titulluar “Pellumbi i Bardhe”, ku u perfaqesuan me grupet e tyre artistike te femijeve te gjitha pakicat kombetare dhe pakicat linguistike qe jetojne ne Shqiperi.

538. Nje numer projektesh, organizuar ne rrethe te ndryshme te vendit nga Qeveria shqiptare, ne bashkepunim me organizata te ndryshme nderko mbetare dhe ne menyre te veçante me Fondacionin “Soros”, synojne te permiresojne

pjesemarrjen dhe integrimin e femijeve te familjeve rome ne shkolle. Keto projekte, qe perfshijne organizimin e tyre ne veprimtari kulturore e sportive, ne te cilat marrin pjese se bashku, si femijet shqiptare, ashtu edhe ata rome, kane kontribuar, gjithashtu, ne promovimin e respektit, e ndjenjave te miqesise dhe bashkepunimit midis tyre.

539. Ne Dropull, ne Prefekturen e Gjirokastrës, zhvillon veprimtarine e saj “Shoqata e Krijuesve Minoritare”, ku marrin pjese shkrimtare, poete, piktore e artiste te njohur minoritare. Ansambli Folkorik “Dropulli”, qe eshte nje nga ansamblet me ne ze ne Shqiperi, merr pjese aktive jo vetem ne jeten kulturore e artistike te vendit, por ajo, me perkrahjen e drejtperdrejte te Ministrise se Kultures, Rinise dhe Sporteve, Bashkise, Qendres Kulturore dhe sponsoreve te ndryshem private, ka dhene nje numer te madh koncertesh edhe jashte vendit, ku me te spikaturat padyshim kane qene ato te dhena ne Greqi.

540. Shoqata “Druzha Prespa” ne Komunen e Liqenasit ne Prefekturen e Korçës, drejton dhe organizon veprimtarine e grupeve popullore te fshatrave minoritare maqedonase. Kjo shoqate ka organizuar Festivalin e Liqenasit dhe nje sere turne artistike ne Shqiperi dhe ne rrethinat fqinje te ish Republikës Jugosllave te Maqedonise, ku me kenget, melodite, vallet dhe sidomos me kostumet popullore, kane deshmuar vlerat e tradites popullore dhe ruajtjen e saj.

541. Ne Komunen e Vrakes, ne Prefekturen e Shkodres, zhvillon veprimtarine e saj shoqata kulturore e pakices malazeze “Moraça Rozafa”, e cila ka realizuar nje sere veprimtarish kulturore e artistike, duke mbajtur gjalle kenget, vallet, ritet e veshjet tradicionale te tradites popullore malazeze.

542. Romet jane te organizuar ne shoqatat e tyre “Amaro - Drom” themeluar ne mars 1991, “Amaro Divas” themeluar me 1996, “Romani Baxt” themeluar me 1991 dhe “Grupi per Zhvillimin e Kultures Rome”.

543. Shoqata “Amaro-Drom” eshte e perbere nga nje berthame qendrore ne Tirane dhe, sipas informacionit nga zyra e tyre ne Tirane, veprimtarite e tyre mbeshteten nga kater qendra koordinuese, kryesisht ne Fushe Kruje, Lushnje, Fier, Korçe. Me rendesi eshte te permendim se kjo shoqate ka, gjithashtu, Forumin e Gruas dhe Forumin e Rinise. Shoqata ka gazeten e saj “Ylli i Karvanit” qe del njehere ne muaj. Shoqata luan nje rol te madh ne ruajtjen e gjuhes, folklorit te tyre te pasur dhe artit te muzikes. Ajo ka krijuar nje sere grupesh me instrumentiste, kengetare dhe valltare te talentuar, qe kane marre pjese ne shume veprimtari kombetare dhe nderkombetare. Shoqata “Amaro Drom” ka aktivizuar gjithashtu edhe nje ekip futbollit, i cili ka marre pjese ne disa veprimtari kombetare.

544. Veprimtari te ngjashme zhvillon edhe shoqata “Amaro Divas”. Ajo, gjithashtu, ka grupin e saj artistik dhe ka hapur nje kurs per mesimin e instrumentave muzikore. Edhe kjo shoqate boton revisten e saj mujore, qe mban te njejtin emer sikurse edhe vete shoqata.

545. Pas viteve 1990, arumunet (vllahet) janë organizuar në shoqatat e tyre “Armeni-Alban”, “Shoqata e Vllahve Voskopoje” dhe “Aefallofisi”. Këto shoqata luajnë një rol të rëndësishëm në ruajtjen e gjuhës, kultures dhe traditave të tyre. Ata kanë gjithashtu gazetën e tyre “Fratia-Vellazëria”, që del një herë në muaj, në gjuhën shqipe dhe arumune.

546. Ndryshimet demokratike gjatë dekadës së fundit bëjnë të mundur rivendosjen e lirisë së ndërgjegjes dhe besimit fetar. Në këtë kuadër në vend u rihapen të gjitha objektet fetare të kultit dhe njëzëri u lanë të lirë të praktikojnë fenë dhe ritet e tyre fetare. Sipas statistikës më të fundit zyrtare të vitit 1953, popullsia në Shqipëri përbëhet nga muslimanë - 50%, bektashianë - 20%, ortodoksë - 20% dhe katolike - 10%.

547. Ndryshimet demokratike në Shqipëri, gjatë dekadës së fundit, krijuan një mjedis të favorshëm për zhvillimin dhe nisimat e sektorit joqeveritar, në kuadrin e shtetit ligjor. Të gjitha pakicat kombëtare që jetojnë në Shqipëri e kanë shfrytëzuar këtë mundësi për t'i dhënë një impuls të ri ruajtjes dhe zhvillimit të elementeve kryesore të identitetit të tyre, gjuhës, traditave, fese dhe trashëgimisë së tyre kulturore.

548. Duhet theksuar se në familjet e pjesëtarëve të pakicave kombëtare, qofshin këto greke, maqedonase apo malazeze, por edhe në familjet e pakicave linguistike të romëve dhe arumunëve, gjuha amtare është transmetuar nga brezi në brez. Ndonëse sipas Kushtetutës (neni 14), “gjuha zyrtare në Shqipëri është gjuha shqipe”, pakicat kombëtare, sipas nenit 20 të Kushtetutës, kanë të drejtë të ruajnë, të zhvillojnë e “të mesojnë dhe të mesohen në gjuhën e tyre amtare”.

549. E drejta për të përdorur gjuhën amtare privatisht dhe në publik është e garantuar edhe në praktike. Individet nga pakicat kombëtare e përdorin gjuhën e tyre lirisht në jetën e përditshme, me njeri-tjetrin, në mbledhjet publike, në shoqatat e tyre, në fushatat elektorale, në shtypin e tyre, në botimet e tyre me karakter kulturor, letrar, historik apo shkencor, në media, si dhe në ceremonitë fetare. Një faktor i rëndësishëm për ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës amtare të pakicave janë edhe shkollat e shumta publike, apo private që funksionojnë për shkollimin e femijëve të pjestarëve të këtyre pakicave.

550. Edhe romët në Shqipëri kanë mundur të ruajnë gjuhën e tyre tradicionale, të cilën e flasin në mjedisin e tyre. Romët e shkruajnë gjuhën e tyre në raste tepër të rralla, pasi në Shqipëri nuk ka patur shkollë romësh.

551. Gjuhën e tyre tradicionale, të cilën e flasin në mjediset e tyre, e kanë ruajtur edhe arumunët. Ajo është ruajtur me shumë e më mirë veçanërisht në grupet kompakte, që jetojnë në fshatra dhe, deri diku, në brezin e vjetër dhe të mesëm të atyre që jetojnë në qytete.

552. Veshtrim i shkurter historik i pakicave kombetare qe jetojne ne Shqiperi. Ne Shqiperi tradita historike ka ecur ne rrugen e njohjes si pakica kombetare te atyre pakicave qe kane nje komb ame, me te cilin kane karakteristika te perbashketa, si: konstitucionin shpirtoror, gjuhen, kulturen, zakonet e traditat, besimin fetar etj. Si pakica te tilla jane konsideruar pakica greke, maqedonase dhe malazeze. Romet dhe arumunet jane njohur dhe respektuar si pakica linguistike.

553. Pakica kombetare greke

Ne jug te Shqiperise, ne kufi me Greqine, jeton nje popullsi greke, qe perben pakicen kombetare me te madhe ne numer. Sipas te dhenave nga Regjistrimi i Pergjithshem i Popullsise dhe i Banesave i vitit 1989, numri i kesaj popullsie eshte 58.758 banore. Pjesetaret e ketij komuniteti jetojne kryesisht ne rrethet Gjirokaster, Sarande dhe Delvine.

554. Pakica kombetare maqedonase

Pakica kombetare maqedonase ndodhet e perqendruar ne zonen e Prespes. Kjo zone eshte e shtrire ne skajin juglindor te Shqiperise, ne kufi me ish Republiken Jugosllave te Maqedonise dhe Greqine. Siperfaqja e zones se Prespes eshte 213.9 km<sup>2</sup>. Popullsia e kesaj zone eshte 4.878 banore, qe do te thote 240 banore per km<sup>2</sup>

555. Pakica kombetare malazeze

Pakica kombetare malazeze eshte e perqendruar kryesisht ne disa fshatra te vegjel ne zonen e Vrakes (fshatrat Gril, Omaraj, Borici i Vogel), ne veri te qytetit te Shkodres (ne Veriperendim te Shqiperise), prane liqenit me te njejtin emer dhe prane kufirit me Malin e Zi. Te dhena statistikore mbi numrin e kesaj pakice ne regjistrimin e vitit 1989 nuk jane te specifikuar dhe te sakta. Gjithsesi, sipas te dhenave nga vezhgimi i bere vitin e kaluar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, kjo pakice perbehet nga rreth 2000 vete dhe ka ruajtur kompaktesine e vet si pakice kombetare, gjuhen, kulturen, fene, traditat e shtetit ame etj.

556. Romet

Te dhena stastistikore lidhur me numrin e romeve qe jetojne ne Shqiperi, mungojne, pasi nje regjistrim i pergjithshem i tyre nuk eshte bere asnjehere. Ata perbehen nga kater fise kryesore: Kallbuxhinj (Tirane, Elbasan, Pogradec, Korce, Bilisht, Gjirokaster, Sarande); Meçkare (Lushnje, Fier, Vlore); Kurtofet - te shperndare; Cergaret - nomade. Persa i perket pozites se romeve, mund te thuhet se ata nuk jane objekt i nje trajtimi diskriminues si komunitet me vete. Por, gjithsesi, problemi i romeve eshte problemi i nje komuniteti me nje nivel teper te ulet jetese. Ne nje kuptim, çeshtja e romeve paraqet probleme te njellojta me ato qe shtrohen ne shkalle rajonale.

557. Arumunet

Midis pakicave, ne Shqiperi jetojne edhe arumunet (te njohur kryesisht si vllehe). Trevat shqiptare, ne hapësira dhe ne kohe te caktuara, kane ndjere popullimin e nomadeve arumune. Per here te pare te dhenat per numrin e pakices arumune ne Shqiperi jepen ne regjistrimin e vitit 1950. Ne kete regjistrim shenohen 2381

banore te popullsise vllahe. Kurse, ne regjistrimin e vitit 1955, numri i popullsise vllahe rezulton ne 4249 banore. Ne regjistrimet e mevonshme nuk rezultojne me te dhena per numrin e arumuneve ne Shqiperi.

558. Me qellim ruajtjen dhe forcimin e identitetit kulturor te pakicave kombetare dhe qe ato te jene ne kontakt te vazhdueshem me zhvillimet politike, shoqerore, ekonomike e kulturore dhe jo vetem me ato brenda vendit, por edhe me ato ne fushen nderkombetare, legjislacioni shqiptar parashikon akses te plote ne gjuhen e tyre amtare, si ne median e shkruar, ashtu edhe ne ate elektronike.

559. Liria e shprehjes, sikurse parashikohet ne Konventen "Per mbrojtjen e te drejtave dhe lirive themelore te njeriut" te Keshillit te Evropes, perben nje te drejte themelore kushtetuese ne Shqiperi. Neni 22 i Kushtetutes garanton lirine e shprehjes dhe lirine shtypit, radios dhe televizionit per te gjithë, perfshire edhe pakicat kombetare dhe ndalon censuren paraprake te mjeteve te komunikimit. Mbi bazen e ligjit ekzistues anetaret e pakicave kombetare, ashtu sikurse te gjithë shtetasit shqiptare kane te drejte, pa asnje pengese te krijojne median e tyre te shkruar ne gjuhen amtare. Shtypi i pakicave kombetare, ashtu si edhe i gjithë shtypi ne Shqiperi, nuk i nenshtrohet censures paraprake.

560. Aktualisht pakica greke, qe jeton ne rrethet e Gjirokastrës, Sarandës, Delvines etj, ka keto revista e gazeta : "Lajko Vima", gazete qe e ka zanafillen e vet qe nga viti 1945; "I Foni tis Omonias" (Zeri i Omonias), e perjavshme; "2000", gazete ne tre gjuhe greqisht, anglisht, shqip; "Oaz" dhe "Progres". revista te ilustruara. Gazetat dhe revistat e permendura me siper shperndahen falas ne çdo fshat. Gjithashtu, ne zonen e kesaj pakice hyjne nga Greqia dhe 15 tituj te tjere gazetash e revistash ne gjuhen greke.

561. Shtypi maqedonas dhe ai malazez gjithashtu, vjen pa asnje pengese ne pakicat maqedonase, apo ate malazeze ne Shqiperi. Arumunet kane gazeten e tyre "Fratia - Vellazerimi", e cila del njehere ne muaj ne gjuhen shqipe dhe ate arumune.

562. Akses ne median elektronike, pakicave kombetare u garanton ligji nr. 8410, date 30.09.1998 "Mbi Radio Televizionin Publik dhe Privat ne Republiken e Shqiperise". Ligji shpall lirine e veprimtarise se radio-televizionit dhe pavaresine editoriale te tyre (neni 4 dhe 5).

563. Ne nenin 39 te ligjit te siperpermendur ndalohet "transmetimi i programeve qe nxisin dhunen, luften agresive, urrejtjen kombetare dhe raciale" etj, ndersa ne nenin 36 parashikohet qe "programet radiotelevizive te respektojne dinjitetin personal dhe te drejtat themelore te njeriut, paaneshmerine, plotesine dhe pluralizmin e informacionit, te drejtat e femijeve dhe te adoleshenteve, rendin publik dhe sigurine kombetare, gjuhen dhe kulturen, te drejtat kushtetuese e njerezore te shtetasve, te pakicave kombetare ne perputhje me konventat nderkombetare qe ka nenshkruar Republika e Shqiperise dhe diversitetin fetar shqiptar"

564. Kurse ne nenin 37 thuhet: “Perdorimi i gjuhes shqipe eshte i detyruar per te gjithë programet, perveç veprave muzikore me tekst ne gjuhe te huaj, emisioneve per mesimin e gjuheve te huaja, emisioneve drejtuar posaçerisht pakicave kombetare dhe programeve te subjekteve radiotelevizive lokale te licensuara per transmetim ne gjuhen e pakicave”. Mbi kete baze, hapja e stacioneve lokale radiofonike apo televizive nga pjestaret e pakicave kombetare ne gjuhët e tyre amtare, eshte e garantuar.

565. Sipas Kushtetutes (neni 14) gjuha zyrtare ne Shqiperi eshte gjuha shqipe. Keshtu qe i gjithë dokumentacioni ne organet e pushtetit qendror dhe organet e njesive administrative te pushtetit lokal perpilohet ne gjuhen zyrtare. Ndersa komunikimi verbal ndermjet pjesetareve te pakicave dhe autoriteteve te administrates se pushtetit lokal ne zonat e banuara prej tyre, duke qene se edhe keto autoritete ne shumicen dermuese jane minoritare, sipas zgjedhjes se tyre te lire mund te behet ne gjuhen amtare.

566. Neni 28, pika 1 te Kushtetutes, parashikon se kujtdo “qe i hiqet liria, ka te drejte te njoftohet menjehere ne gjuhen qe ai kupton, per shkaqet e kesaj mase, si dhe per akuzen qe i behet”. Ndersa ne nenin 31 te saj, pika c, parashikohet se gjate procesit penal kushdo ka te drejte “te kete ndihmen pa pagese te nje perkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhen shqipe”.

567. Kodi i Procedures Penale ne piken 2, te nenit 8, parashikon se ne te gjitha fazat e procedimit gjyqesor “Persona qe nuk dine shqip perdorin gjuhen e tyre dhe, me anen e perkthyesit, kane te drejte te flasin e te marrin dijeni per provat e aktet, si dhe per zhvillimin e procedimit”.

568. Gjithashtu, neni 98, pika 2, lidhur me perpilimin e akteve te procedures penale, parashikon se “Personi qe nuk flet gjuhen shqipe pyetet ne gjuhen amtare dhe procesverbali mbahet edhe ne kete gjuhe. Ne te njejten gjuhe perkthehen aktet procedurale, qe jepen me kerkese te tij”.

569. E drejta per te deponuar ne gjuhen e vet i njihet edhe nje deshmitari ne proces. E drejta per perdorimin e gjuhes se tyre apo e perpilimit te akteve ne gjuhen e tyre amtare, u njihet personave qe nuk dine gjuhen shqipe edhe ne procesin gjyqesor civil.

570. Ne nenin 27 paragrafi i dyte i Kodit te Procedures Civile parashikohet se “Personat qe nuk dine shqip perdorin gjuhen e tyre. Ata marrin dijeni per provat dhe per gjithë zhvillimin e gjykimit me ane te perkthyesit”. Ndersa ne nenin 116, ne paragrafin e dyte, thuhet se “Gjykata, per pyetjen e personave qe nuk dine gjuhen shqipe ose per perkthimin e dokumentave te shkruara ne gjuhe te huaj, therret perkthyesin”.

571. Se fundmi, sipas nenit 5 te ligjit nr. 8328, date 16.04.1998, “Mbi te drejtat dhe trajtimin e te denuarve me burgim”, “trajtimi i te denuarve nuk duhet te kete



diskriminim per shkak te seksit, kombesise, races, gjendjes ekonomike dhe shoqerore, pikpamjet politike dhe besimeve fetare”.

572. Rregullorja e Burgjeve te Republikes se Shqiperise, miratuar me Vendimin e Keshillit te Ministrave nr.96, date 09.03.2000, ne nenet 13, 45, 53 dhe 63, gjithashtu parashikon njoftimin e personave te denuar ne gjuhen qe ata kuptojne mbi rregullat e burgut, menyren e vuajtjes se denimit, te drejtat dhe detyrimet e te burgosurve etj. Te gjitha te drejtat e parashikuara me siper vlejne edhe per femijet qe i perkasin minoriteteve etnike, kulturore, fetare, apo gjuhesore.

573. Pjesetaret e pakicave kombetare qe jetojne ne Shqiperi jane te lire te vendosin dhe mbajne emrat dhe mbiemrat e tyre sipas traditave ne gjuhen e tyre dhe gezojne te drejten e njohjes zyrtare te tyre. Regjistrimin e emrave te tyre dhe te anetareve te familjeve te tyre, pjestaret e pakicave kombetare e bejne ne Zyrat e Gjendjeve Civile te Bashkive apo Komunave ku ato jetojne.

574. Sipas ligjit, regjistrimi ne regjistrat e Zyres se Gjendjes Civile behet nga nepunesi i kesaj zyre sipas prononcimit fonetik prej tyre, por gjithmo ne mbi bazen e ortografise te alfabetit latin, sikurse shkruhet gjuha shqipe, qe eshte njekohesisht edhe gjuha zyrtare ne Shqiperi. Ky rregull zbatohet gjithashtu edhe per faktin se te tre pakicat kombetare, qe jetojne ne territorin e Shqiperise, gjuhet e tyre amtare i shkruajne mbi bazen e ortografise se alfabetit grek, apo cirilik. Per pasoje, regjistrimi i emrave dhe mbiemrave te pjesetareve te tyre, te mbeshtetur ne ortografine cirilike, do te krijonte probleme te shumta dhe peshtjellim ne marredheniet e tyre me pjesen tjeter te administrates publike dhe institucioneve te tjera te ndryshme ne Shqiperi.

575. Ne Shqiperi eshte bere dhe behet kujdes i vecante e i vazhdueshem per arsimimin e pakicave kombetare. Ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise ne nenin 20, ne paragrafet 1 dhe 2, per pakicat kombetare thuhet: "Personat qe u perkasin pakicave kombetare ushtrojne ne barazi te plote para ligjit te drejtat dhe lirite e tyre. Ata kane te drejte te shprehin lirisht, pa u ndaluar as detyruar, perkatesine e tyre etnike, kulturore, fetare e gjuhesore. Ata kane te drejte t'i ruajne e zhvillojne ato te mesojne dhe te mesohen ne gjuhen e tyre amtare".

576. Te drejta te barabarta per te gjitha ofron edhe legjislacioni ne fushen e arsimit. Neni 3 i ligjit nr. 7952, date 21.06.1995, "Per Sistemin e Arsimit Parauniversitar", garanton te drejta te barabarta per te gjitha shtetasit "per t'u arsimuar ne te gjitha nivelet e arsimit qe percaktohen nga ky ligj, pavaresisht nga gjendja sociale, kombesia, gjuha, seksi, feja, raca, bindjet politike, gjendja shendetesore dhe niveli ekonomik".

577. Arsimimi pakicave kombetare perfshin tre nivele shkollimi, njesoj si edhe per shqiptaret: ai parashkollor, 8-vjecar dhe te mesem te pergjithshem. Ne vitin 1998, ne shkollat e pakicave u futen edhe lendet e reja: Njohuri per Historine e Popullit Grek dhe Njohuri per Historine e Popullit Maqedon.

578. Ne shkollat 8-vjeçare te te dy pakicave, per vitin shkollor 2000-2001, mesojne gjithsej 1845 nxenes, qe perbejne 0,37% te te gjithe nxenesve te arsimit 8-vjeçar dhe japin mesim 297 mesues gjithsej, nga te cilet 267 jane minoritare.

579. Gjithashtu, ne zonen ku jeton pakica kombetare greke dhe ajo maqedonase, funksionojne 35 kopshte me 628 femije. Ne keto kopshte per femijet kujdesen 43 edukatore minoritare. Raporti nxenes-mesues, per te dy pakicat, eshte 6 nxenes per mesues, nderkohe qe ky raport per shkollat shqiptare te arsimit 8 vjecar eshte 19 nxenes per mesues. Ky raport eshte i vogel per shkollat e pakicave per arsye se megjithese ka rene shume numri i nxenesve neper shkolla per shkak te largimit te tyre ne emigracion, ato jane mbajtur hapur.